



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

---

**AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT**  
**NË ROLIN E**  
**MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

**RAPORTI I VEÇANTË VJETOR**  
**2018**

**Tiranë 2020**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. Kuadri, mandati ligjor i funksionimit të MKPT-së .....</b>	<b>4</b>
<b>2. Metodologjia e përdorur gjatë inspektimeve nga MKPT-ja .....</b>	<b>6</b>
<b>3. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet .....</b>	<b>7</b>
<b>3.1 Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës</b>	
<b>4. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet .....</b>	<b>9</b>
<b>4.1. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare .....</b>	<b>10</b>
<b>4.2. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore .....</b>	<b>15</b>
<b>4.3 E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet .....</b>	<b>17</b>
<b>4.4 Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare ndjekur nga ana e MKPT-së gjatë vitit 2018 .....</b>	<b>19</b>
<b>4.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra .....</b>	<b>19</b>
<b>4.5.1 Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç .....</b>	<b>20</b>
<b>4.6 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë .....</b>	<b>24</b>
<b>5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në</b>	
<b>Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale .....</b>	<b>25</b>
<b>5.1 IEVP “Ali Demi” (325), Tiranë - Datë 24.05.2018 .....</b>	<b>25</b>
<b>5.2 IEVP Burrel – Datë 04.09.2018 .....</b>	<b>31</b>
<b>5.3 IEVP Kukës – Datë 10.09.2018 .....</b>	<b>36</b>
<b>5.4 IEVP Tropojë - Datë 12.09.2018 .....</b>	<b>39</b>
<b>5.5 IEVP Tepelenë - Datë 2.10.2018 .....</b>	<b>42</b>
<b>5.6 IEVP Vlorë - Datë 16.10.2018 .....</b>	<b>48</b>
<b>5.7 IEVP Sarandë - Datë 17.10.2018 .....</b>	<b>52</b>
<b>5.8 IEVP “Mine Peza” 302 Tiranë - Datë 23.10.2018 .....</b>	<b>56</b>
<b>5.9 IEVP Drenovë, Korçë - Datë 29.10.2018 .....</b>	<b>59</b>
<b>5.10 IEVP Vaqarr - Datë 03.12.2018 .....</b>	<b>64</b>
<b>5.11 IEVP Berat – Datë 15.11.2018 .....</b>	<b>68</b>

<b>5.12 IEVP Shën Koll, Lezhë – Datë 07.12.2018</b>	<b>71</b>
<b>6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në Drejtoritë</b>	
<b>Vendore të Policisë dhe në Komisaritet e varësisë</b>	<b>76</b>
<b>6.1 Komisariati i Policisë Krujë - Datë 10.05.2018</b>	<b>76</b>
<b>6.2 Komisariati i Policisë Bulqizë - Datë 06.09.2018</b>	<b>77</b>
<b>6.3 Komisariati i Policisë Mat - Datë 06.09.2018</b>	<b>79</b>
<b>6.4 Komisariati i Policisë Dibër- Datë 07.09.2018</b>	<b>82</b>
<b>6.5 Komisariati i Policisë Has - Datë 10.09.2018</b>	<b>85</b>
<b>6.6 Komisariati i Policisë Kukës - Datë 10.09.2018</b>	<b>86</b>
<b>6.7 Komisariati i Policisë Tropojë - Datë 10.09.2018</b>	<b>89</b>
<b>6.8 Komisariati i Policisë Vlorë - Datë 16.09.2018</b>	<b>91</b>
<b>6.9 Komisariati nr.1, Tiranë – Datë 20.09.2018</b>	<b>96</b>
<b>6.10 Komisariati nr.3, Tiranë – Datë 21.09.2018</b>	<b>100</b>
<b>6.11 Komisariati nr.6, Tiranë – Datë 21.09.2018</b>	<b>103</b>
<b>6.12 Komisariati i Policisë Rinas - Datë 25.09.2018</b>	<b>104</b>
<b>6.13 Komisariati i Policisë Vorë - Datë 25.09.2018</b>	<b>106</b>
<b>6.14 Komisariati i Policisë Kavajë - Datë 27.09.2018</b>	<b>108</b>
<b>6.15 Komisariati i Policisë Tepelenë - Datë 01.10.2018</b>	<b>110</b>
<b>6.16 Komisariati i Policisë Përmet - Datë 01.10.2018</b>	<b>112</b>
<b>6.17 Komisariati i Policisë Gjirokastër - Datë 03.10.2018</b>	<b>113</b>
<b>6.18 Komisariati i Policisë Delvinë - Datë 07.10.2018</b>	<b>116</b>
<b>6.19 Komisariati i Policisë Sarandë - Datë 17.10.2018</b>	<b>120</b>
<b>6.20 Komisariati i Policisë Pogradec - Datë 31.10.2018</b>	<b>124</b>
<b>6.21 Komisariati i Policisë Kolonjë - Datë 01.11.2018</b>	<b>125</b>
<b>6.22 Komisariati i Policisë Lushnje - Datë 05.11.2018</b>	<b>127</b>
<b>6.23 Komisariati i Policisë Malësi e Madhe - Datë 21.11.2018</b>	<b>129</b>
<b>6.24 Komisariati i Policisë Shkodër- Datë 21.11.2018</b>	<b>131</b>
<b>6.25 Komisariati i Policisë Pukë - Datë 23.11.2018</b>	<b>134</b>
<b>6.26 Komisariati i Policisë Mirditë - Datë 05.12.2018</b>	<b>135</b>
<b>6.27 Komisariati i Policisë Kurbin - Datë 05.12.2018</b>	<b>137</b>
<b>6.28 Komisariati i Policisë Lezhë - Datë 07.12.2018</b>	<b>139</b>

# AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË NË ROLIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

## RAPORTI VJETOR

2018

### Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2018

#### 1. Kuadri, mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Gjatë vitit 2018 Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është përmbushur si një detyrë funksionale e konsoliduar duke u mbështetur në prioritete të veçanta.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, zbaton një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë e përditshme. Konkretisht, sipas pikës 1 të nenit 60 të Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Nisur nga nevoja për të përmbushur një monitorim më të madh të institucioneve ku liria e personave është e kufizuar, ku dhe probabiliteti për shkelje është më i lartë, janë paraparë të rëndësishme për zbatim edhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)” miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt. 03.07.2003.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e mësipërme dhe garantojnë një aktivitet konform standardeve kombëtare në këtë drejtim.

Gjithashtu, neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses te madh në çdo ambient apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qofte dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në institucionet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në Spitale Psikiatrike në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka pasur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të artikulojë një qëndrim realist zyrtar mbi situatën në terren.

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer **91** inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë, inspektime të kthimeve të detyruara të emigrantëve në bashkëpunim me Frontex dhe vizita në të gjitha vendet e privimit të lirisë dhe institucionet e tjera. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me rekomandime dhe me një korrespondencë zyrtare të shpeshtuar, për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë prezantuar kryesisht për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore edhe një sërë masash të tjera për kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukture, në plotësimin

e efektivit punonjës me qëllimin mbulimin e plotë të shërbimeve të kërkuara nga këto institucione. Përveç kësaj është mbajtur në konsideratë veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me administratën e burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre etj.

Gjatë vitit 2018, janë kryer sondazhe në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të shoqërimit të shtetasve, për mbajtjen e objekteve të dyshimta në zyrat e hetimit që mund të provokojnë dhunë psikologjike tek individët, si dhe për rolin e psikologut të policisë në trajtimin e personave të mitur dhe të efektivave që mund të shfaqin probleme psikologjike gjatë shërbimit. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit.

Një tjetër fushë ku është fokusuar gjatë vitit 2018 aktiviteti i Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka qenë monitorimi i operacioneve të përbashkëta të kthimit të detyruar të emigrantëve të paligjshëm nga zona Shengen të koordinuara nga Frontex.

Gjatë periudhës Janar 2018- Dhjetor 2018, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe Frontex, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të 37 operacioneve të riadhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Avokati i Popullit është përfaqësuar rregullisht dhe aktivisht në të gjitha aktivitetet e përvitshme të organizuara nga organizmat ndërkombëtare dhe shoqatat ne mbrojtje të të drejtave të njeriut me qëllim shkëmbim informacionesh dhe përvojash më të mira dhe është pjesë e rrjeteve të MKPT-ve në nivel ndërkombëtar.

### **Roli parandalues i Avokatit të Popullit në mbrojtje të shkeljes së të drejtave të personave të privuar nga liria për vitin 2018**

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është parashikuar në ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, ndërkohë që njohja ligjore e saj, si strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Gjatë vitit 2016, shtesat dhe ndryshimet ligjore të bëra me anë të Ligjit Nr. 155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, ‘Për Avokatin e Popullit’”, e kanë kaluar strukturën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në nivel Seksioni duke parashikuar zgjedhjen nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Komisionerit drejtues të këtij seksioni.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në ushtrimin e detyrave të tij të njohura nga legjislacioni vendas, udhëhiqet edhe nga parime e instrumente të sanksionuara në legjislacionin ndërkombëtar si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollet e saj shtesë<sup>1</sup>; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Çnjerëzor e Degradues,<sup>2</sup>; Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT),<sup>3</sup>; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese,<sup>4</sup>. Lista e instrumentave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës dhe vendimesh të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës të cilët janë të rëndësishëm dhe përbejnë standarde në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. MKPT funksionon dhe vepron në përputhje me legjislacionin vendas, si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 437, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”; Ligjin Nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërish, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

## **2. Metodologjia e përdorur gjatë inspektimeve nga MKPT-ja**

Metodologjia e ndjekur nga MKPT-ja gjatë vizitave inspektuese konsiston në: përgatitjen e vizitës, ndarja në grupe, takimi dhe bashkëbisedimi me drejtuesin/drejtuesit e institucionit, grupi monitorues viziton të gjitha hapësirat e institucionit, kryen intervista me personat e privuar nga liria, zhvillon takime me punonjësit e burgjeve (përfshirë personelin me uniformë si dhe ata civilë), me punonjësit e policisë në raste e inspektimit në komisariatet e policisë, zhvillon takime me personelin shëndetësor, kontrollojnë regjistrat, dhomat ku merren në pyetje të ndaluarit/shoqëruarit, kuzhinat në rastet e inspektimeve në burgje, spitale psikiatrike, apo qendrat e ndryshme të azilit apo të antitrafikut, në përfundim të inspektimit zhvillon takimin ndërmjet anëtarëve të grupit monitorues, përpara takimit final me drejtuesin e institucionit dhe më tej, biseda finale me drejtuesin ku i parashtrohen gjetjet dhe i lihen paraprakisht rekomandimet për përmirësimin e problematikave të evidentuara.

Faza e përgatitjes së vizitës nënkupton mbledhjen e informacionit të rëndësishme për institucionin i cili do të vizitohet, objektivi i vizitës, përcaktimin e numrit të anëtarëve të MKPT-së, të cilët do të marrin pjesë në grupin inspektues, ndarjen konkrete të detyrave, si dhe diskutimi me Seksionin e Veçantë lidhur me rastet e ankesave, që mund të kenë ndjekur ata, për institucionin që do të inspektohet. MKPT-ja i kryen vizita në vendet ku privohet liria, kryesisht pa paralajmërim.

<sup>1</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996

<sup>2</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993

<sup>3</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003

<sup>4</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.07.1996

Gjatë bisedës paraprake me drejtuesin e institucionit, i cili inspektohet nënkupton prezantimin e mandatit të MKPT-së në mënyrë efektive dhe profesionale, prezantimin e anëtarëve të ekipit monitorues, objektivi i vizitës, kontrolli nëse janë zbatuar apo jo rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm etj. Pas bisedës fillestare me drejtorin, ekipi monitorues bën inspektimin në të gjitha hapësirat e institucionit.

Vlen të theksohet se në intervistat me personat e privuar nga liria dhe zyrtarët e institucionit, ekipi monitorues i siguron të intervistuarit se biseda do të jetë konfidenciale, pa prezencë të zyrtarëve të institucionit.

Në përfundim të gjithë procedurave grupi inspektues harton raportin dhe lë rekomandimet përkatëse të cilat ua dërgon institucioneve të inspektuara.

### **3. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet.**

Gjatë vitit 2018, MKPT ka funksionuar si një seksion me strukturë multidisiplinare të përbërë nga 4 (katër) ndihmës komisionerë, pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë, prej të cilëve tre ekspertë ligjorë dhe një psikologe dhe është drejtuar nga Komisioneri i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë. Për herë të parë në 15 mars 2018, sipas ndryshimeve të bëra në ligjin për Avokatin e Popullit, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi znj Ermonela Xhafa, si komisionere e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së mori pjesë në aktivitetet e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare mori pjesë dhe kontribuoi në disa seminare dhe konferenca.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2018, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta, kontakteve të drejtpërdrejta dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave, mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe Frontex, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të 32 operacioneve të riatdhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të

Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

### ***3.1 Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës***

Në kuadrin e bashkëpunimit Ndërkombëtar, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Ombudsmanit të Armenisë si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës mbajtur në datat 28-29 Nëntor në Jerevan, Armeni.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit në Forumin Evropian të Mekanizmit për Parandalimin e Torturës mbi monitorimin e shtëpive të të moshuarve të organizuar në **12 Mars**, në Trier, Gjermani.
- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga FRONTEX në lidhje me monitorimin e kthimeve të detyruara, të mbajtur në datat **9-13 prill**, në Beograd, Serbi.
- Pjesëmarrja në Forumin Evropian të Mekanizmave Kombëtare për Parandalimin e Torturës, të mbajtur në datat **17-18 Prill**, në Lubjanë, Slloveni si edhe në takimin e Rrjetit të Mekanizmave Kombëtare të Parandalimin e Torturës të Europës Juglindore, në datat **29-30 Maj**, në Podgoricë, Mali i Zi.
- Pjesëmarrja, në kuadër të bashkëpunimit me IOI, në workshopin me temë: “Forcimi i ndjekjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës”, i fokusuar kryesisht në përgatitjen e rekomandimeve efektive, ndjekja dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve dhe progresi në këtë proces.
- Pjesëmarrja në takimin e dytë rajonal të Mekanizmave për Parandalimin e Torturës, organizuar nga ATP dhe ODHIR në datat **3-4 Dhjetor** në Milano, Itali.
- Avokati i Popullit mbështet iniciativën e sensibilizimit mbi çështjet e trafikimit të Femrave në Shkodër, në këtë aktivitet “Handle with Care” në Shkodër, mori pjesë Komisionerja e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e Torturës **znj. Ermonela Xhafa, në datën 27.10.2018**
- Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në bashkëpunim me OSBE në datat **20-21.12.2018** organizuan Konferencën e Përbashkët. “Përhapja e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në shoqëri është një sfidë e cila në shumë mënyra i prek të gjitha institucionet e shtetit

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2018 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend, si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektive të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.



Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2018 kanë qenë aktivë në mediane dhe shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

#### 4. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kryer **91** vizita, nga të cilat **51** vizita monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2018, dhe **8** ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuessit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve gjithashtu dhe **32** monitorime të operacioneve të riadhesimit.

Aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen e **51** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. (rekomandimet mund të gjeni në faqen e Avokatit të Popullit si vijon <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/police/rekomandime-drejtuar-policis-2017-300/> rekomandimet e komisariateve viti 2018 <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/jails/rekomandime-drejtuar-sistemit-t-burgjeve-2018-295/> rekomandime burgje 2018.

Nga përgjigjet e institucioneve përgjegjëse mbi rekomandimet, rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.
- Kushtet materiale të personave të trajtuar në institucione, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë të vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienë personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara në rregulloret institucionale dhe specifike të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët, për të kryer telefonata, për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin, për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, për procedurat e punësimit dhe shpërblimet për punën e kryer, për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër, të

- drejtën e ushtrimit të riteve fetare, të drejtën për të përfitur ndihmë financiare, etj.)
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese sipas specifikave të institucioneve.
  - Cilësinë e kujdesit shëndetësor, etj.

Për rastet e pretendimeve për tejkalim të forcës apo ushtrim dhunë ndaj personave të privuar nga liria nga ankesat e marra përmes postës e telefonit apo ankesave nga familjarët, MKPT bashkëpunoi në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

#### ***4.1. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare***

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2016 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Vazhdimin e konstatimeve lidhur me kushtet materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, I EVP Sarandë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbipopullimi mbetet një problematikë e sistemit tonë penitenciarë me një mesatare vjetore prej 15-18% mbi kapacitetet. Vërehet një ndikim në uljen e mbipopullimit prej 5%-8% krahasuar me një vit më parë nga një rishpërndarje më adekuate të dënuarve/paraburgosurve në I EVP dhe nga hapja dhe vënia në eficiencë e I EVP Shkodër rikonstruksioni i I EVP “Jordan Misja”. Megjithatë problematike paraqitej situata në I EVP-të Lezhë, Krujë, Rrogozhinë, Tepelenë, “Jordan Misja”, Drenovë, Durrës, Vlorë e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, një pjesë e I EVP-ve ka aplikuar shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që kishte sjellë si pasojë cenimin e standardeve të hapësirës jetike për person. Në disa prej I EVP-ve situata paraqitej edhe më problematike, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit ambientet e aktiviteteve të përbashkëta, observimi e izolimi ishin kthyer në ambiente banimi. Ndërkohë, veçanërisht shqetësuese paraqitej situata në seksionin e veçim-observimit të I EVP Rrogozhinë, ku pjesa dërrmuese e personave qëndronin në këtë sektor në kushte degraduese dhe për ta ishte e pa mundur realizimi i ajrosjes dhe aktiviteteve sipas parametrave ligjore.
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP Krujë etj, në kushte materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër

dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale.

- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në I EVP Lezhë, Lushnje, Tepelenë, Sarandë dhe Rrogozhinë, nuk ofrohet arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, nuk ofrohet arsimi i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Përjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të ri konstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar Shqiptarë.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të I EVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social të cilat ndonëse mundohen t'i realizojnë realisht nuk arrijnë t'i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP-të e reja si Vlorë, Berat, Fier, Durrës, Elbasan dhe Shkodër, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha I EVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.

- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.
- Mungesat në dollapë e raftë të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshet kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, Sarandë, Kukës, Rrogozhinë e Tropojë.
- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të I EVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thuajse në të gjitha I EVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Ndërsa në I EVP Burrel për punën e kryer nga të dënuarit /paraburgosurit nuk jepej asnjë formë shpërblimi.

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

### ***Shqyrtimi i rasteve individuale gjatë inspektimeve të referuara nga Seksioni i Veçantë lidhur me ankesat e të dënuarve/paraburgosurve***

Gjatë inspektimeve të vitit 2018 janë paraqitur dhe pranuar dhe ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve/paraburgosurve.

Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me: *cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzimin e kërkesës për të përfutuar leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për t’u transferuar në një I EVP tjetër; transferimin e padrejtë në një I EVP tjetër; pretendimet për ushtrim dhune fizike, psikologjike dhe keqtrajtim; dhënia e padrejtë e masës disiplinore.*

Ankesat që kanë të bëjnë me cilësinë e **shërbimit shëndetësor** vazhdojnë të jenë të shumta në numër. Gjykojmë se mbipopullimi i lartë ka bërë që administrata e burgjeve të mos i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të të burgosurve për trajtim mjekësor. Gjithashtu në disa I EVP është konstatuar mungesë e mjekut, pavarësisht se në organikë parashikohet të ketë një të tillë, pasi ky vend pune nuk është i pëlqyer. Disa mjekë që fillojnë detyrën në I EVP, pas një farë kohe japin dorëheqjen.

**Të burgosurit duhet të vuajnë dënimin në një institucion sa më afër vendbanimit të familjes.** Ky është një nga kriteret kryesore ligjore për përcaktimin e I EVP-së ku i burgosuri duhet të vuajë dënimin. Nga hetimi i rasteve kur është pretenduar se po zvarritej procedura për të dërguar të burgosurin në një I EVP më afër vendbanimit të familjes, ka rezultuar se shkak i vonësës ka qenë mbipopullimi. Hapja e I EVP Malësi e Madhe (Reç) ka bërë që të plotësohen disa nga kërkesat e të burgosurve për të vuajtur dënimin në një I EVP afër vendbanimit të familjes. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, DPBurgjeve na ka kthyer përgjigje se arsyeja e transferimit të të burgosurit në

një I EVP larg vendbanimit të familjes ka qenë siguria e tij për shkak të konflikteve me të burgosur të tjerë apo cënimi i rendit në I EVP. Nga ana jonë është e vështirë të provohet nëse me të vërtetë arsyeja e transferimit ka qenë siguria e të burgosurit apo ndëshkimi i tij për shkak të sjelljes në institucion. Megjithatë është kryer një punë hetimore lidhur me bazueshmërinë e informacionit të përpiluar për të motivuar transferimin. Nga hetimi që kemi kryer lidhur me transferimin e disa të burgosurve nga I EVP Lezhë në I EVP të tjera, kemi arritur në përfundimin se arsyeja e transferimeve nuk ishte e bazuar. Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i është rekomanduar transferimi i të burgosurve në një I EVP më afër vendbanimit të familjes.

**Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese** ka qenë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave të të dënuarve për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por vetëm për të verifikuar procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi i këtyre rasteve ka rezultuar se, arsyeja e refuzimit të tyre ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka patur garanci nëse jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të cenohej gjatë lejes ose i dënuari mund të cenonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të verifikojë informacionin që përfitohet në rrugë operative apo konfidenciale. Gjithsesi vlerësimi i dhënë për këto raste ka një dozë të shtuar subjektiviteti.

Në lidhje me **shpërblimin e punës të të burgosurve**, siç kemi informuar edhe më parë, që më datë 04.03.2013 i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt VKM-së për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. *Ky rekomandim nuk është zbatuar dhe puna e të burgosurve vazhdon të mos paguhet.* Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohej sipas neneve 34,35, të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Në nenin 34 të ligjit të cituar më sipër ndërmjet të tjerave parashikohet se: “Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.”

Megjithëse në nenin 76 të këtij ligji parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore në zbatim të tij brenda tre muajve nga hyrja në fuqi, deri më tani nuk është nxjerrë e miratuar VKM-ja lidhur me kriteret për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Avokati i Popullit thekson se puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor<sup>5</sup>, ka shumë vite që nuk është miratuar

Burgjet nuk janë vendi i duhur për të burgosurit me **probleme të shëndetit mendor**. Akoma nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Që në vitin 2012, Avokati i Popullit i ka dërguar një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hapja e një institucioni të ri mjekësor për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjekësore “mjekim të detyruar”. *Ky rekomandim nuk ka gjetur zgjidhje.* Në përgjigjen e fundit që kemi marrë nga DPB jemi vënë në dijeni se, po përshtaten dy godina në I EVP Lezhë për të vendosur aty të burgosurit me probleme të shëndetit mendor që mbahen aktualisht në I EVP Krujë. Në

---

<sup>5</sup> Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

përfundim të rikostruksionit, këto mjedise do të funksionojnë si institucion i posaçëm mjekësor dhe do të kalojnë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

**Ankesat për keqtrajtim, ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga punonjës të Policisë së Shtetit dhe të Burgjeve** janë shqyrtuar me përparësi nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Pretendimet për ushtrim dhune, veçanërisht të dhunës psikologjike, nuk janë të lehta për tu provuar. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 23 ankesa të tilla. Në një rast kemi arritur të provojmë se, disa punonjës të policisë së IEVP Fushë-Krujë, gjatë veprimeve të tyre aktive për të neutralizuar një të dënuar me sjellje të dhunshme, kishin humbur vetëkontrollin duke e tejkalar minimumin e mundshëm të përdorimit të forcës dhe duke shkelur parimin e proporcionalitetit, sepse intensiteti i forcës kishte qenë më i madh se sa intensiteti i rezistencës së të dënuarit. Për shkak të këtij intensiteti, i dënuari kishte pësuar dëmtime në pjesë të ndryshme të trupit. Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti arritëm në konkluzionin se, nga punonjësit e Policisë së Burgjeve të IEVP Fushë-Krujë ishin konsumuar elementët e veprës penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”. Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, iu rekomandua fillimi i hetimeve ndaj punonjësve përgjegjës. Organi i prokurorisë na ka informuar se për këtë rast ka filluar procedimin penal.

**Vetëvrasjet** në burgje janë ngjarje që shpesh kalojnë pa shumë bujë. Institucioni i Avokatit të Popullit, i vënë në dijeni nga media, ka nisur me iniciativë hetimin e rasteve të vetëvrasjeve në burgje për të kuptuar nëse këto ngjarje mund të parandaloheshin. Në përfundim të hetimit të një vetëvrasje të ndodhur në fund të vitit 2017 në IEVP Lezhë, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Lezhë marrjen e masave për parandalimin e vetëvrasjeve. Mungesat në organikën e personelit shëndetësor dhe social ndikojnë në cilësinë e shërbimit që ofrojnë këto dy sektorë. Rrjedhimisht zvogëlohet edhe mundësia për të parandaluar rastet e vetëvrasjeve. Të dënuarit shfrytëzojnë shpesh mundësitë që krijojnë infrastruktura e amortizuar ose jo e ndërtuar sipas standardeve për të kryer aktin e vetëvarjes.

Në datën 18.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka depozituar në Kuvend projektligjin, “*Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”*, të ndryshuar, i cili do të sjellë ndryshime në të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve që akuzohen apo janë dënuar për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Këto të burgosur do të nënshtrohen një regjimi të posaçëm sipas të cilit veprimet e tyre do të kufizohen më shumë se sa ato të të burgosurve të tjerë. Shqetësimi i vetëm që mbetet për ne është, nëse IEVP-ët në Shqipëri kanë logjistikën e duhur për ta bërë të zbatueshme regjimin e posaçëm duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të burgosurve. Mbetet për tu parë nëse zbatimi i regjimit të posaçëm do të lejojë një nivel minimal të pranueshëm kontakti për të burgosurit dhe nëse aktivitetet sociale, kulturore dhe krijuese do të jenë të mjaftueshme për të zbutur rreptësinë e këtij regjimi.

Një problematikë tjetër e ngritur në vazhdimësi është dhe **çështja e personelit të burgjeve**. Siç kemi raportuar dhe më parë, rekomandimet e dërguara për respektimin e të drejtave të punonjësve të policisë së burgjeve janë pranuar por, nuk po gjejnë zbatim me arsyetimin se nuk ka fonde të mjaftueshme. Në vitin 2018 i kemi rikthyer sërish të drejtave financiare të punonjësve të policisë së burgjeve. Në përfundim të hetimit të ankesave të efektivëve të IEVP “Ali Demi”, i rekomanduam Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe DPB: kompesimin e orëve shtesë të punës të kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festive zyrtare; zbatimin e Kodit të Punës për sa i përket orëve maksimale shtesë që mund të kryhen; pajisjen me uniformë; trajtimin e barabartë ekonomik-financiarë të punonjësve të policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit; ndryshimin e VKM nr.201, dt.

15.03.2017, për të formuluar më qartë rregullat e llogaritjes së shtesës për vjetërsi në punë; rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve; zgjidhjen e problemit të transportit nga vendbanimi në qendrën e punës dhe anasjelltas.

Në përfundim, vlen të theksohet se **rehabilitimi i të burgosurve** është funksioni kryesor i burgjeve. Personat e privuar nga liria duhet të inkurajohen të punësohen duke u shpërblyer në para për punën e kryer. Nëpërmjet programeve dhe shërbimeve ata duhet të ndihmohen të zgjidhin problemet e tyre si, varësia nga përdorimi i substancave narkotike dhe sjellja e dhunshme. Gjithashtu, duhet gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Funksioni rehabilitues i burgjeve është bërë një sfidë më e vështirë me rritjen e popullsisë në burgje dhe buxhetin e pamjaftueshëm. Masa e sigurisë “arrest me burg” dhe dënimi me burg duhet të zgjidhen si alternativë e fundit në sigurimin dhe ndëshkimin e personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël. Trajtimi i punonjësve të burgjeve kërkon vëmendjen e institucioneve shtetërore për ti siguruar atyre kushtet e pune, pagesë dhe kompensim ekonomik të përshtatshme me vështirësinë që paraqet puna në burgje.

#### ***4.2. Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore.***

Inspektimet e kryera në njësitë policore gjatë vitit 2018 kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Aktin e procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dhëna gjatë vitit 2017.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në DPV Tiranë, si dhe në komisariatet ku gjenden ambiente sigurie në varësi të saj. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia, për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë, në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur, në disa komisariate. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Mbajtje dhe trajtim i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-30 ditore, në disa prej ambienteve të sigurisë në strukturat e Policisë së Shtetit.

- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultojnë të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe “Aktit të Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”. Përjashtim bënin ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisaritet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisaritet që duhej të rezultojnë me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, vijon të konstatohet se nuk ishin të mbyllura sipas procedurave përkatëse, me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.
- Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave, në disa drejtori mjeku mungon. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.
- Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.

Gjatë inspektimeve në njësitë policore gjatë vitit 2018 janë administruar ankesa, ndaj Ministrisë së Brendshme dhe organeve të Policisë së Shtetit të cilat i janë referuar për shqyrtim Seksionit të Veçantë. Konstatohet se numri i ankesave ndaj këtyre organeve në vitin 2018 është më i madh se sa numri i ankesave të administruara në vitin 2017.

Objekt i ankesave të qytetarëve ka qenë i larmishëm dhe kanë qenë pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat ose punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, sikurse mund të përmendim: për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë; për trajtim jo human e dinjitoz në mjediset e organeve të policisë ku mbahen, ruhen dhe trajtohen të shoqëruarit ose të arrestuarit/ndaluarit; për shoqërimi të paligjshme; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese të tubimeve; për vendosje të masave administrative të padrejta; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për bllokim sendesh personale; për sigurimin e jetës; për pengim të daljes lirisht jashtë shtetit; për mos dhënie informacioni; për dhënie të përgjigjeve negative ndaj të dënuarve të cilët kanë kërkuar përfitimin e të drejtës për leje shpërblyese; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri; për cenim të marrëdhënieve të punës dhe për transferime të padrejta nga Policia e Shtetit, etj.

Nga shqyrtimi i ankesave të administruara ka rezultuar se disa prej tyre kanë qenë të bazuara dhe konkretisht për ushtrim dhune fizike, për pengim të ushtrimit të të drejtës për tubim, për cenim të marrëdhënieve të punës, etj. Duhet të mbajmë në konsideratë faktin se, shkeljet dhe cenimet e të



drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mos veprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë në cenimin e imazhit të këtyre organeve në publik dhe për rrjedhojë cenojnë rëndë besimin e publikut tek ato.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend e të drejtave të shkelura qytetarëve, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

#### ***4.3 E drejta e shtetasve për të mos iu cenuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet***

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar disa ankesa të bërë nga shtetas të ndryshëm të cilët pretendonin për sjellje jo korrekte të punonjësve të policisë në rastet e kapjes së persona në kërkim si autorë të dyshuar të veprave penale, kur kanë shkelur rregullat e parashikuara në dispozitat e Kodit Rrugor, apo gjatë kontrolleve rutinë që bëjnë policia në lokale, mjedise të tjera dhe në rrugë. Në vend që punonjësit e policisë të sillen me korrektesë dhe etikë, i fyejnë dhe dhunojnë ata, apo ushtrojnë forcë fizike dhe i lidhin me pranga pa qenë nevoja. Sikur të mos mjaftonin vetëm këto, dhe me qëllim justifikimin dhe mbulimin e veprimeve të kundërligjshme, punonjësit e policisë bëjnë kallëzime dhe i arrestojnë ata për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” dhe atë të “Goditjes së punonjësit të policisë”. Pas arrestimit, kur dërgohen në gjykatën përkatëse për vleftësim dhe caktim të masës së sigurimit, duke mos pasur prova për pafajësinë e tyre, gjykata i vlerëson të ligjshëm arrestimet në flagrancë dhe ndërkohë ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg”.

Në një rast, pas kryerjes së hetimeve administrative dhe marrjes së deklarimeve të dy dëshmitarëve të pranishëm shtetasve A. C. dhe L. F., është mundur që të provohet se arrestimi i shtetasit D.D. ishte bërë në mënyrë të kundërligjshme, sepse ai nuk kishte kryer asnjëherë nga veprat penale për të cilat ishte arrestuar nga policia dhe nuk kishte kundërshtuar apo goditur punonjësit e policisë. Arrestimi i D.D. ishte bërë për arsye të justifikimit të dhunës së ushtruar ndaj tij nga punonjësit e policisë të strukturës operationale të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërkohë nga verifikimet e bëra rezultoi se ankuesi kishte bërë kallëzim në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë. Nga punonjësit e SHÇBA-së kallëzimi i bërë nga ankuesi dhe materialet e tjera procedurale i ishin referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë. Kjo e fundit kishte regjistruar procedimin penal nr. 3120, datë 20.04.2018 për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Pas fillimit të procedimit penal, prokurori i çështjes e kishte deleguar atë për kryerjen e hetimeve në Drejtorinë e SHÇBA-së Tiranë. Më vonë, në datën 18.05.2018, prokurori i çështjes kishte vendosur bashkimin e procedimit penal nr. 2927 të vitit 2018 për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” me procedimin penal nr. 3120, datë 20.04.2018, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” dhe hetimin e tyre në një procedim të vetëm.

Bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm në këtë ngjarje, në faktin që i arrestuari D. D. natën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje nuk kishte përdorur pije alkoolike dhe ishte një person me përmasa dhe peshë trupore të imta, si dhe numrit të madh të punonjësve të policisë rreth 10 persona, gjykojmë se ai

nuk ka pasur arsye për të kryer veprat penale për të cilat ishte arrestuar. Përveç këtij fakti, ankuesi ishte dhunuar fizikisht nga njëri prej punonjësve të policisë, ndërkohë që nga hetimi ynë administrativ nuk na rezultoi që të ketë qenë e nevojshme as përdorimi i forcës ndaj tij.

Ndodhur në këto rrethana, kur për të njëjtën ankesë dhe ngjarje organi i prokurorisë kishte filluar procedimin penal ndaj punonjësve të policisë për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, vendosëm që të mos i drejtohem këtij organi me rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë. Ndërkohë është vënë në dijeni SHÇBA-në Tiranë për faktet e administruara nga ana jonë dhe deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm. Është detyrë dhe e drejtë e organit të prokurorisë që të bëjë një hetim profesional, objektiv, të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me procedimin penal të filluar ndaj punonjësve të policisë, si dhe ndaj të arrestuarit D. D.

Megjithatë, nisur nga kjo ankesë, por edhe disa ankesa të tjera të ngjashme, gjykuam që këto raste duheshin vlerësuar seriozisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Për këto arsye ishte nevojë imediate që punonjësit e policisë të edukohen e trajnohen që të sillen dhe komunikojnë me qytetarët me etikë, durim dhe profesionalizëm. Ata duhet të tregohen të kujdesshëm që në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative, të mos bëhet shkak për ndodhjen e incidenteve të pahijshme deri në kryerjen e veprave penale, si ato të cituara më sipër nga punonjësit e policisë, apo më keq akoma që, për të justifikuar një veprim të paligjshëm të tyre ndaj qytetarëve, të bëjnë kallëzime të rreme. Kjo mënyrë sjelljeje e disa punonjësve të policisë vjen në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se: *“Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”*. Gjithashtu ajo vjen në kundërshtim edhe me nenin 94 të këtij ligji i cili parashikon se: *“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave....”*

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, iu rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

- 1. Fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë të strukturës operacionale të DVP Tiranë nga Drejtoria e Performancës dhe e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
- 2. Nxjerrjen e përgjegjësive, dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.*
- 3. Trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë së shtetit me synimin respektimin e të drejtave të shtetasve, sjelljes së tyre me etikë gjatë përmbushjes së detyrave dhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit nëse lind nevoja e përdorimit të forcës konform nenit 123 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.*

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u informuam se rekomandimi u mirëprit dhe u pranua, dhe se kishte filluar hetimin disiplinor për të gjithë punonjësit e policisë të përfshirë në këtë ngjarje. Pas përfundimit të hetimit disiplinor, problematika e konstatuar do të përgjithësoheshin me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen dhe njëkohësisht do të mbaheshin në vëmendje për tu trajtuar edhe në trajnimet e vazhdueshme të punonjësve të Policisë së Shtetit.

#### ***4.4. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare ndjekur hetuar nga ana e MKPT-së gjate vitit 2018***

Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, ankesave nga familjarët apo nga mediat MKPT ka bashkëpunuar në kryerjen e hetimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Duhet theksuar se kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për të mos ju nënshtuar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250).

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2018 ka filluar me iniciativë ndjekjen e rastit të bërë publik në media për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë ndaj shtetasit N.B, me dt.18.04.2018. Në këtë kuadër është kryer një hetim të pavarur administrativ nga ana e Avokatit të Popullit, në vijim të së cilit janë kryer një sërë procedurash. Janë marrë shpjegimet me proces-verbal të qytetarit N.B, i cili gjithashtu nga ana e tij ka regjistruar në vijim një ankesë individuale pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ky rast është pranuar nga ana e Prokurorisë dhe në përfundim të hetimeve dhe ndjekjes penale është dërguar për gjykim pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë me të njëjtat prova dhe argumente sipas Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

#### ***4.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra***

#### *4.5.1. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç*

Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç në datën 25.09.2018, nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave, në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin. Inspektimi u zhvillua sipas plani vjetor të inspektimi, miratuar nga Avokati i Popullit. Gjatë inspektimit u konstatua se vijonin po të njëjtat problematika të konstatuara në inspektimin e vitin 2017. Gjatë vizitave të shpeshta monitoruese dhe hetuese në këtë Qendër ka patur ankesave të shumta mbi trajtimin e shtetasve të huaj në të.

Kjo Qendër përbëhej nga një godinë dy katëshe, me një pjesë të parashikuar për zyra administrative dhe pjesa tjetër për regjim me 25 dhoma akomodimi, 4 dhoma veçimi, bibliotekë, lavanteri, dushe, ambient rekreacioni, magazina dhe ambiente ajrosje të jashtme. Në këtë Qendër kishte katër ambiente veçimi, të cilat ishin me kubaturë dhe hapësirë të mjaftueshme, dritare me përmasa të cilat lejojnë ajrosjen dhe futjen e dritës natyrale.

Për të huajt femra dhe të miturit, kishte një sektor të veçantë, i cili ishte i ndarë nga sektori i meshkujve. Në rastet kur të huajt e strehuar ishin me familjet, ata akomodoheshin së bashku në ambiente të veçanta.

Kapaciteti zyrtar i kësaj Qendre është për 100 persona. Në mjediset e institucionit në kohën e inspektimit ndodheshin 71 persona, nga të cilat 67 meshkuj dhe 4 femra. Koha e qëndrimit të tyre në këtë Qendër është 1-3 muaj.

Pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me inspektimin, grupi i inspektimit inspektoi ambientet e kësaj Qendre. Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambienteve të kësaj Qendre ishte e pandryshuar si inspektimin e zhvilluar më parë në vitin 2017, ishin fokusuar kryesisht në mënyrën e trajtimit të një shtetasi të huaj afgan dhe përgjithësimin e këtij rasti me qëllim shmangien e rasteve të mëtejshme të shkeljes të të drejtave të njeriut.

Gjatë vizitës grupi inspektues u takua me personat e huaj që ndodheshin në këtë Qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale. Nga biseda e bërë me ta, nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga punonjësit e Policisë së Shtetit apo nga personeli civil që shërbente në këtë Qendër.

Problematikë kishte vetëm për një person që ishte akomoduar në këtë Qendër dhe ishte nën moshën 16 vjeç. Lidhur me këtë rast rekomanduam që duhet të merren masat e domosdoshme për ekzaminimin dhe identifikimin shkencor të moshës reale të të miturve të pa shoqëruar dhe trajtimin e diferencuar të tyre sipas standardeve ndërkombëtare.

Disa ankesa u morën për cilësinë e jetës në institucion. Ankesa kishte edhe për mos respektimin e ajrimit për 2 orë të parashikuara, si edhe mungesën e aktiviteteve rekreative. Komunikimi me botën e jashtme i tyre përmes aparateve kartofonike, ende nuk ishte mundur. Gjithashtu mungesa u konstatuan në ambientet e katit të parë të Qendrës.

Ankesa kishte edhe për trajtimin ushqimor, si jo i shumëllojshëm dhe i pa mjaftueshëm. Nga verifikimi i menisë javore në kuzhinë u konstatua se ajo ishte shumë e varfër dhe e papërditësuar. Trajtimi me

ushqim i të huajve bëhej në bazë të normativave të miratuara <sup>6</sup>. Nga intervista me stafin u bëmë me dije se numri i ndryshueshëm i shtetasve të trajtuar në Qendër e vështirëson gatimin me sasinë e parashikuar të asortimenteve për kuotë.

Të ndaluarit paraqitën ankesa lidhur me pamundësinë për t'u informuar me ngjarjet, që ndodhin nga vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë, sepse televizorët nuk ishin të lidhur me pajisje satelitore.

Po ashtu, ankesa dhe pretendime lidhur me shërbimin shëndetësor që ofrohet në këtë Qendër, mungesën e stafit psiko-social pasi mungojnë katër persona që duhet të punësohen në këtë sektor, si edhe atë të sigurisë, që duhet të monitorojë dhe garantojë mbarëvajtjen dhe ruajtjen e qetësisë në ambientet e Qendrës.

Të huajt e ndaluar dhe akomoduar në këtë Qendër kanë të drejtën të përfitojnë asistencë individuale mjekësore, ligjore e sociale<sup>7</sup>. Nga inspektimi u konstatua se sektorët shëndetësor, psiko-social dhe ligjor kishin mangësi dhe për rrjedhojë cenoheshin standardet e trajtimit të kësaj kategorie. Në organikën kësaj Qendre në stafin psiko-social dhe juridik nuk janë parashikuar pozicione për psikolog dhe jurist, të cilët janë të domosdoshëm për të përmbushur të drejtat e parashikuara në pjesën e pestë të VKM-së së sipërcituar. Këto funksione në kohën e monitorimit kryheshin nga punonjësja sociale dhe stafi drejtues.

Nga inspektimi u konstatua se në hollët dhe ambientet e tjera nuk kishte të afishuara postera me të drejtat e personave të huaj të ndaluar në këtë Qendër. Sipas punonjësve të policisë, ishin vendosur postera, por ato ishin grisur nga të ndaluarit.

Autoritetet duhet të vënë në dispozicion dokumentacionin gjithëpërfshirës për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë Qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuesit dhe grupet vulnerabël.

Sistemi i pritjes dhe i kontrollit fizik për pritjen dhe intervistim e të huajve kryhej konform Rregullores së Përgjithshme dhe asaj të Brendshme. Në Qendër ishin hapur dosjet personale të të huajve të ndaluar, regjistri i pranimeve, regjistri i takimeve, regjistri i hyrje/daljeve, regjistri i marrjes-dorëzimit të shërbimit, si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të sendeve personale dhe të vlerave monetare.

Ambienti ku depozitoheshin vlerat monetare dhe sendet personale funksiononte sipas Rregullores. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit nuk u konstatuan parregullsi. Të gjitha veprimet që kryheshin me të huajt lidhur me sendet personale dhe vlerat monetare regjistroheshin në regjistrin përkatës.

**Lidhur me çështjen e sigurisë**, Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç, ishte e pajisur pjesërisht me kamera vëzhgimi si në mjediset e jashtme ashtu dhe në ambientet e brendshme. Sistemi i monitorimit

---

<sup>6</sup> Urdhri i përbashkët i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Urdhrit të DPP-së nr.1812/1, datë 26.08.2010 dhe VKM nr.702 datë 21.08.2013 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të gardës së republikës, të punonjësve të policisë së shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkollat e policisë së shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre”.

<sup>7</sup> Në bazë të VKM nr.1083 datë 28.10.2009 “Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të saj” dhe Rregullores së Brendshme të Qendrës, miratuar me Urdhrin nr. 117, datë 09.02.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

nuk funksiononte për shkak të defekteve, ndonëse ishte kërkuar disa herë riparimi dhe vënia e tij në funksionim. Gjithashtu zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve nuk funksiononin.

Sistemit të kërkesë/ankesave kishte një regjistër ku pasqyroheshin kërkesat dhe ankesat e të huajve. Regjistri përmbante rubrika të specifikuar mbi ankesën dhe zgjidhjen e saj dhe i referoheshin punonjësës sociale apo punonjësit të sigurisë, të cilët merrnin masa për të njoftuar drejtorin e institucionit dhe zgjidhjen e menjëhershme të ankesës.

Vizitat nga familjarët, avokatët, përfaqësuesit diplomatikë etj., kryheshin sipas parashikimeve në Rregullore dhe regjistroheshin në regjistrin përkatës.

Kushtet e strehimit në këtë Qendër ishin brenda normave të parashikuara. Gjithsesi, sektori i katit të parë paraqiste probleme të kushteve sanitare dhe materiale. Dhomat ishin të pajisura edhe me ndriçim artificial. Nuk u konstatua prania e insekteve apo brejtësve. Në rastet e mungesës së energjisë elektrike nga rrjeti, ndriçimi artificial sigurohej nga një gjenerator.

Problem shqetësues përbënte ngrohja e ambienteve të Qendrës, sepse ndonëse ishte instaluar sistemi i ngrohjes me kaldajë, ai nuk ishte vënë në funksionim pasi shpenzonte shumë karburant dhe nuk kishte fonde për përbalimin e këtij shpenzimi.

Të huajve, për ruajtjen e higjienës personale iu jepeshin detergjentë si sapun, shampo, ilaç rrobash, furça dhe pastë dhëmbësh.

Pati ankesa lidhur me furnizimin me material higjienike në katin e parë të Qendrës pasi disa banues në këtë sektor kishin përdorur këto material në një formë vetëlëndimi si një mënyrë pakënaqësie ndaj mbajtjes së tyre në një Qendër të mbyllur.

Larjet e trupit bëheshin me grafik në 2 duset e përbashkëta, të cilat ishin të pajisura me bojlerë për të mundësuar ujin e ngrohtë. Lavanteria kishte një lavatriçe për të gjithë të huajt e ndaluar, e cila ishte e pamjaftueshme në rastet kur numri i të huajve në Qendër ishte me kapacitet të plotë.

Kishte një mjedis ambulator (dhoma e kryeinfermierit), e cila ishte e pastër dhe e pajisur me orënditë e nevojshme, si krevat, tavolinë dhe karrige.

Sipas stafit, ambienti i ajrimit përdorej edhe për lojëra sportive, por fusha ishte e papërshtatshme për zhvillimin e lojërave me top. Nga punonjësit e Qendrës u konfirmua se po punohej për krijimin e një fushe sporti. Ndërkohë u konstatua se nuk kishte një kënd lodrash për fëmijët.

Qendra e mbyllur kishte një bibliotekë, e cila kishte literaturë fetare, por ishte e varfër me botime në gjuhën arabe, si dhe në literaturë juridike.

Grupi inspektues konstatoi se ajrimi i të ndaluarve dhe zhvillimi i aktiviteteve argëtuese e sportive nuk bëhej sipas rregulloreve në fuqi. Ajrosja dhe aktiviteti sportiv ishte i pamundur si rrjedhojë e mosfunksionimit të mbulimit me kamera mungesës së personelit të sigurisë si dhe e pamundësisë financiare për të përshtatur ambientet e jashtme me sigurinë e duhur për këto qëllime.

Në Qendër kishte një ambient kulti, si dhe ishte krijuar edhe një ambient faljeje për praktikantët e besimit mysliman.

Grupi i inspektimit konstatoi se kuzhina e Qendrës dhe mensa ishin të pastra dhe orënditë e sistemuara. Mensa kishte tavolina dhe karrige të mjaftueshme për kapacitetin e Qendrës, ndërsa në kuzhinë mungonte lavastovilja dhe pajisje apo materiale të tjera lehtësuese.

Në këtë Qendër nuk kishte njësi tregtare për të mundësuar blerjen e artikujve të ndryshëm nga personat e strehuar në këtë Qendër.

Sipas organikës së miratuar, Qendra kishte vetëm specialistë për pranim dhe intervistim, por nuk kishte specialitete të tilla tepër të rëndësishme për natyrën e funksionimit të saj, si psikologë, edukatorë dhe juristë. Programet e punës me plan të miratuar nga stafi social mungonin pasi aktualisht ishte vetëm një punonjëse e cila ishte multi funksionale në ndjekjen e problematikave të të huajve.

Në këtë Qendër vijnë persona me trauma të tipeve të ndryshme, familje të shpërngulura nga vende në gjendje lufte etj., stafi psiko-social duhet të jetë konform parashikimeve ligjore në Rregulloren për Qendrën e Mbyllur për të Huajt, me qëllim përmirësimin e gjendjes së tyre psikologjike gjatë qëndrimit të tyre në këtë Qendër.

Lidhur me paraqitjen e ankesave dhe rrugën që ndiqet për zgjidhjen e tyre, grupi inspektues u informua se kishte kanale komunikime me UNHCR, ku personat e strehuar në Qendër mund të drejtoheshin dhe referonin problemet e tyre.

Në organikën e Qendrës së mbyllur nuk kishte mjek, por ndihmësmjek. Gjithashtu nuk kishte as stomatolog. Në rast nevojë, të huajt dërgoheshin tek stomatologu privat. Ndhimësmjeku kryente vizitat e të gjithë personave që në momentet e para sapo ata ndaloheshin në këtë Qendër dhe në mënyrë periodike në vijimësi. Në rastet kur kërkoheshin ekzaminime të specializuara apo të sëmundjeve infektive, të huajt dërgoheshin në Spitalin Rajonal Durrës, apo trajtoheshin nga Sektori i Higjienës, pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Në rastet emergjente përdoreshin makinat e Qendrës për transportimin e të huajve pranë qendrave spitalore.

Sipas ndihmësmjekut, Qendra nuk kishte probleme lidhur me furnizimin me medikamentet mjekësore të nevojshme.

Nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se ekzistonin dy regjistra, njëri i vizitave dhe tjetri i mjekimit të cilat ishin plotësuar me rregull.

Përmes raportit me rekomandime pas vizitës në këtë Qendër, MKPT-ja i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit Kufirit dhe Migracionit që : të merren masat e nevojshme për respektimin e të drejtave themelore të njeriut si gjatë praktikave të identifikimit dhe regjistrimit ashtu dhe gjatë zhvendosjes dhe riatdhesimit të të huajve, marrjen e masave të nevojshme për shtimin e stafit të kësaj Qendre me një punonjës social, një psikolog, një jurist, dhe një punonjës sanitar, marrjen e masave që grupet vulnerabël duke përfshirë të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e trafikimit, të mos qëndrojnë për periudha të zgjata në Qendër, por të transferohen sa më shpejt në qendra strehimore të specializuara, Marrjen e masave të nevojshme për të krijuar ambientet rekreative të brendshme e të jashtme të Qendrës me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive dhe për ndërtimin e një këndi lojërash për fëmijët për të mundësuar trajtim dinjitoz të tyre, marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksionim të sistemimit të monitorimit me kamerave të perimetrit të brendshëm, duke shtuar kamera në hollët dhe korridoret e godinës, si dhe në korridoret e ambienteve të veçimit, ,marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksionim të sistemimit të njoftimit me zilet e emergjencës , marrjen e masave të nevojshme për pasurimin e bibliotekës, marrjen e masave të nevojshme për vendosjen në ambientet e Qendrës të posterave, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të ndaluar aty, marrjen e masave për të pajisur ambientet e kësaj qëndre me aparate kartofonike, sikurse është parashikuar në rregulloren e institucionit, marrjen e masave për pajisjen me televizorë të ambienteve të përbashkëta të brendshme, si dhe lidhjen me antenë satelitore për të mundësuar informimin e të huajve me ngjarjet që ndodhin nga vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë.

Marrja e masave për pajisjen e kuzhinës së institucionit me mjete gatimi, aspirimi dhe larje industriale dhe pajisje të tjera të domosdoshme, marrja e masave për sigurimin e një lavatriçeje shtesë në shërbimin e lavanderisë.

#### ***4.6. Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë***

Shqipëria vijon të përballlet me raste të shtuara të hyrjes së migrantëve të huaj kryesisht nga kufiri me Greqinë si pikë hyrëse dhe kufiri me Malin e Zi si pika dalje. Pika e Kakavijës në Gjirokastrë dhe zonat përreth saj shërbejnë si rrugë të depërtimit të migrantëve të huaj. Gjatë vitit 2018, siç është informuar edhe më parë institucioni i Avokatit të Popullit (MKPT-ja) në kuadër Marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR, është përfshirë në monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve dhe forcimin e respektimit të të drejtave të tyre.

Kjo gjë është arritur përmes aktiviteteve të tilla si monitorimi sistematik i kufijve, prezenca gjatë procedurave të përzgjedhjes me personat në fjalë, analizë dhe rekomandime në lidhje me procedurat e mësipërme dhe monitorimin e kufirit, raportim i të dhënave në Zyrën Qendrore dhe UNHCR, kontribut në hartimin e fletëpalosjeve për refugjatët dhe azilkërkesit, bashkëpunim me aktorët dhe pjesëmarrje në aktivitete/evente të përbashkëta.

Gjatë periudhës dhjetor 2017- dhjetor 2018 janë kryer misione monitoruese në brezin kufitar të Qarkut të Gjirokastrës me Greqinë, një pjesë e madhe e të cilëve në bashkëveprim me zyrën e UNHCR-së Gjirokastrë ndërsa një pjesë në mënyrë të pavarur.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTX, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së.

Ekspertët e MKPT-së, ishin pjesë e grupit monitorues të **32** operacioneve të riadhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorimin e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Në përmbushje të misionit të tyre ekspertët e MKPT-së kanë pasur si detyrë funksionale, përveç monitorimit të respektimit të instrumenteve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut edhe monitorimin e respektimit të dinjitetit njerëzor të të gjithë personave pjesëmarrës në operacionin e riadhesimit. Në përfundim të operacioneve të kthimit, vëzhgimet e procesit të plotë të monitorimit janë përfshirë në raportet e institucionin të cilët në raste specifike i dërgohen dhe FRONTX si dhe autoriteteve kombëtare relevante, si Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit në Ministrinë e Brendshme.



## **5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale**

### **5.1 IEVP 325 “ALI DEMI”**

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale 325 “Ali Demi”, më datë 24.05.2018, Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose degradues, (MKPT) zhvilloi një vizitë inspektuese që kishte për objekt vlerësimin e kushteve në këtë IEVP, lidhur me cilësinë e trajtimit të të dënuarve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Në kuadër të ristrukturimit të Institucioneve penitenciare, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, (IEVP) 325 “*Ali Demi*” funksion si institucion i posaçëm për trajtimin e grave të paraburgosura dhe të dënuara dhe klasifikohet si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion për gratë e dënuara dhe një seksion për gratë e paraburgosura dhe me fëmijë deri në moshën 3 vjeç.

Kapaciteti zyrtar i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, (IEVP) 325 “*Ali Demi*”, Tiranë është 80 persona (kundrejt kapacitetit prej 138 personash të deklaruar nga drejtorja e burgut gjatë takimit paraprak). Gjatë monitorimit në institucion trajtoreshin 39 të paraburgosura dhe 61 të dënuara, të vendosura përkatësisht në seksionin e paraburgimit dhe në seksionin e të dënuarave. Në çerdhe kishte një fëmijë të trajtuar. Në seksionin e kujdesit të veçantë ndodhej një person me çrregullime psikiatrike, ndërkohë që në institucion trajtoreshin 8 persona me probleme të shëndetit mendor.

Nga informacioni i grumbulluar në vend përmes kryerjes së intervistave konfidenciale rezultoi se pjesërisht ishin marrë disa masa për të përmbushur rekomandimet e bëra në inspektimet e mëparshme, por ende pesë prej rekomandimeve kryesore nuk kishin gjetur zbatim pavarësisht kohës relativisht të gjatë nga rekomandimi i mëparshëm, dhe konkretisht: nuk ishte siguruar një fond i posaçëm për rikonstruksionin e plotë të godinave të këtij institucioni i cili të mundësonte kushte dhe trajtim të denjë të grave të dënuara/paraburgosura; në korridorin pranë dhomave të veçim/observimit në të dy regjimet mungonte mbulimi me nga një kamera sigurie; nuk ishte kryer hidroizolimi i plotë i të gjitha ambienteve të regjimit të brendshëm dhe riparimi i tualeteve dhe dusheve; dhomat e observim/veçimit nuk ishin riparuar dhe kompletuar me pajisje; nuk ishte siguruar ruajtja në kushte frigoriferike të kampioneve të ushqimit të fëmijëve që mbahen në çerdhen e këtij institucioni.

IEVP 325 “*Ali Demi*”, paraqet një infrastrukturë të amortizuar, mungon autoambulanca dhe se shërbimi stomatologjik nuk ofrohet i plotë pasi mungon autoklava dhe poltroni(unit). Praktikisht shërbimet që ofroheshin ishin mjekime të lehta, por në kushte tejet të papërshtatshme. Gjithashtu nga ana e saj na u bë me dije që rekomandimet e pazbatuara në raportin pararendës të Avokatit të Popullit do të kenë një vëmendje prioritare gjatë punës së saj në vitin në vazhdim.

Në organikën e IEVP 325 “*Ali Demi*”, Tiranë stafi i edukimit përbëhej nga katër vetë: një përgjegjës sektori dhe tre edukatorë. Vendi i një edukatori nuk ishte i plotësuar. Gjithashtu organika kishte një mjek, një stomatolog, një farmacist dhe katër ndihmësmjekë. Vendi i farmacistit nuk është i plotësuar.

Nga informacioni i marrë, grupi inspektues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo ushtrimi të dhunës fizike.

Gjatë inspektimit u konstatua se ankesat më të shumta vinin në drejtim të kushteve tejet të amortizuara të godinave dhe lagështirës, kryesisht në sektorin e paraburgimit.

Ambientet e përbashkëta të vizituara në paraburgim janë: dhoma e takimit me familjarët; dhoma e takimit me avokatin, dhomat ku mbahen të burgosurat me masë disiplinore “*përrjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta*” (veçimi), tualetet, dushet, lavamanët, biblioteka, dhoma e kultit, mensa, infermiera, fusha ku luhen lojëra me top. Dhoma e takimit me familjarët dhe dhoma e takimit me avokatin ishin të pastra dhe të lyera si dhe kishin ndriçim natyral të bollshëm.

Në ambientet e veçimit kishte 3 dhoma për mbajtjen e të paraburgosurave me masë disiplinore. Dhomat u gjetën të lyera me gëlqere, të pastra dhe të pajisura vetëm me një krevat hekuri. Dhoma mbyllej me derë hekuri me shul me një dritare të vogël të bllokuar me zgarë hekuri. Ndriçimi natyral mundësonte leximin, deri në një pjesë të caktuar të ditës ndërsa ndriçimi artificial nuk sigurohej i plotë pasi llamba ishte vendosur për arsye sigurie jashtë dhomës.

Tualeti i veçimit ishte me sipërfaqe të vogël dhe kishte dush dhe tualet. Bojleri dhe lavamani ishin vendosur në korridorin e dhomave ku edhe kryhej ajrimi i të burgosurës të veçuar. Duke konsideruar dhe mungesën e orendive bazë të jetesës (karrige tavolinë) në ambientet e veçimit kjo situatë trajtimit në këto ambiente mund të konsiderohen trajtim degradues dhe jo human i personave të vendosur përkohësisht në këto ambiente dhe duhet të ndryshojë menjëherë.

Gjithashtu në sektorin e paraburgimit ambienti u gjet i pastër, pavarësisht strukturës së amortizuar. Sipas punonjëses së regjimit, tualetet-të dezinfektohen me klor dy herë në javë .

Dushet kishin gjashtë bokse për larje. Ambienti u gjet i pastër pavarësisht strukturës së amortizuar. Grafiku i larjes ishte i afishuar në hyrje të korridorit dhe sipas ndarjes së dhomave, çdo të burgosurë i takonte të lahej tre herë në javë. Lavanderia u gjet e pastër dhe përdorej rregullisht, pavarësisht strukturës së amortizuar.

Biblioteka u gjet e lyer dhe e pastër. Dritaret mundësonin ndriçim natyral të mjaftueshëm për të lexuar dhe punuar. Ajo ishte e pajisur me orendi: tavolina, karrige dhe rafte druri të mbushura me libra. Në bibliotekë kishte gjithashtu televizor ku shfaqeshin filma dhe 7 pajisje kompjuteri, të cilët përdreshin gjerësisht nga të dënuarat. Numrat e kontaktit me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit ishin afishuar të dukshme në mur.

Dhoma e kultit u gjet e pastër, e lyer dhe e pajisur me orendi. Në këtë ambient zhvillohej çdo ditë aktivitet fetar. Mensa nuk ishte e pajisur me orendi dhe nuk përdorej për konsumimin e vakteve nga të burgosurit. Në këtë ambient pritej të kryheshin punime me fonde të siguruara nga një subjekt privat. Të dënuarat e konsumonin ushqimin brenda ambienteve të dhomave të tyre.

Infermiera u gjet e pastër, e lyer dhe e pajisur me orendi: dy shtretër dhe dy rafte për mbajtjen e medikamenteve.

Procedura e pranimit në institucion bëhej në përputhje me legjislacionin në fuqi. Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht, me dokumentim të rregullt të të gjithë procedurës së ndjekur nga stafi i këtij institucioni. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjeku bënte pjesë në Komisionin e pritjes.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të institucionit, dy dhomat e takimit me familjarët u gjenden në të njëjtat kushte si dy vite më parë, ku amortizimi dhe lagështira ishin evidente, si në gjithë ambientet e regjimit të brendshëm. E njëjta situatë paraqitej edhe në dhomat e observim/veçimit të cilat vazhdonin të rezultonin problematike, si për sa i përket hapësirës jetike ashtu dhe kushteve materiale brenda këtyre ambienteve.

Kontakti me botën e jashtme ishte i garantuar. Të dënuarat/paraburgosurat mund të takoheshin me familjarët e tyre sipas rregullores në fuqi. Për takimet me të mitur mundësohej takim i zgjatur deri në dy orë. Ambientet e takimit me familjarët ndodheshin përkatësisht përpara hyrjes në regjim. Ato ishin pa hekura apo xhama ndarës e të pajisura me tavolina dhe karrige, por në kushte amortizimi si gjithë godinat e institucionit. Në to ishin vendosur edhe disa lodra për fëmijët e mitur. Ambienti i takimit me avokatët ishte i veçantë, nga ai i takimit me familjarët dhe ishte i pajisur me tavolinë dhe karrige.

Sistemi i monitorimit me kamera ishte në funksion të plotë dhe ishin rregulluar dhe dy kamerat të cilat kishin qenë jashtë funksionit, megjithëse nevojitej shtim i tyre në dhomat e observim/veçimit ku mungonte mbulimi me kamera vëzhguese. Kamerat ofronin qartësi në pamje nga këqyrja e tyre në monitorët përkatës.

Sistemi i kërkesë/ankesave administrohej nga sektori i edukimit, ankesa që kishin të bënin më shumë me proceset gjyqësore, masat e sigurisë dhe dënimet e dhëna nga gjykatat. Në bibliotekën e regjimit të femrave ishte një kuti, e cila shërbente si për letrat që vinin apo dërgoheshin nga të dënuarat/paraburgosurat, ashtu edhe për kërkesat dhe ankesat e tyre.

Të gjitha gratë që vuanin dënimin në këtë institucion pohuan faktin se mund të kryenin 4-5 telefonata në muaj me familjarët e tyre nëpërmjet telefonit me kartë, që ndodhej në mjedisin e regjimeve përkatëse (3 telefona funksionalë në secilin prej regjimeve pranë të cilëve ishte dukshëm i afishuar edhe numri i Avokatit të Popullit).

Ashtu siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në të dy regjimet vijon të jetë tejet i amortizuar dhe me lagështirë. Vihej re një ndryshim i dukshëm i sektorit të paraburgimit nga ai i burgut, për sa i përket kushteve materiale dhe lagështirës të cilat ishin më të theksuara në regjimin e brendshëm të paraburgimit.

Në këtë IEVP, dhomat e banimit ishin të hapura duke u krijuar mundësi të dënuarave/paraburgosurave të kishin akses me orare të zgjatura ajrimi në oborret e sektorëve përkatës. Mesatarisht në çdo dhomë kishte 4-6 gra. Dhomat e banimit ishin të përmasave të ndryshme, por nuk vihej re mbipopullim.

Përsa i përket pajisjeve grupi inspektues i MKPT-së konstatoi ankesa për mungesa në dollapë, ku të mbanin ushqimet, që merrnin nga familjet e tyre dhe për dollapë për rrobat, kryesisht në sektorin e paraburgimit. Ndriçimi artificial ishte i mjaftueshëm dhe ai natyror i bollshëm falë dritareve të mëdha që lejonin dritën dhe ajrin. Në institucion mungonte sistemi qendror i ngrohjes.

Gjithashtu, **në regjimin e të dënuarave** kishte një godinë, e cila ishte e pajisur mirë dhe shërbente si çerdhe për fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Çerdhja ndiqet nga mjeku, infermieri dhe kujdestari. Në godinën e çerdhes ka dhomë qëndrimi për stafin, tre dhoma qëndrimi për të burgosurat me fëmijë nën moshën tre vjeç dhe një kuzhinë. Një dhomë shërben për prindërimin në distancë për të burgosurat me fëmijë mbi 3 vjeç. Ngrohja realizohej me energji elektrike, me kaloriferë .

Dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme dhe me lodra për fëmijë. Godina e çerdhes ndodhet e veçuar nga dhomat e banimit të të dënuarve dhe në hyrje të janë mbjellë lule.

Çerdhja kishte ambiente të mirë organizuara të ndara në katër dhoma për fëmijë: një dhomë për nëna me fëmijë, një dhomë vetëm për fëmijë, një dhomë lodrash dhe një dhomë për edukatore, të pajisura sipas standardeve me orënditë e nevojshme dhe me materiale shëndetësore e informuese për nënat me fëmijë. Çerdhja kishte një personel prej 5 vetash, të ndarë në 2 edukatore, 2 infermiere dhe një kujdestare.

**Në ambientet e veçimit** kishte 2 dhoma për mbajtjen e të dënuarve me masë disiplinore. Dhomat u gjendën të pastra dhe të lyera. Ato ishin të pajisura vetëm me shtrat hekuri. Ndriçimi natyral nuk ishte i mjaftueshëm, pasi përhapej në dhomë vetëm nëpërmjet dritares së vogël me rrjetë teli të derës. Ndriçimi artificial përhapej i zbehtë pasi llamba ishte vendosur për arsye sigurie në një frëngji në lartësi të murit të mbyllur me zgarë hekuri dhe rrjetë teli. Tualeti ndodhej jashtë dhomave dhe ishte pajisur me tualet allaturka dhe dush. Bojleri ishte vendosur brenda tualetit. Ajrimi kryhej në korridorin e dhomave.

Grupi inspektues konstatoi se dyshemeja ishte e shtruar me pllaka dhe ambienti u gjend i pastër. Sipas punonjësës së regjimit, tualet-të dezinfektohen me klor dy herë në javë. Tualetet dhe dushet, të cilat ishin ndara sipas dhomave vazhdonin të mbeteshin të amortizuara dhe kishin nevojë për riparime/zëvendësime.

Dushet mundësoheshin çdo ditë në këtë institucion. Furnizimi me ujë të ngrohtë i dusheve bëhej çdo ditë. Shtrojat (çarçafët, jastëkët dhe batanijet) në shumicën e rasteve siguroheshin nga familjarët. Pajisjet e hotelerisë, të higjienës personale dhe të përbashkët siguroheshin si nga institucioni, ashtu edhe nga organizata të ndryshme jo-fitimprurëse apo nga familjet e të dënuarave/paraburgosurave.

Kuzhina ishte e pastër dhe e rregullt, me kampionë ushqimorë të ruajtur në kushte frigoriferike dhe me menu javore të afishuar. Cilësia dhe gramaturat e ushqimit ishin të kënaqshme, megjithëse kishte ankesa të veçuara sa i përket mungesës së shumëllojshmërisë të ushqimit. Në të kishte pajisje gatime, frigoriferë për mbajtjen e ushqimeve dhe frigorifer të kyçur me dryna për mbajtjen e kampionëve të ushqimeve që gatuheshin. Në mur ishin afishuar: menyja javore, urdhri i brendshëm nr. 48, dt. 27.04.2018 me listën e të burgosurave diabetike; organika e punës; norma ushqimore.

Në institucion secili sektor kishte nga një bibliotekë, të cilat ishin të mirë pajisura me libra dhe orëndi, tavolina e karrige për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, një TV plazma, si dhe të pasura me libra kryesisht fetarë. Këto 2 ambiente shfrytëzoheshin nga sektori i edukimit për aktivitete të ndryshme që zhvilloheshin në këtë institucion. Biblioteka u gjend e lyer dhe e pastër.

Dritaret mundësonin ndriçim natyral të mjaftueshëm për të lexuar dhe punuar. Ajo ishte e pajisur me orëndi: tavolina, karrige dhe rafte të mbushura me libra. Në bibliotekë kishte gjithashtu televizor ku

shfaqeshin filma dhe një kompjuter funksional. Në mur ishin varur piktura të të burgosurave si dhe ishte afishuar dukshëm numri i kontaktit me Institucionin e Avokatit të Popullit, Komitetin Shqiptarë të Helsinkit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

**Seksioni i kujdesit të veçantë** ndodhej ndërmjet çerdhes, veçimit dhe ambientit të dhomave të banimit të të dënuarve pa probleme të shëndetit mendorë. Ky sektor kishte dy dhoma banimi dhe oborr me gjelbërim. Tualeti i veçimit përdorej edhe nga të burgosurat që vendoseshin në Seksionit të Kujdesit të Veçantë.

Të dënuarat/paraburgosurat mund praktikonin ritet fetare në dy dhomat që ndodheshin në ambientin e paraburgimit, përkatësisht një për fenë myslimane dhe një për fenë katolike/ortodokse. Të dyja dhomat ishin të plotësuara me bazë materiale dhe literaturë të nevojshme për praktikuesit e feve përkatëse. Ato mund ta kryejnë këtë veprimtari kurdo që dëshironin.

Në të dy sektorët, jeta zhvillohej në regjim të hapur. Nga grupi monitorues u vërejt se fryma e kolektivitetit gjatë aktivitete të përbashkëta dhe gjatë kohës së lirë, ndihmonte në formimin e një klime jo konfliktuale.

Në të dy regjimet, në dyert e dhomave ishte i afishuar orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambienteve të përbashkëta të punës edukative e profesionale etj.

Të dënuarat/paraburgosurat ishin të përfshira në aktivitete dhe kurse të cilat ishin në vijim. Gjatë muajit shkurt ishin aktivë kursi i asistencës sociale, dadove, dhe ai i rrobaqepësi/qëndistarisë të organizuara nga Qendra e Formimit Profesional Nr. 1 dhe 4 në Tiranë. Programe aktive ishin programi i prindërimit në distancë për nënat me fëmijë jashtë institucionit dhe programi në prag lirim. Katër herë në muaj zhvilloheshin tema të ndryshme psiko-sociale materialet për të cilat ishin të ruajtura në dosje nga stafi.

**Në sektorin e paraburgimit** kishte një dhomë të posaçme shërbesash fetare, ku të dënuarit besimtarë ushtronin ritet e tyre të besimit dhe merrnin pjesë në lutje të udhëhequra nga udhëheqës shpirtërorë të komuniteteve fetare, që vizitonin sipas një plani të caktuar nga institucioni. Këtë funksion, në regjimin e të dënuarave e kryente biblioteka.

Si shqetësuese në këtë institucion u konstatua çështja e arsimimit të detyrueshëm 9-vjeçar, pasi në momentin e inspektimit u gjendën disa të dënuara të cilat nuk kishin përfunduar këtë cikël shkollor. Në bazë të nenit 43, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar dhe nenit 60 të “*Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*”, i është kërkuar nga ana e I EVP “*Ali Demi*” Ministrisë së Arsimit si dhe Drejtorisë Arsimore, Tiranë, vënia në zbatim të këtij detyrimi ligjor për sigurimin e programit arsimor formal për këtë kategori të dënuarash, por ende nuk kishte një përgjigje për këtë çështje.

Në këtë institucion ishin punësuar disa të paraburgosura, ndërsa kishte edhe të dënuara të cilat punonin si sanitare, magaziniere, rrobaqepëse, punonjëse lavanderie apo sere, etj. Stafi psiko-social, i zhvillonte veprimtaritë e veta kryesisht pranë bibliotekës.

Dokumentacioni i stafit psiko-social ishte i mbajtur me rregull, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit për të dënuarat me probleme të shëndetit mendor, për grup moshat 18-21 vjeç dhe/apo abuzuesit me substanca.

Organika e stafit mjekësor përbëhej nga një mjek, një stomatolog, një farmacist, katër ndihmësmjekë, si dhe çerdhja e institucionit, që përfshinte dy edukatore, dy ndihmësmjete dhe një kujdestare.

Gjatë inspektimit si dhe nga intervistat me të dënuarat/paraburgosurat, mendimi për shërbimin shëndetësor në përgjithësi ishte pozitiv, dhe vlerësohej gatishmëria e stafit si për vizitat mjekësore në institucion, ashtu dhe për konsultat me specialistë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve dhe në QSUT “Nënë Tereza”, Tiranë.

Në Sektorin e Kujdesit të Veçantë (SKV), mbaheshin vetëm gra me probleme të shëndetit mendor, trajtimi i të cilave vazhdonte në mënyrë periodike me konsulta psikiatrike, si dhe me mjekimet përkatëse të rekomanduara nga specialistja.

Farmacia ishte e kompletuar me medikamente, megjithëse kishte disa të dënuara të cilat mjekimin e siguronin nga familja me kërkesën e tyre. Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të mjekes, formatet e kontrollit mjekësor, regjistri i vizitave, ai themeltar për kartelat dhe ai i rasteve të evidentimit për dhunë fizike mbaheshin me rregull. Gjithashtu, ishin të plotësuar mirë dhe kartelat. Po ashtu të rregullt ishin edhe regjistrat që administroheshin nga infermierët.

Të gjithë të dënuarat/paraburgosurat ishin të pajisura me librezë shëndetësore, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte dhe nuk kishte vonesa në zbatimin e saj.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar : Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e një fondi të posaçëm për rikonstruksionin e plotë të godinave të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, (IEVP) 325 “Ali Demi”, Tiranë, në mënyrë që si i vetmi institucion i ekzekutimit të vendimeve penale për gratë në Shqipëri, të ofrojë kushte dhe trajtim të denjë të grave të dënuara apo paraburgosura.**

Deri në gjetjen e një zgjidhjeje për rikonstruksionin e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale 325 “Ali Demi”, Tiranë, rekomanduar marrjen e masave për hidroizolimin e plotë të të gjitha ambienteve të regjimit të brendshëm dhe riparimin e tualeteve dhe dusheve të IEVP 325 “Ali Demi”; marrjen e masave për pajisjen dhe instalimin në institucion të një sistemi qendror të ngrohjes; marrja e masave për riparimin dhe përmirësimin e kushteve të mensës së sektorit të paraburgimit; marrjen e masave për shtimin e kamerave vëzhguese me rezolucion të lartë në të gjitha ato ambiente ku mungonte mbulimi nga sistemi i monitorimit me kamera, kryesisht në ambientet e paradhomave të observim/veçimit; marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe nenit 60 të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, në mënyrë që të sigurohet përfundimi i ciklit 9 vjeçar të detyrueshëm i grave të pa arsimuara, të këtij institucioni;

marrjen e masave të menjëhershme për kompletimin e dhomës së stomatologut me instrumente dhe materiale dentare të domosdoshme për të kryer efektivisht një shërbim të tillë; marrjen e masave për pajisjen e I.E.V.P 325 “Ali Demi”, me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të dënuarave dhe të paraburgosurave; marrjen e masave për ruajtjen në kushte frigoriferike dhe me dry edhe të kampioneve të ushqimit të fëmijëve që jetojnë në çerdhen e këtij institucioni; marrjen e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), 325 “Ali Demi”, Tiranë, që nuk kanë zbatuar detyrën për ruajtjen në kushte frigoriferike të kampioneve ushqimore; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), 325 “Ali Demi”, Tiranë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave për pajisjen e dhomave të veçimit me orendi të posaçme për garantimin e konsumimit të vakteve të ushqimit në dinjitet nga ana e të paraburgosurave/dënuarave me masë disiplinore të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, (IEVP) 325 “Ali Demi”, Tiranë.

## 5.2 IEVP BURREL

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel më datë 04.09.2018, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, rezultoi se kishte gjetur zbatim krijimi i sektorit të veçantë për 18-21 vjeçarët ishin realizuar riparime në ambientet e kuzhinës si dhe ishte arritur shmangia e mbipopullimit. Ndërkohë që disa nga rekomandimet ishin pjesërisht të realizuara, pjesa më e madhe e tyre nuk kishin gjetur zbatim me objektivin kryesor vlerësimim e kushteve të I.E.V.P.-së, cilësinë e trajtimit të të paraburgosurve në të, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të parashtruara pas inspektimit të realizuar gjatë vitit 2017. Situata në këtë IEVP është jashtë standardeve, kushtet janë të papërshtatshme dhe me gjithë rekomandimet e vazhdueshme për përmirësimin e situatës nuk ka pasur përmirësime të tilla që të bëjnë të mundur jetesë dinjitoze për të burgosurit

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel kategorizohet “*Burg i sigurisë së lartë me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi*”. Dhe i ka kapacitet maksimal prej 196 personash. Në momentin e vizitës inspektuese, IEVP Burrel nuk rezultoi të kishte problematikë mbipopullimit. Në mjediset e institucionit ishin 164 persona të dënuar/paraburgosur, nga të cilët 118 të dënuar dhe 46 të paraburgosur.

Ndërtesa e kësaj IEVP-je, përveç se është e vjetëruar, nuk i plotëson kushtet e përshtatshme higjienike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të burgjeve europiane. Muret kishin mjaft lagështirë dhe pavarësisht përpjekjes për të realizuar lysterje të shpeshta, njollat e lagështirës dhe rëniet e suvasë faktonin një ambient jo të shëndetshëm. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit u konstatua se në aspektin material, infrastruktura e institucionit është e vjetëruar dhe e degraduar pavarësisht përpjekjeve për riparime pjesore. Mungesa e fondeve ishte pengesë për të kryer një rikonstruksion tërësor. Në mjaft raste viheshin re priza të pasigurta, si edhe instalime elektrike të zhveshura dhe jashtë parametrave të sigurimit teknik, veçanërisht në instalimet e bojlerëve të ngrohjes së ujit në banjat e përbashkëta të regjimeve.

Në përgjigje, grupi i monitorimit sqaroi se qëndrimi i institucionit të Avokatit të Popullit i shprehur dhe në rekomandimet e vitit 2015, 2016 dhe 2017 është hartimi dhe realizimi i një projekti për ndërtimin e një institucioni të ri.

Ashtu si në inspektimin e vitit 2017, edhe këtë radhë u konstatua mungesa e ambienteve të tualeteve në dhoma në seksionin e sigurisë së lartë dhe dusheve brenda sektorit të banimit, por që aktualisht gjenden në sektorin e ajrimit. Gjithashtu problematik në IEVP Burrel janë tualetet dhe dushet në sektorin e paraburgimit, të cilët janë jofunksional dhe jashtë të gjithë parametrave të higjienës. Mungesa e herëpashershme e ujit të rrjedhshëm e përkeqësonte më tej situatën në këto ambiente. Përfundimisht në përmbledhje të asaj që u përshkrua më sipër, vetëm në sektorin e paraburgimit gjendeshin dushe dhe tualete, të cilët janë në funksion normal.

Në përgjithësi kushtet e godinave ishin jo të mira dhe të pamjaftueshme për aktivitete social-kulturore. Në to vihej re mungesa e një sistemi ngrohjeje për periudhën e dimrit dhe e sistemit të ajrimit të mjaftueshëm. Gjithashtu edhe instalimet elektrike e ato hidrosanitare rezultojn në amortizuar. Ankesa kryesisht kishin të bënin me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmisë së vakteve. Gjithashtu kishte edhe ankesa dhe pretendime edhe lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore, mungesën e aktiviteteve dhe ambienteve të përbashkëta për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, si dhe mungesën e medikamenteve.

Gjatë intervistave, grupi monitorues nuk konstatoi ankesa për raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe asaj psikologjike nga ana e personelit të sigurisë në institucion.

Mjediset e ajrimit ishin shumë të zhveshura dhe të betonuara dhe të papërshtatshme për im paktin e diellit në stinën e verës dhe të reshjeve në stinën e dimrit. Kishte vonesa në transferimet e të burgosurve nëpër IEVP më të afërta me qendrat e tyre të banimit, gjë e cila ndikon në pamundësinë e familjarëve për të ardhur një herë në javë në takime.

Në seksionin e veçim/izolimit mbaheshin disa persona të dënuar/paraburgosur të tjerë për arsye mospërshtatje. Institucioni i Avokatit të Popullit thekson se këto ambiente janë të destinuara për përdorim sa më të shkurtër në kohë dhe se vendosja në to duhet të bëhet vetëm me vendim të Komisionit Disiplinor.

MKPT i kushton vëmendje të veçantë personave të dënuar/ paraburgosur, të mbajtur për çfarëdo arsye (për qëllime disiplinore si rezultat i sjelljes së tyre “të rrezikshme” ose “shqetësuese” për interes të hetimit penal apo për arsye sigurie apo me kërkesën e tyre), në kushte të ngjashme me izolim të zgjatur. Parimi i përpjesëtueshmërisë (proporcionalitetit) kërkon të ruhet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të sanksionit disiplinorë lidhur me veprën e kryer dhe zbatimit të regjimit tip - izolim i tej zgjatur, i cili është një vendimmarrje që mund të ketë pasojë shumë të dëmshme për personat në fjalë. Izolimi i tej zgjatur, në disa rrethana, mund të arrijë në trajtim poshtëruar e çnjerëzor. Në çdo rast, të gjitha format e izolimit duhet të jenë sa më të shkurtra që është e mundur dhe jo më shumë se 20 ditë.

Prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e veçimit është një garanci thelbësore, me synimin që personeli mjekësor të kryejë vëzhgim dhe ekzaminimin mjekësor të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore, si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t’u paraqiten rregullisht me anë të një deklaratë me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente për çështjet e regjimit dhe sigurisë në IEVP.



Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumenteve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej<sup>8</sup>. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankesë dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte vetë të dënuarit.

Megjithatë, sipas intervistave pati pretendime se kishte pasur raste që ata kishin bërë një ankesë dhe nuk u ishte kthyer përgjigje, ose ishte kthyer me shumë vonësë.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Ajo për të cilën të dënuarit/paraburgosurit u ankuan lidhur me telefonatat ishte çmimi i lartë i impulseve telefonike krahasuar me vlerën e tregut.

Në I EVP Burrel nuk janë marrë masa për rregullimin apo riparimin e dhomës së takimit me fëmijët, që të paraburgosur/dënuar që kishin të drejtën e prindërimit në distancë, si dhe për të moshuarit me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike, pavarësisht se është rekomanduar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit edhe pas inspektimit të realizuar në vitin 2017.

Në I EVP Burrel punonin disa të paraburgosur/dënuar, nga shumica e të cilëve u morën ankesa për mos përfitim të uljes së dënimit nga puna e kryer, pasi nuk trajtohen fare në skemat përfituese. Në I EVP Burrel nuk janë marrë masa për rregullimin e situatës së shpërblimit të punës së kryer, pavarësisht se është rekomanduar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit edhe pas inspektimit të realizuar në vitin 2017. Situata faktike në I EVP Burrel, nuk është si në burgjet e tjera pasi ka një sërë vendimesh gjyqësore të formës së prerë të gjykatës së Rrethit Mat, për mosnjohjen e ditëve të punës të të paraburgosurve/dënuarve për efekt të shlyerjes së dënimit. Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet në nenet 349 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor<sup>10</sup>, nuk është miratuar ende ndonëse kanë kaluar 10 vite nga momenti i miratimit të ligjit.

I EVP Burrel përbëhej nga 3 seksione: siguri e lartë, siguri e zakonshme dhe sektori i paraburgimit. Në momentin e inspektimit nuk kishte të dënuar me masë disiplinore në veçim përveç rasteve të vendosjes për mospërshtatje. Në dy sektorë, dhomat ishin të pajisura me tualete brenda ndërsa dushet ishin të përbashkëta në kushte lagështire dhe të pa mirëmbajtura. Ndërsa në seksionin e sigurisë së lartë banjat ishin të përbashkëta në kushte higjienë dhe pajisjesh të papërshtatshme, dyer të vjetra dhe jofunksionale, pa lavamanë dhe rubinete funksionale. Në këtë seksion problematike mbetej vendndodhja e dushëve të përbashkëta jashtë godinës së sektorit. Të dënuarit duhet të kalonin sidomos gjatë dimrit në kushte të ftohti apo reshjesh përmes oborrit të hapur të ajrimit për të bërë dush në

---

<sup>8</sup> Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. ( i shfuqizuar)

<sup>9</sup> Paragrafi 3 dhe 4 i nenit 34, i ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar parashikon se: ***Punësimi i të burgosurve/paraburgosurve mbështetet në parimet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.***

<sup>10</sup> Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

ambientet e dusheve të përbashkëta. Nga ana e të paraburgosurve/burgosurve u morën ankesa për mungesën e herëpashershme të ujit të rrjedhshëm.

Kishte ndriçim artificial, por përgjithësisht në sektorë, dritaret ishin të vogla dhe pengonin ajrosjen dhe ndriçimin natyral.

Pavarësisht se në ambientet e sigurisë së zakonshme, të cilat u vizituan nga grupi i ekspertëve, u konstatuan pajisje për ngrohje (kaloriferë) apo pajisje kaldaje, nga komunikimi me të burgosurit, u pohua fakti se ato nuk ndizeshin rregullisht dhe mjaftueshëm në kohën e dimrit dhe ngrohja realizohej kryesisht nëpërmjet batanijeve dhe rrobave personale, apo ndonjë ngrohëse të siguruar nga vetë të dënuarit. Ndërsa në ambientet e sigurisë së lartë dhe paraburgimit mungonte krejtësisht ngrohja.

Dhomat përgjithësisht ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe dollap, por kishte ankesa nga disa të paraburgosur që nuk lejoheshin të merrnin pajisje të përdorura, si TV dhe frigorifer nga të afërmit, dhe që nga ana tjetër nuk mund t'i blinin të reja pasi nuk i kishin mundësitë financiare. Pengesë sipas tyre ishte Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, i cili lejon në mjediset e banimit vetëm pajisjet e reja që blihen nga institucioni me një Komision të Posaçëm.

Në IEVP Burrel ofroheshin shumë pak aktivitete, kjo edhe për shkak të mungesës së hapësirave. Biblioteka ishte shumë e varfër, në tituj e sasi librash. Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin shumë pak aktivitete të përbashkëta në mjediset e edukimit.

Aktualisht stafi i kujdesit social ishte i paplotësuar, pasi në përbërje të tij nuk kishte dy punonjës social që mungonin në organikë, si edhe u konstatua mungesa e psikologut. Në ditën e monitorimit gjendeshin persona të identifikuar me probleme të shëndetit mendor, por për ta kishte programe të individualizuara trajtimi.

Në ambientet e paraburgimit nuk kishte dhomë kulturi. Ambientet e kultit gjendeshin vetëm në seksionin e të dënuarve. Nuk kishte dhomë këshillimi në seksione. Në IEVP Burrel kishte një ambient të përshtatshëm që shërbente si sallë për ushtrimin e riteve fetare. Të dënuarit kryenin rregullisht ritet fetare respektive.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas Rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Nuk u konstatuan ankesa nga ana e të dënuarve lidhur me kryerjen e telefonatave, përveç faktit që kërkonin pajisje shtesë telefonit në korridorin e sektorit të paraburgimit, pasi aktualisht ishin vendosur në ambientet e ajrimit. Të dënuarit kishin mundësi për të shfrytëzuar librat në bibliotekë, lojërat e tavolinës dhe aktivitete të tjera rekreative si rezultat i ambienteve të përbashkëta të papërshtatshme.

Ishin në përdorim të vazhdueshëm ambientet e jashtme të cilat përveç ajrimit përdoren sistematikisht për të luajtur futboll apo volejboll sipas një grafiku paraprakisht të miratuar. Sipërfaqja e ambienteve të ajrimit ishte brenda standardeve të pranuar. Mundësia për trajnime profesionale mbetet e kufizuar. Ato nuk ofroheshin nga institucioni dhe nuk kishte organizata që të kryenin të tilla shërbime.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, vihej re se kishte kontakte të shpeshta të të dënuarve/ paraburgosurve me punonjësit përkatës të kujdesit social. Gjithsesi, problematike mbetet mungesa e dhomës dhe ambienteve të përshtatshme për këshillim individual, mungesë e cila kufizonte përfshirjen në procesin e rehabilitimit. Stafit psiko-social nuk ishte i plotësuar sipas organikës, si edhe nevojitej vëmendje më e madhe për sa i përket trajtimit individual të dosjeve, vlerësimeve psikologjike apo të ndërhyrjes së ofruar prej tyre, si dhe përpjekjeve për të vendosur ura komunikimi me familjet e personave që nuk kishin kontakte.

Sa i takon shërbimit shëndetësor përbëhej nga 1 mjek me kohë të plotë, 4 ndihmës mjekë, 1 stomatolog dhe 1 farmacist. Të dënuarit/ paraburgosurit referuan ankesa për sa i përket shërbimit shëndetësor. Problematikat më të shumta që u konstatuan në këtë institucion për sa i përket shërbimit shëndetësor, ishin të lidhura kryesisht me mungesën e medikamenteve për mjekimet, të cilat shpesh mbuloheshin me ilaçe që sillleshin nga familja, pasi vetë institucioni kishte mangësi të theksuara të ilaçeve. Gjithashtu duhet theksuar fakti se në Burrel nuk ka depo farmaceutike dhe marrja e një ilaçi, të padisponueshëm në depon e IEVP, mund të kërkojë disa ditë apo javë. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai ishte i mangët dhe nuk ofronte shërbime thelbësore si mbushje etj., por veçse mjekime në raste infeksionesh dhe ekstraksione.

Sipas informacionit që u mor nga përgjegjësi i sektorit shëndetësor në këtë institucion vuanin dënimin disa persona me çrregullime të shëndetit mendor. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike si me Diabet Mellitus të cilët trajtoheshin nga stafit mjekësor i institucionit me medikamente sipas rekomandimeve të mjekëve specialist të spitalit civil të Burrelit. Institucioni nuk dispononte një autoambulancë për shërbime urgjence apo shërbime të tjera shëndetësore.

Dhoma e mjekut ishte e rregullt, e pastër, e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të mbyllura me dry. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me unit, autoklavë dhe instrumente dentare tejet të amortizuara, por funksionale, ndërkohë që materialet dentare nuk siguroheshin rregullisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Dhoma e infermierisë e cila ndodhej brenda në regjim në sektorin B1, shfrytëzohej për vizitat e mjekësore. Dhoma ishte e pajisur me dy krevate, tavolinë, ndërsa mjekimet e urgjencës mbaheshin në një çantë e cila shërbente edhe për sektorët e tjerë, duke qenë se këta të fundit nuk kishin një dhomë infermierie.

Farmacia e këtij institucioni ishte e rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike, por mungonin ato për sëmundjet akute.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut, u konstatua ekzistenca e një ishte regjistri të vizitave të mjekut, regjistri themeltar i të dënuarve/paraburgosurve dhe regjistrat e informacionit 24 orëshe të infermierëve, ndërsa mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të rënda të dhunës. Me librezat shëndetësore ishin të kompletuar vetëm të dënuarit, ndërsa të paraburgosurit nuk ishin të pajisur me librezat për shkak të vonësive në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale. Ndërkohë që skema e rimbursimit të ilaçeve ishte funksionale vetëm për sëmundjet kronike, por ajo nuk gjente zbatueshmëri për sëmundjet akute, megjithëse ky është një detyrim që rrjedh nga kontrata tre palëshe midis Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, IEVP-së dhe Depos Farmaceutike përkatëse.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduum :** **Mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel.** Deri në gjetjen e një zgjidhjeje për mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, rekomanduum: marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcion tërësor të IEVP Burrel për ta sjellë në kushte banimi; përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjave të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik; marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të paraburgosurve/dënuarve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar; marrjen e masave të menjëhershme për ofrimin e shërbimit të lavanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit/paraburgosurit; marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e hapësirës personale prej 4m<sup>2</sup> për person në dhoma; marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në ambientin e guzhinës dhe përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e sistemit të kërkesë-ankesave në institucion, duke kthyer përgjigje me shkrim të paraburgosurve dhe të dënuarve brenda afateve ligjore; marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit/paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre; marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në të gjithë sektorët, sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve; marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute; marrjen e masave për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, në mënyrë që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës; marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik; marrjen e masave për shtimin e një pajisje telefonike në korridoret e seksionit të paraburgimit; marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijë të mitur; marrjen e masave për të përmirësuar mjedisin e ajrimit për t’iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve periodike me të dënuarit/paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për krijimin e ambienteve dhe dhomave të përshtatshme për këshillim dhe punë individuale të personelit psiko-social me të burgosurit; marrjen e masave për pajisjen e fushës së ajrimit me tendë mbrojtëse nga dielli dhe reshjet;

### 5.3. IEVP KUKËS

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale I.E.V.P Kukës më datë 10.09.2018 MKPT-ja kishte si qëllim vlerësimin e kushteve të I.E.V.P.-së, cilësinë e trajtimit të të paraburgosurve në të, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të parashtruara pas inspektimit të realizuar në inspektimin e mëparshëm.

Kapaciteti zyrtar maksimal i këtij institucioni është 36 të paraburgosur. Në ditën e vizitës inspektuese në institucion mbaheshin 20 të paraburgosur, dhe 3 të dënuar me vendim të formës së prerë në pritje të transferimit.

Por shqetësues ishte fakti që personat të cilët kishin marrë vendimin e formës së prerë nga Gjykata, banonin në të njëjtat ambiente me të paraburgosurit, dhe gëzonin po të njëjtin trajtim me këta të fundit. Nga ana e institucionit ishin marrë masa për kërkimin e transferimit, por deri në marrjen e përgjigjes e cila kërkonte një periudhë 1-2 javore të dënuarit, vazhdonin të qëndronin në dhomat ku kishin qëndruar më parë, si të paraburgosur.

MKPT konstatoi se rekomandimet e bëra kishin gjetur pjesërisht zbatim dhe konkretisht: në regjimin e brendshëm ishte mundësuar shtrimi me pllaka e dyshemesë, ishin marrë masa për rikonstruktimin e kuzhinës, ishin marrë masa për lysterjen e përgjithshme të të gjithë ambienteve të I.E.V.P. Kukës, ishin marrë masa për zvogëlimin e mbipopullimit.

Nga bisedat e realizuara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se ndaj tyre **nuk** të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike. Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacioneve rezultoi se për një periudhë të gjatë nuk kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të paraburgosurve falë marrëdhënieve pozitive të ndërtuara, ndërmjet të paraburgosurve, si edhe midis tyre e stafit.

Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të drejtë për të gjithë. Në rastet kur kërkoheshin takime shtesë me familjarët, ato mundësoheshin në çdo rast.

Ankesat e parashtruara gjatë inspektimit fokusoheshin kryesisht ndaj: kufizimeve infrastrukturore për ajrim, arsimim, aktivitete fetare e sportive. Ajrosja kryhej në përputhje me Urdhrin nr. 4024 datë 10.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ankesat lidhur me faktin që kur familjarët sillnin ushqimet këto raste konsideroheshin si takim, edhe për rastet kur takimi nuk realizohej faktikisht. Ankesa të tjera kishte mbi mundësimin e blerjeve. Në kushtet kur në institucion nuk lejohej më njësia tregtare dhe kur arka nuk ishte në funksion, të paraburgosurit e kishin të vështirë të mbulonin nevojat e tyre për blerje, nëse nuk kishin mbështetjen familjare apo të të paraburgosurve të tjerë. Veçanërisht pamundësia e blerjeve ndikonte më së shumti tek shtetasit e huaj që ndodheshin në I.E.V.P. dhe ata të paraburgosur të braktisur nga familja.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve u konstatua se çdo veprim regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Secili sektor mbante dosjet përkatëse. Komisioni i pritjes funksiononte në rregull. Përsa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte mbulim të plotë me kamera dhe informacioni ruhej për një periudhë tre mujore. Sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas rregullit. Specialistja e sektorit psiko-social i mblidhte nga kutia, ose i merrte verbalisht, dhe ia përcillte drejtorit. Përgjithësisht kërkesat kishin të bënin me takime shtesë ose bashkim dhomash. Përgjigja u jepej verbalisht ose me shkrim brenda afateve. Telefonat ishin funksionalë dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin, brenda orarit të lejuar nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Takimet zhvilloheshin në rregull, sipas planifikimeve dhe mbikëqyreshin në distancë nga punonjës të sigurimit. Ambienti i kultit ishte funksional dhe përdorej kryesisht nga besimtarët myslimanë.

Punësimi i të paraburgosurve në I.E.V.P. Kukës shpërblehej me ditë ulje dënimi në momentet kur të paraburgosurit merrnin vendim të formës së prerë nga gjykata. Në ditën e inspektimit u gjetën 2 të punësuar, në pozicionet sanitar dhe berber.

Grupi i Monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës.

Gjendja materiale e I.E.V.P. Kukës u konstatua të kishte përmirësime përse i përket ndërhyrjeve riparuese. Dhoma e takimeve ishte e rregullt, e pastër dhe e lyer, me kablllo të vendosura në kanalina. Duke qenë se ajo përdorej edhe për takimet me avokat, prokuror, dhe oficerë të policisë gjyqësore, ajo ishte e pa monitoruar me kamera. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë, karrige e stol. Në dhoma kishte ndriçim të kufizuar natyror, pasi dritaret ishin të përmasave 80x60 cm dhe ishin të përforcuara me skarë të parë, skarë mbrojtëse hekuri dhe kornizë.

Problem mbetet lagështira, pasi godina e paraburgimit ndodhet pjesërisht nën nivelin e tokës. Lagështira ishte më e madhe në dhomën e cila gjendej pranë tualetit duke e bërë tërësisht të pabanueshme. Dhoma e observimit si dhe ajo e veçimit, me nga një shtrat, kishin të njëjtat kushte me dhomat e tjera.

Në I.E.V.P. Kukës mungojnë mjediset e jashtme të cilat mund të përdoren për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. I vetmi mjedis ishte ai i ajrimit i cili ishte i kufizuar në hapësirë dhe nuk ofronte asnjë mundësi argëtimi me aktivitete sportive, përveç lojërave të tavolinës.

Kuzhina e I.E.V.P.-së ishte e vogël dhe e pastër. Megjithatë në të mungonte aspirimi dhe gatimi kryhej me sobë me energji elektrike. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme. Në kuzhinë ishte afishuar menuja javore, kuotat ditore dhe vlerat kalorike, të cilat rezultuan brenda standardeve. Po aty ishin vendosur të afishuara dhe librezat shëndetësore të punonjësve të cilat rezultuan të rregullta. Gjatë inspektimit u konstatua se kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike.

Në institucion nuk kishte persona të kategorizuar me probleme të shëndeti mendor. Për të paraburgosurit e ardhur rishtas mundësohej aplikimi i programit të pritjes për të paraburgosurit e rinj.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale rezultoi se ato ishin të plotësuar mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek me kohë të pjesshme (katër orë në ditë) dhe 3 ndihmësmjekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut, u konstatua se regjistrat e terapisë ditore, marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, kartelave dhe ngjarjeve të rënda ishin të plotësuar dhe të mbajtur në mënyrë të rregullt. Kartelat mbaheshin pa dryna në zyrën e Nd/mjekut që shërbente njëkohësisht si zyrë, edhe për financën dhe logjistikën.

Dhoma e mjekut, infermierisë dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura, megjithëse me infrastrukturë të vjetër e të varfra në pajisje. Prej tre vitesh ishte përshtatur një hapësirë me dy dhoma, me hyrje më vete, që plotëson gjithë parametrat e sigurisë. Si rregull shtrimet për situata serioze shëndetësore, kryheshin në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve në Tiranë. Furnizimi me medikamente për pacientët kronikë kryhej me kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Furnizimi me mjekime të urgjencës kryhej përmes blerjeve me prokurim të vogël nga vetë institucioni. Mjekimet, përfshirë ato personale të sjella nga familjarët, administroheshin nga ndihmësmjekët e turnit.

Të gjithë të paraburgosurit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Asgjësimi i ilaçeve të skaduara bëhej me komision dhe regjistrohej në mënyrë filmike. Autoambulanca në këtë institucion mungonte prej kohësh.

Të paraburgosurit, u shprehën të kënaqur nga gatishmëria e stafit mjekësor në përgjigje të kërkesave për ndihmë mjekësore si në rastet e urgjencës, ashtu dhe në përmbushjen e kërkesave për konsulta të specializuara nga mjekë specialistë të Spitalit Rajonal Kukës.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduum**: marrjen e masave për kalimin në një dhomë të veçantë të të dënuarve me vendim gjyqësor të formës së prerë, në datën që në institucion vjen vendimi i gjykatës dhe urdhri i prokurorit për ekzekutimin e tij, si dhe garantimin e të drejtave të tyre të njohura me ligj; marrjen e masave për krijimin e kushteve për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional si dhe për mundësimin e aktiviteteve të tjera kulturore; marrjen e masave për mundësimin brenda skemës së sigurisë të hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen; marrjen e masave për hapjen e dyqanit dhe mbajtjen e arkës në institucion për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve; marrjen e masave për mbajtjen në raft të veçantë dhe të mbyllur me çelës të kartelave mjekësore nga ana e sektorit shëndetësor.

## 5.4 IEVP TROPOJË

**Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar** për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar **kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P)** Tropojë me datë 12.09.2018, sipas një plani inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Alfred Koçobashi dhe Genci Tërpo, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

**Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ( I.E.V.P.)** Tropojë është kategorizuar si institucion i sigurisë së zakonshme me regjim paraburgimi dhe burgimi, përkatësisht me kapacitet 10 dhe 16 persona. Ndarja midis dy sektorëve që ndodhen në të njëjtin korridor, kryhej me anë të një skare. Në ditën e vizitës inspektuese në institucion trajtoheshin 12 të paraburgosur dhe 15 të dënuar, duke patur një tejkalim të kapacitetit zyrtar të këtij institucionit me dy persona më shumë në sektorin e paraburgimit. Në godinën e I.E.V.P. Tropojë nuk ishin kryer investime të reja gjithpërfshirëse. Për rrjedhojë nuk kishte ambient të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive, arsimore e të formimit profesional. Ndërkohë që u konstatuan ndryshime pozitive strukturore pasi me shpenzime të vogla të brëndshme ishin zgjeruar dhomat e banimit duke eliminuar një ndarëse murale jo funksionale. U ri-konstatua problematika e mbajtjes në ambientet e institucionit të personave të ndaluar/arrestuar në pritje të caktimit të masës së sigurimit, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 2151 prot. datë 17.03.2015 dhe nr. 1054/1 prot. datë 16.03.2015, të lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, “Për rritjen e sigurisë

*në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sigurimin e të burgosurve dhe të dënuarve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale”.*

Nga ana e I.E.V.P. Tropojë i ishte kërkuar D.P.B.-së rishikimi i kësaj marrëveshje sikurse provohej dhe me shkresën me nr. 783 prot. datë 20.07.2017, në mënyrë që personat e ndaluar/arrestuar deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit të mbaheshin në ambientet e Komisarariatit të Policisë Tropojë, të cilat kanë qenë në përdorim të I.E.V.P.-së. U konstatuan probleme për sa i përket plotësisimit të nevojave për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve. Kjo pasi me urdhër të D.P.B.-së është ndaluar funksionimi i blerjeve më arkat e institucioneve dhe këto janë zevendësuar me pajisjen e të dënuarve me karta debiti nga filialët e bankës BKT por në rrethin e Tropojës nuk ka filial të bankës BKT për të mundësuar pajisjen e personave me karta, Urdhëri i D.P.B. nr. 4629/1 prot. datë 11.07.2012 “*Mbi pajisjen me karta debiti të të dënuarve në I.E.V.P.*”, dhe urdhëri nr. 2399 prot. datë 01.04.2013 “*Mbi përdorimin e arkës së të dënuarve dhe kartat e debitit për të dënuarit*”, nuk kishin gjetur zbatim. Nga bisedat e realizuara me të paraburgosurit dhe të dënuarit, në dhoma e më vete, pa praninë e punonjësve të institucionit, nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike. Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacioneve rezultoi se prej një periudhe të gjatë nuk kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të paraburgosurve falë marrëdhënieve pozitive të ndërtuara ndërmjet të paraburgosurve, si edhe midis tyre e stafit të institucionit. Nga ana tjetër ankesat e marra gjatë inspektimit ishin kryesisht të lidhura me kufizimet infrastrukturore për ajrim, arsimim, aktivitete fetare e sportive. Ajrosja kryhej në përputhje me Urdhrin nr. 4024 datë 10.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Të paraburgosurit në ndryshim nga një vit më parë u shprehën të kënaqur me shërbimin shëndetësor si dhe me mënyrën me të cilën trajtoheshin kërkesat dhe ankesat e tyre nga stafi. Po ashtu, thuajse të gjithë të paraburgosurit u shprehën të kënaqur në lidhje me ushqimin e servirur në institucion. Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të drejtë për të gjithë. Kur prej të paraburgosurve kërkoheshin takime shtesë me familjarët, ato rezultonin të mundësuar në çdo rast. Takimet zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve në një ambient me dy poste, pa kufizime, të pajisur me një tavolinë dhe disa karrige në kushte të mira. Takimeturvejoheshin në distancë nga punonjës të sigurisë. Ankesat mbi takimet konsistonin në pamundësinë e të dënuarve për të kryer takime speciale.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, përveç tre ditëve të fundit, ku kompania ‘Mobitel’ kishte hasur në probleme teknike dhe nuk kishte arritur ende ta ofronte shërbimin. Ankesa u konstatuan mbi mos përfitimin e lejeve shpërblyese, por për të gjitha ankesat e marra, grupi monitorues konstatoi se veprimet nga ana e **Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale**(I.E.V.P) ishin kryer, por ishin komisarariatet ata që kishin dërguar përgjigje negative. Ankesa të tjera kishte mbi mundësimin e blerjeve. Në kushtet kur në institucion nuk lejohej më njësia tregtare dhe kur arka nuk ishte në funksion, të paraburgosurit dhe të dënuarit e kishin të vështirë të mbulonin nevojat e tyre për blerje nëse nuk kishin mbështetjen familjare apo të të bashkëvuajtësve të tjerë. Veçanërisht pamundësia e blerjeve ndikonte në shtetasit e huaj dhe ata të braktisur nga familja. Pothuajse të gjithë të dënuarit e konsumonin ushqimin në institucion dhe pohuan se ishte i kënaqshëm për nga cilësia, por problem ishte larmia. Punësimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve në I.E.V.P. Tropojë bëhej në përputhje me Urdhrin e D.P.B.-së nr. 2916, dt. 18.04.2016. Në ditën e inspektimit rezultonin disa të punësuar në pozicionet sanitar, berber, punonjës biblioteke, mirëmbajtës, lulishtar dhe shpërndarës ushqimi. Në I.E.V.P. Tropojë **kishte një dhomë në të cilën siguroheshin dhe trajtoheshin** personat e arrestuar dhe të ndaluar nga Komisariami i Policisë Tropojë



për shkak se në këtë komisariat nuk kishte ambiente sigurie. Të arrestuarit dhe të ndaluarit që dërgoheshin në këtë institucion siguroheshin nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tropojë, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të përmendur në shënimet paraprake më lartë. Kushtet materiale në I.E.V.P. Tropojë u gjetën të pandryshuara nga inspektimi i mëparshëm. Ndërtesa e këtij institucioni përbëhej nga dy kate dhe një kat pjesërisht nëntokë vetëm nga njeri krah. Ky i fundit ka dalje të drejtpërdrejtë mbi tokë (nga krahu tjetër), jashtë godinës pasi vetë ndërtesa është e pozicionuar mbi një pjesë kodrinore. Në këtë kat, pjesërisht nëntokë, ndodhej kuzhina e institucionit. Problematike mbetet edhe zgjerimi i dritareve në dhomat e banimit, pasi nuk lejojnë hyrjen e dritës natyrale në këto kushte në të cilat ndodhen.

Në katin e parë të ndërtesës gjendej dhoma e takimit me familjarët dhe avokatin, vendqëndrimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, një ambient për magazine dhe regjimi i brendshëm. Në hyrje të regjimit të brendshëm ndodhej infermiera. Në korridor ishte vendosur kabina e telefonit. Të drejtat dhe detyrat e të paraburgosurve ishin të afishuara po aty.

Në regjimin e brendshëm, gjendeshin 6 dhoma për 4 persona dhe 2 dhoma për 2 persona, ambientet e dushit (nga dy poste të ndara që siguronin privatësinë) si dhe ambienti për ajrim të jashtëm. Nga vizita në dhomat e paraburgimit u vu re se ato ishin kryesisht të pastra dhe të lyera, por nuk e respektonin hapësirën jetike, gjë e cila krijonte probleme për ajrosjen.

Nga inspektimi rezultoi se ambienti i tualetit/dusheve ishte me lagështirë. Kalendarit i dusheve nuk ndodhej i afishuar, por nga pohimet e të paraburgosurve/ dënuarve u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve. Çarçafët ndërroheshin një herë në 15 ditë, ndërsa ambienti i dusheve shfrytëzohej nga vetë të paraburgosurit/ dënuarit, për larjen e rrobave personale. Hapësira e ajrimit ishte e vogël për organizimin e lojërave përtej atyre të tavolinës, pasi edhe kjo hapësirë ishte e ndarë në dy poste të veçuara për të paraburgosurit dhe të dënuarit. Për shkak të mungesës së dhomës së aktiviteteve, nuk ofroheshin kurse arsimore e formimi profesional, por sipas rastit në korridor ose në ambientet e ajrimit mundësohej trajtimi i temave të ndryshme dhe recensionet e librave. Me gjithë kufizimet infrastrukturore, specialisti i sektorit psiko-social punonte në mënyrë aktive që të mundësonte aktivitetet të ndryshme social- kulturore. Në institucion nuk kishte persona të kategorizuar me probleme të shëndeti mendor, e megjithatë specialisti i kujdesit social i kontaktonte dhe punonte çdo ditë me për të paraburgosurit dhe të dënuarit. Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga 1 mjek /farmacist që ofronte 90 orë shërbime në muaj dhe 3 ndihmësmjekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se të gjithë librat/regjistrat ishin të plotësuar në mënyrë të rregullt, por kartelat mjekësore nuk mbaheshin të kyçura. Dhoma e mjekut, infermierisë dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Infermiera gjendej brenda në regjim dhe ishte e rregullt, e pajisur me krevat vizitash, aparat tensioni, mjekime të urgjencës dhe terapinë ditore. Furnizimi me medikamente kryhej me kërkesë nga D. P. Burgjeve. Mjekimet, përfshirë ato personale të sjella nga familjarët, administroheshin nga ndihmës mjekët e turnit. Autoambulanca në këtë institucion mungonte prej kohësh, por lëvizjet për në Qendrën Spitalore Tiranë mundësoheshin me automjetin e Komisarariatit të Policisë Tropojë. Shërbimi stomatologjik mundësohej jashtë institucionit nga ofrues privatë, me rekomandimin e mjekut, dhe mbulohej financiarisht nga familjarët. Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar :** 1. Shfuqizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 2151 prot. datë 17.03.2015 dhe nr. 1054/1 prot. datë 16.03.2015, të lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, “*Për rritjen e sigurisë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sigurimin e të burgosurve dhe të dënuarve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale*”. Marrjen e masave për eliminimin e mbipopullimit në I.E.V.P Tropojë. Marrjen e masave për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional. Marrjen e masave për mundësimin brenda skemës së sigurisë të hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen. Marrjen e masave për mbajtjen e arkës në institucion për të mundësuar blerjet nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve ose pajisjen e tyre me karta bankare. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Tropojë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Tropojë, sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike. Marrjen e masave për eliminimin e lagështirës dhe riparimet e nevojshme të ambienteve të dusheve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.)Tropojë.

## 5.5 I.E.V.P TEPELENË

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tepelenë më datë 02.10.2018 MKPT-ja kishte si qëllim vlerësimin e kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Tepelenë, cilësinë e trajtimit të të dënuarve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me bazën ligjore si dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Tepelenë, kishte një kapacitet maksimal prej 75 personash, por në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 115 persona, nga të cilët 93 të paraburgosur dhe 22 të dënuar ndërkohë që 2 të dënuar të tjerë ishin me leje. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte një problematikë e qenësishme, duke pasur parasysh edhe infrastrukturën e këtij institucioni.

Gjatë vizitës MKPT-ja ka vërejtur se: ishte plotësuar rekomandimi për pajisjen e të gjithë të dënuarve dhe paraburgosurve me libereza shëndetësore dhe numrat respektive të sigurimit shëndetësor, ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e vendit vakant të psikologut dhe punonjësit social sipas parashikimeve në organiken e institucionit, ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijë të mitur në kuadrin e prindërimit në distancë por nuk ishin realizuar investime të nevojshme për këtë ambient, ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për respektimin e orarit të ajrimit prej të paktën, dy orësh por nuk ishin realizuar investime për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t’iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim, ishte plotësuar rekomandimi për riparimin e pajisjeve telefonike në ambientet e ajrimit, ishte zbatuar rekomandimi për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e nevojshme të produkteve bazë të higjienës personale si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre, ishte plotësuar rekomandimi për pajisjen e kuzhinës së institucionit me mjete profesionale gatimi dhe aspirimi.

Grupi inspektues nuk evidentoi pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Rezultoi se një numër i madh ankesash që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion si dhe me punën që duhej bërë nga sektori psiko-social dhe ai i shëndetësor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin jo në nivelin e duhur, shërbimin e sektorit psiko-social në I.E.V.P Tepelenë. Gjithashtu sipas të dënuarve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi.

Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore dhe ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve .

Ankesa kishte për furnizimin me ngrohje në I.E.V.P Tepelenë për t'iu përshtatur kushteve klimaterike.

Ankesa të shumta vinin për kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit, të cilat jo vetëm që ishin me lagështirë të theksuar, por kishin mungesa në orendi dhe dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale.

Ankesa gjithashtu kishte lidhur me mungesën e njësisë tregtare, brenda I.E.V.P Tepelenë, gjë kjo që kishte shkaktuar vështirësi tek të dënuarit/paraburgosurit për sigurimin e produkteve bazë të domosdoshme personale. Ankesa kishte edhe për mungesën e aktiviteteve rekreative në I.E.V.P Tepelenë. Ankesa kishte edhe për faktin se nuk ekzistonin ambiente për ushtrimin e riteve fetare.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Observimi si sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçante të paraburgosurve të cilët akomodohen rishtazi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë, funksiononte dhe në momentin e inspektimit gjendeshin 2 (dy) persona.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë, që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Gjithashtu ishte vënë në funksionim edhe aparati telefonik në ambientet e ajrimit i cili nuk punonte më parë si rezultat i një defekti teknik.

Respektohej numri i takimeve me familjet, por u konstatuan ankesa për mënyrën e kryerjes së kontrollit të ushqimeve nga stafi i institucionit.

Në I.E.V.P Tepelenë ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosur/dënuar që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike por ky ambient kishte nevojë për investime dhe orendi për të qenë sa më i përshtatshëm.

Në I.E.V.P Tepelenë kishte disa të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj dhe dhënia e përfitimit monetar, në masë minimale, që depozitohej në llogarinë bankare të personit. Kjo procedurë ndiqej pasi ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërblim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve duhet të rregullohej dhe se puna dhe kriteret e shpërblimit duhet të parashikohen dhe rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, vendim i cili edhe pse tej çdo afati ligjor<sup>11</sup>, ka shumë vite që nuk është miratuar.

I.E.V.P Tepelenë **është një institucion i vjetër i trashëguar nga sistemi komunist**. Infrastruktura e godinës ofron dy kate akomodimi dhe ambiente ajrimi të jashtëm. Në çdo kat kishte nga 12 dhoma. I.E.V.P Tepelenë **kishte nevojë për realizimin e investimeve**.

Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda. Ajrimi për katet kryhej në ambiente të veçanta të ndara nga njëra-tjetra. Në hyrje të godinës gjendej një ambient ajrimi i cili përdorej për personat me probleme të shëndetit mendor, izolim/veçimin, si edhe 18-21 vjeçarët (aktualisht ishin 4 të paraburgosur në moshën 18-21 vjeçare). Gjithashtu ky ambient i veçantë përdorej për kryerjen e ajrimit edhe për personat e tjerë kur konstatohej se ata kishin konflikte dhe mosmarrëveshje me njëri-tjetrin.

Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re se baza materiale nuk ishte e plotësuar si duhej, dhe kishte mungesë pajisjesh ose orendi të amortizuara. **Shtrojat në disa raste ishin vendosur në dyshemetë e dhomave** nga të paraburgosurit/dënuarit për shkak të mbipopullimit. **Nisur nga situata e mbipopullimit edhe hapësira brenda disa dhomave, ishte e kufizuar**.

Komiteti për Parandalimin e Torturës<sup>12</sup> shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> kur në to sistemohen më shumë persona. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.<sup>13</sup>

**Nuk kishte bazë materiale në ambientet e përbashkëta**. Ambientet e takimit me familjarët gjendeshin në një dhomë të përbashkët për të dy sektorët. Në këtë ambient të takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me kangjella hekuri. Një dhomë e vogël prej gati 2-3 m<sup>2</sup> sipërfaqe që gjendej në hyrje të godinës, **përdorej si ambient për prindërimin në distancë** por kjo dhomë nuk kishte orenditë e duhura për t'u konsideruar si ambient takimi, megjithëse kjo ishte e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së ambienteve shtesë. Gjithashtu kishte një ambient për takime speciale ndërmjet bashkëshortëve të pajisur me bazë materiale sipas standardeve por që kishte nevojë për rikonstruksion.

Probleme kishte me higjienën e mjediseve nisur nga fakti që institucioni në tërësinë e tij ishte i amortizuar. Kishte **mungesë në investimeve** në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë **për të garantuar cilësinë e higjienës brenda në institucion**.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë larja në dushe zhvillohej mesatarisht dy herë në javë **por u konstatua se vetëm njëri prej bokseve të dusheve punonte**, dhe

---

<sup>11</sup> Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

në ambientin e dusheve që punonin u konstatua lagështirë e theksuar, tavani ishte shumë i dëmtuar, kokat e dusheve ishin të dëmtuara, kishte amortizim të theksuar të pllakave dhe tubacioneve.

Për përsa i përket larjes së rrobave të fjetjes ato **vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre, pasi ende nuk ishte mundësuar një shërbim i tillë nga institucioni.**

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Tepelenë nuk kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

**Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi.** Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuara sipas vakteve përkatëse. të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri..

U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve në I.E.V.P Tepelenë nuk e konsumojnë ushqimin e përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë.

Në I.E.V.P Tepelenë gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin shumë pak aktivitete të përbashkëta. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan të kenë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*<sup>14</sup>.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta.

**Trajnime profesionale** në I.E.V.P, Tepelenë **nuk kishte** pasi në këtë njësi administrative nuk kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional apo organizata të ndryshme.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale u konstatua se **aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta** dhe këto kryesisht ishin diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit, ose në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë, si dhe nga aktivitetet sportive.

---

<sup>14</sup> Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse. Në dosjet ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike të cilët ishin të plotësuara mirë. Pengesë për kryerjen e punës nga stafi i edukimit dhe nga ai psiko-social ishin mungesa e ambienteve të përbashkëta dhe e dhomave të këshillimit.

Në institucion, gjendej dhe një numër i vogël librash që konsideroheshin si të bibliotekës, por ato gjendeshin të shpërndara nëpër zyra. Këto libra iu viheshin në dispozicion të parburgosurve /dënuarve për lexim sipas kërkesave, me kartelat personale

**Sa i takon shërbimit Shëndetësor u konstatua se kishte mungesa të medikamenteve** blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej përkohësisht nga blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.Burgjeve. Dhe blerjet e medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond. Shpesh mbuloheshin me kontributet e familjeve të të burgosurve. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte vetëm për të sëmurët kronikë. Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, **kishte probleme për shkak të mungesës së bazës materiale**. Theksojmë se Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar marrjen e masave për vënien në funksion të skemës së furnizimit me ilaçe në I.E.V.P Tepelenë dhe në vijim do të kërkohet informacion i vazhdueshëm për hapat e marra në këtë drejtim, si dhe në çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e kushteve në këtë institucion si dhe me uljen e mbipopullimit.

**Mjeku punonte me kohë të pjesshme**. Si rezultat i mbipopullimit ishin shtuar numri i vizitave mjekësore si në I.E.V.P, ashtu dhe ato të specializuara pranë Spitalit të Burgjeve dhe Spitalit Rajonal të Gjirokastrës. Gjithashtu dhe trajtimi akut i personave me probleme të shëndetit mendor bëhej në Spitalin e Burgjeve. Në I.E.V.P. Tepelenë u evidentua edhe 1( një) i dënuar që vuante nga probleme të shëndetit mendor. Mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor.

Mungesa e mjekut me kohë të plotë shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje të mjekut, që në qëndrimet e KPT parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

**Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin të amortizuara**, si të gjithë ambientet e këtij institucioni, dhe kishin nevojë për investime. Në këtë institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.

Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*<sup>15</sup>. Për rrjedhojë u konstatua se organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat që shërbimi i kujdesit mjekësor ndaj tij të përmbushë standardet e të jetë sa më eficient në funksion të shëndetit.

---

<sup>15</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Në I.E.V.P, Tepelenë nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor. Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull, por mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike si dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar** : Marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në I.E.V.P Tepelenë; marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lysterjen e dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të tualeteve të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, dusheve, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.P Tepelenë, për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në I.E.V.P Tepelenë; përmirësimin e higjienës në dhomat e banimit të të paraburgosurve/dënuarve, gjithashtu dhe në ambientet e përbashkëta në institucion; marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e institucionit, marrjen e masave për pajisjen e I.E.V.P Tepelenë me ambulancë; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare; marrjen e masave për rikonstrukcionin e dhomës së mjekut, farmacistit, dhe infermierisë në I.E.V.P Tepelenë; marrjen e masave për krijimin e një Sektori të Kujdesit të Veçantë në I.E.V.P Tepelenë, për të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme të shëndetësore; marrjen e masave për rikonstrukcion dhe plotësimin me materiale dhe orëndi të dhomës së veçantë për ta bërë sa më të përshtatshme për takime të të dënuarve dhe të paraburgosurve me fëmijë të mitur në kuadrin e prindërimit në distancë; marrjen e masave për vënien në funksionim të ambienteve për ushtrimin e rriteve fetare; marrjen e masave për përmirësimin e mjedisit të ajrimit për t’iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim; marrjen e masave për furnizimin me ujë 24 orë në ditë në ambientet e I.E.V.P Tepelenë; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit dhe të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave për ofrimin e kurseve profesionale dhe të aktiviteteve mësimore dhe edukative në institucion; marrjen e masave për pasurimin e fondit të librave në I.E.V.P Tepelenë, në shërbim të të dënuarve apo të paraburgosurve; marrjen e masave për hapjen e një njësie tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit nga I.E.V.P Tepelenë në shërbim të të dënuarve dhe të

paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave për pajisjen e sektorit shëndetësor me regjistrin për evidentimin e rasteve të dhunës; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin me bazë materiale dhe orendi të dhomës së veçimit; marrjen e masave për ofrimin e shërbimit të lavanterisë.

## 5.11 IEVP VLORË

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, më datë 16.10.2018, MKPT-ja kishte si qëllim vlerësimin e kushteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, në kuadër të respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë klasifikohet si “burg i sigurisë së zakonshme”, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion paraburgimi. Kapaciteti fizik i I.E.V.P Vlorë ishte për 168 persona. Në ditën e inspektimit në mjediset e këtij institucioni numri i të paraburgosurve ishte 120 persona, prej të cilëve 9 persona ishin të mitur (në pritje të transferimit brenda muajit Tetor 2018 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve), 16 persona ishin të moshës 18-21 vjeçare, ndërsa pjesa tjetër në moshë madhore.

Në mënyrë të veçantë grupi i inspektimit, vizitoi kushtet e trajtimit në këtë institucion dhe intervistoi të paraburgosurit e mitur 14-18 vjeç dhe të paraburgosurit e moshës 18-21 vjeç. Inspektimi u krye edhe në ambientet ku qëndronin të paraburgosurit në moshë të rritur. Nuk u raportua asnjë rast për ushtrim dhune apo pretendim për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Në intervistat me personat e paraburgosur dolën disa problematika që kishin të bënin me shërbimin shëndetësor për sa i takon vonesave të vizitave mjekësore nga stafi mjekësor i këtij institucioni, si dhe për shërbimin stomatologjik që nuk kishte mjek stomatolog me kohë të plotë pune dhe as mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi.

Ankesa kishte dhe për mungesën e hidroizolimit të tarracës të godinës dhe për nivelin e lagështirës në disa dhoma dhe korridoret e seksioneve të godinës. Gjithashtu, ankesa kishte dhe për ambientet e tualeteve dhe të dusheve, të cilat ishin të përbashkëta dhe të organizuara në bazë seksioni. Vetëm në seksionin e të miturve tualetet ishin brenda në çdo dhomë.

Në mjedisin e sektorit të observim/veçimit nuk kishte asnjë person që qëndronte aty për mospërshtatje apo masë disiplinore.

Sistemit i kërkesë/ankesave funksiononte, çdo formular regjistrohej në regjistrin përkatës dhe më tej protokollohej<sup>16</sup>. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit plotësonin formularin e kërkesë/ankesës dhe e hidhnin në kutinë postare ose ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj

---

<sup>16</sup> Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.



i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit, sipas përcaktimeve ligjore.

Komisioni i pritjes funksiononte normalisht, me përfaqësues nga sektori ligjor, sektori i ruajtjes dhe sigurisë, sektori i kujdesit social dhe sektori i shëndetësisë. Të dhënat regjistroheshin në formularin përkatës dhe më tej pasqyroheshin në një regjistër të posaçëm.

Qendra e monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksionale. Në institucion kishte 48 kamera që monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve me tre turne për 24 orë, ndërkohë që filmimet ruhen në server për një periudhë një mujore.

Komunikimi me familjarët kryhej përmes takimeve periodike dhe me aparatet telefonik me kartë të vendosur në mjediset e regjimit të brendshëm në çdo seksion dhe në ambientin e ajrimit. Ndërsa takimet me familjarët realizoheshin me leje dhe kërkesë të veçantë në ambiente më vete dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për të mundësuar qëndrimin dhe komunikimin mes tyre.

Gjithashtu, në ambientin e takimeve me familjarët, për të paraburgosurit që kanë fëmijë të vegjël, ishte krijuar një mjedis i veçantë lidhur me ushtrimin e të drejtës të prindërimit në distancë. Ky mjedis ishte sipas kushteve dhe standardeve që ai duhet të plotësonte për realizimin e qëllimit të krijuar.

Në I.E.V.P Vlorë, kushtet materiale ishin të përshtatshme dhe funksionale për akomodimin, sigurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve të paraburgosurve. Pranë çdo seksioni, kishte ambiente përfshirë këtu bibliotekën, sallën e informatikës, palestrën, dhomat e këshillimit, dhoma e edukimit, ambienti i kinemasë, si dhe dy ambiente kulturi. Gjithashtu, institucioni kishte ambiente ajrimi të përshtatshme, por ishin të pambuluara në kushte për kryerjen e ajrimit në mot me shi.

Në dhoma akomodoheshin nga 2 deri në 4 persona dhe respektohej standardi në lidhje me hapësirën jetike për person, pasi në këtë institucion nuk kishte mbipopullimi. Në përgjithësi, dhomat kishin dritë natyrale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Dhomat ishin të plotësuara me dyshekë, batanije dhe çarçafë, të cilët ishin në gjendje të mirë, por një pjesë e të paraburgosurve i siguronin këto materiale nga familjarët e tyre. Ambienti i dusheve dhe tualetet ishin i përbashkët për çdo seksion, pasi të tillë ishin parashikuar në projektin e zbatimit për ndërtimin e godinës. Duset kishin ujë të ngrohtë për larjen e trupit, sipas grafikut të miratuar nga drejtuesi institucionit, por këto ambiente nuk ishin të pastra sipas kushteve higjiena-sanitare.

Po ashtu, në ambientin e seksionit për të miturit gjendja e kushteve materiale të dhomave ishte e mirë. Në momentin e inspektimit, ishin të akomoduar 2-3 të mitur për çdo dhomë. Në këtë seksion gjendeshin ambiente të përbashkëta për aktivitete të ndryshme si, klasa këshillimi, klasa për zhvillimin e mësimin për arsimin 9-vjeçar, biblioteka, kinemaja dhe palestra në të cilën kishte tavolina ping-pongu dhe lojëra të tjera. Çdo dhomë ishte me tualet brenda, ndërsa ambienti i dushit ishte i përbashkët. Dhomat ishin të përmasave të ndryshme të përshtatshme për qëndrimin e dy deri në katër të paraburgosur. Sipas informacionit, të miturit do të transferoheshin për në I.E.V.P Kavajë, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, brenda muajit tetor 2018.

Ambientet e përbashkëta në seksionet e të rriturve ishin të pajisura me të gjitha mjetet dhe materialet e nevojshme si tavolina dhe stola për qëndrimin e tyre, si dhe ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjiena-sanitare. Kushtet e dhomave të observimit/veçimit ato ishin përmirësuar dhe plotësuar me

materialet e nevojshme. Në disa nga ambientet e përbashkëta dhe në disa nga dhomat e të paraburgosurve, grupi i inspektimit konstatoi se kishte lagështirë, e cila ishte tej normave të lejuara.

Ambientet ku kryheshin takimet, ishin të ndara me xham ndërmjet të paraburgosurve dhe familjarëve. Nga inspektimi rezultoi se nuk kishte një ambient të veçantë për takime me të miturit i cili të ishte i pajisur me bazën materiale që të ofrojë një ambient të ngrohtë dhe familjar. Zakonisht, për takimet me të miturit, përdorej një ambient i cili ishte pak më i hapur se të tjerët dhe lejonte pak më shumë hapësirë për kontakt fizik, ndërsa për raste të veçanta përdorej dhe dhoma e takimit me avokatin.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte i siguar tre herë në ditë, gjë që bënte të mundur aksesin e personave, për të mbajtur pastër higjienën vetjake. Në institucion nuk kishte sistem qendror për ngrohje. Në periudhën e dimrit, ngrohja nëpër dhoma realizohej me pajisje të siguruara nga vetë familjarët e të paraburgosurve, që futen në dhoma me urdhër të brendshëm për periudhën 1 dhjetor deri në 1 mars të çdo viti. Ndërsa sistemi i ngrohjes në godinën ku ndodhej administrata e institucionit ishte me defekt dhe nuk punonte.

Kuzhina e institucionit ishte me hapësirë të madhe, e ljer dhe me higjienë të pastërti. Cilësia e ushqimit e gatuar në ditën e vizitës monitoruese ishte e mirë. Në kuzhinë ndodheshin librezat shëndetësore të personelit që punonin aty, regjistri i gramaturave dhe menyja ditore e afishuar. Kampionet ushqimore të gatuar një ditë më parë ndodheshin në kushte frigoriferike dhe ishin të mbyllura me çelës. Për minorenët dhe të sëmurët me diabet, gatuhej më vete dhe kishin trajtim të veçantë. E megjithatë, nga intervistat me të paraburgosurit kishte ankesa lidhur me ushqimin, pjesa më e madhe e të cilave lidheshin me cilësinë, larminë dhe sasinë e ushqimit.

Në lidhje me furnizimin me energji elektrike, nuk kishte probleme. Për rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike institucioni ishte i pajisur me gjenerator, i cili përballonte nevojat për ndriçimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe për sigurinë e godinës.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin dhe pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, puna edukative e profesionale etj., ishte i afishuar. Nga bisedat me të dënuarit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet i kryer sipas standardeve dhe bazuar në një grafik paraprak për çdo sektor, por dhe grup moshë. Grupi i monitorimit konstatoi se kishte disa mjedise të jashtme, të cilat përdorreshin për ajrim.

Personeli i edukimit dhe shërbimit psiko-social në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, ishte i plotësuar sipas organikës, funksionit dhe formimit profesional të përcaktuar për secilin pozicion pune. Vlen të theksohet se, stafi i institucionit kishte planifikuar dhe zhvilluar një sërë aktivitete rehabilituese e kreative përfshirë këtu aktivitete kulturore, sportive në palestër e ajrim, kurse të formimit profesional me nga 8 persona në grup për mësimin e gjuhëve të huaja, për hidraulikë, elektrikistë, punë me dru dhe saldator. Mjediset ku kryheshin aktivitetet ishin të përshtatshme dhe të pajisura me bazën materiale të nevojshme. Biblioteka funksiononte normalisht dhe kishte të paraburgosur të regjistruar që frekuentonin rregullisht leximin e librave. Kinemaja po ashtu funksiononte normalisht me shfaqjen e dy filmave në javë për kategorinë e të miturve. Të punësuar rezultonin të ishin 20 të paraburgosur, kryesisht si sanitarë, shpërndarës ushqimi, lulishtarë, etj.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u konstatua se ato ishin të gjitha të plotësuara dhe të përditësuara me takimet me të paraburgosurit dhe

vlerësimet e tremujorit të fundit. Në dosje ishin përfshirë edhe programet individuale të trajtimit psiko-social për çdo moshë. Gjithashtu dhe vlerësimet periodike ishin të plotësuara mirë.

Në ambientin e godinës të banimit, ndodheshin dy ambiente kulti përkatësisht për besimin e krishterë dhe për atë mysliman. Shërbesat kryheshin çdo javë nga personeli i besimeve respektive sipas një marrëveshje ndërmjet institucionit me komunitetet fetare lokale. Mjediset ku kryheshin këto rite fetare ishin të mirëmbajtura dhe të pastra.

Personeli mjekësor në I.E.V.P. Vlorë, nuk ishte i plotësuar sipas organikës. Kryesore ishte mungesa e mjekut të përgjithshëm dhe stomatologut. Për nevojat e punës, institucioni kishte kontraktuar mjekë dhe stomatolog nga shërbimi shëndetësor parësor i qytetit të Vlorës, të cilët punonin me kohë të pjesshme. Gjithashtu, mungesa kishte dhe në plotësimin e personelit të mesëm mjekësor me infermierë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua se, nga ana e tij ishin siguruar konsultime të vazhdueshme me të paraburgosurit. Sa i përket regjistrave dhe konkretisht ai i vizitave mjekësore, i mjekimeve, i konsultave të specializuara në Spitalin Rajonal të Vlorës, i të sëmurëve mendorë dhe abuzuesve me substanca narkotike/alkool, i personave që refuzojnë terapinë, si dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermierëve, u gjetën të gjithë të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura me rregull dhe të mbyllura në dollap me çelës.

Në këtë Institucion ishte një godinë e cila shërbente si spital, me dy dhoma për shtrim të cilat ishin të mirë pajisura me orendi, me nga një krevat për dhomë dhe në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e mjekut ishte e pajisur me një krevat vizite, tavolinë, karrige dhe një dollap ku mbaheshin të kyçura kartelat mjekësore. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me një poltron, unit funksional, por mungonin autoklava dhe materialet bazë dentare.

Farmacia ishte e rregullt dhe e furnizuar me medikamente, që ishin siguruar nga sektori i shëndetësisë pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nga fondi i vetë institucionit për blerjen e ilaçeve.

Kishte disa ankesa për sa i përket vonësive për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku dhe për vizitë tek specialistët e spitalit rajonal Vlorë. Ankesa kishte dhe për mungesën e shërbimit stomatologjik, i cili thuajse nuk funksiononte.

Një problem shqetësues në I.E.V.P. Vlorë ishte dhe mungesa e një autoambulance, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në spitalin rajonal Vlorë. Në këto kushte, nga drejtuesi i institucionit u informuam se, në rastet e emergjencave transporti i të sëmurëve për në spitalin rajonal, kryhej me autoambulancat e shërbimit të urgjencës Vlorë, duke marrë masa shtesë për sigurinë fizike të paraburgosurve.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar**: marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin dhe hidroizolimimin e tarracës së godinës ku ndodhen të paraburgosurit, për eliminimin e lagështirës brenda këtyre ambienteve;

marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të stafit mjekësor të institucionit me mjek të përgjithshëm, stomatolog dhe infermierë, të punësuar me kohë të plotë; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjiena-sanitare në ambientet e dusheve; marrjen e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me mjetet e nevojshme si autoklavë dhe materialet bazë dentare, sipas protokolleve mjekësore; marrjen e masave të menjëhershme për mbulimin e ambienteve të ajrosjes, për mundësimin e ajrimit të paraburgosurve edhe për ditët me mot të rënduar; marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes të ambienteve të përbashkëta dhe dhomave të paraburgosurve në rregjimin e brendshëm, nëpërmjet instalimit të një sistemi qendror për ngrohje.

## 5.7 IEVP SARANDË

**Gjatë vizitës, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë më datë 17.10.2018.** MKPT-ja kishte si qëllim vlerësimi i kushteve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, për garantimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim të përcaktuara në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe në dokumentet ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

**Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe** grupit të inspektimit iu ofrua mundësia që të kishin akses, në përputhje me bazën ligjore si dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve,

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë kishte një kapacitet maksimal prej 31 personash, por në momentin e vizitës inspektuese në mjediset e këtij institucioni ishin 50 persona, me një mbi popullim prej 19 të paraburgosur mbi kapacitet. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte një problematikë e qenësishme, duke pasur parasysh edhe kushtet e këtij institucioni.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se **nuk ishte zbatuar rekomandimi i Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm për “mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Sarandë”. Kjo, për shkak të trajtimit dhe kushteve jo humane dhe degraduese të të paraburgosurve që qëndrojnë në këto ambiente, të cilat vazhdojnë ende dhe sot të jenë jashtë çdo standardi ligjor dhe konvente ndërkombëtare.**

Theksojmë se, veprimtaria e institucionit kryhej normalisht, ndonëse me urdhër nr.8729/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, i klasifikuar “Institucion paraburgimi”, urdhërohej të kalojë në konservim (mbyllje e përkohshme). Ky status, në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit është i paqartë, pasi nuk gjendet dhe nuk përcaktohet në asnjë nga aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e organeve shtetërore kompetente në këtë fushë.

Gjithsesi, nga ana e stafit të institucionit ishin marrë disa masa për përmirësimin e kushteve materiale dhe higjieno-sanitare në ambientet e regjimit të brendshëm, në dhomën e observimit/veçimit, si dhe në dhomën e takimeve me familjarët.

Grupi inspektues, nuk evidentoi raste apo pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Infrastruktura e këtij institucioni nuk ofronte asnjë kusht dhe standard ligjor, pasi godina ishte gjysmë nëntokë dhe me nivel të lartë lagështire, ku të paraburgosurit mbaheshin si në bodrum duke e bërë trajtimin e tyre jo human dhe degradues.

Në momentin e inspektimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, u konstatua se kishte mbi popullim në dhomat ku akomodohen të paraburgosurit, një fenomen ky i përsëritur, duke patur parasysh faktin që infrastruktura e këtij institucioni nuk plotëson as kushtet minimale për trajtimin dhe sigurinë e personave të privuar nga liria. Konkretisht, në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>17</sup> përcaktohet se, për çdo të paraburgosur kubatura duhet të jetë jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m<sup>2</sup>. Si rrjedhojë e mbi popullimit, grupi inspektues konstatoi në disa dhoma se kishte të paraburgosur që flinin me dyshek në dysheme, në kushtet e një trajtimi çnjerëzor dhe degradues.

Ashtu siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, godina e institucionit dhe mjedisi në regjimin e brendshëm, ishin të amortizuar dhe me lagështirë tej normave të lejuara.

Gjithashtu, ankesa të shumta kishte dhe për cilësinë jo të mirë të ushqimit, mungesën e ujit të ngrohtë në çezma për pastërtinë vetjake, mungesën e kushteve higjieno-sanitare në dushe dhe tualete, mungesën e ngrohjes kryesisht në periudhën e dimrit, si dhe për mungesën e mjediseve në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, për shkak të mungesës së infrastrukturës ndarja e të paraburgosurve në seksione të veçanta sipas kategorive 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>18</sup>, nuk mund të realizohej. Institucioni kishte vetëm një ambient në regjimin e brendshëm, i cili ishte i ndarë në dhoma dhe jo me seksione.

Dhoma e observim/veçimit ndodhej në fund të korridorit të regjimit, por ishte nën administrimin e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe përdorej si dhomë sigurie, sipas një marrëveshje ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme<sup>19</sup>. Gjendja e dhomës së sigurisë, për sa i përket sipërfaqes dhe kubaturës për një person, ishte në shkëlqje të kritereve të përcaktuara në aktet normative. Ajo, kishte kushte jo të mira higjieno-sanitare, ku mungonte ndriçimi natyral dhe ajrosja sigurohej nga një dritare shumë e vogël. Kushtet materiale dhe pajisja me orënditë e nevojshme ishin të plotësuara.

Sistemi i monitorimit me kamera në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm ekzistonte dhe ishte funksional. Ato mbanin në vëzhgim mjediset e këtij institucioni për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

Mjedisi i ajrimit në këtë institucion është një ambient shumë i vogël, ku mund të qëndronin 3-4 persona ulur dhe jo në këmbë. Ai ishte i pambuluar dhe hapësira e tij nuk përmbushte asnjë standard për ajrim.

<sup>17</sup> Neni 30, dhomat dhe pajisja e tyre, Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve.

<sup>18</sup> Neni 29/1 dhe 2, vendosja në dhoma, Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve

<sup>19</sup> Marrëveshja dypalëshe mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme “Për mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ndaluarve të komisariateve të policisë Sarandë, Berat, dhe Tropojë në ambientet e IEVP-ve të Ministrisë së Drejtësisë”

Kërkesat e të paraburgosurve për zhvillimin e aktiviteteve sportive nuk plotësoheshin, pasi mungonin mjediset dhe infrastruktura për zhvillimin e tyre.

Situata ishte shqetësuese, për faktin se në dhomat e të paraburgosurve thuajse mungonte ajrimi dhe drita natyrale, pasi dritaret e dhomave në njërin krah të regjimit ishin shumë të vogla dhe pozicioni i godinës e cila ndodhet gjysmë nën tokë nuk e lejonte hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale.

Mjediset e përbashkëta që duhet të ofronin arsimim, formim profesional, zhvillim të aftësive individuale, aktivitete sociale, sportive, këshillime individuale dhe në grup mungonin krejtësisht. Mungesa e këtyre ambienteve kishte sjellë pengesa në zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese, integruese dhe psiko-sociale.

Takimet me familjarët vazhdonin të zhvilloheshin në ambient me kushte relativisht jo të mira, pasi kishte mungesë të kushteve materiale. Por, nga stafi i institucionit, ishin marrë disa masave për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të këtij ambienti. Takimet me familjarët kryheshin një herë në javë. Ndërsa komunikimi me familjarët kryhej përmes aparateve të telefonave me kartë që ndodheshin në korridorin e regjimit të brendshëm.

Ashtu siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, godina e institucionit dhe mjedisi në regjimin e brendshëm, ishin të amortizuar dhe me lagështirë tej normave të lejuara.

Nga inspektimi, u konstatua se dhomat e banimit nuk respektonin standardin e kubaturës dhe sipërfaqes jetike për person të përcaktuar në aktet normative. Në disa dhoma ishin akomoduar 4-6 persona, ndërkohë që kishte të paraburgosur që flinin me dyshek në dysheme, si rrjedhojë e mbipopullimit mbi kapacitetin fizik të institucionit, të cilat përbëjnë një trajtim çnjerëzor dhe denigrues të të paraburgosurve që qëndronin në këto ambiente.

Në lidhje me kushtet fizike të dhomave, u konstatuan se dritaret e dhomave në njërin krah të regjimit të brendshëm, ishin shumë të vogla e të pamjaftueshme për ajrosje dhe ndriçim natyral, si dhe në të gjitha dhomat kishte lagështirë të theksuar. Disa nga dhomat ishin të pajisura me ventilatorë që siguronin qarkullimin e ajrit. Si pasojë e mbi popullimit si dhe hapësirave shumë të vogla të banimit, në dhomat ku mbaheshin të paraburgosurit mungonin orenditë e domosdoshme si tavolina, karrige apo stola, ndaj dhe ushqimet e veshmbathjet mbaheshin në tokë.

Mungonin shtresat, mbulesat për fjetje dhe veshje, në përputhje me kushtet klimaterike dhe nevojat shëndetësore, sipas normave të miratuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>20</sup>. Gjendja e shtresave dhe mbulesave për fjetje të institucionit nuk ishte e mirë, pasi ato ishin shumë të vjetra dhe të konsumuara, ndaj në shumicën e rasteve materialet ishin siguruar nga familjarët e të paraburgosurve.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte problematik, pasi kishte mungesa gjatë ditës. Uji i pijshëm vijonte të blihej nga të paraburgosurit. Tualetet dhe dushet ishin të përbashkëta, në kushte tejet të amortizuara dhe me higjienë që linte për të dëshiruar.

Në ambientin e paraburgimit ndodheshin 1 (një) dhomë dushi dhe 2 (dy) tualete, por ato ishin të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e higjienës personale. Dushet zhvilloheshin dy herë në javë

---

<sup>20</sup> Neni 31, veshjet dhe pajisjet e fjetjes, Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve.

shpesh mungonte edhe uji i ngrohtë. Sistemi i ngrohjes mungonte dhe gjatë periudhës së dimrit ngrohja bëhej me pajisjet e siguruara nga vetë të paraburgosurit.

Për larjen e ndërresave të të paraburgosurve, mungonte lavanderia, por si e tillë shërbente një lavatriçe e cila funksiononte dhe ishte e vendosur në hyrje të regjimit të brendshëm.

Kuzhina e IEVP-së Sarandë ndodhej në një ambient pranë zyrave të administratës dhe ishte rikonstruktuar dhe pajisur me orënditë e nevojshme. Ajo ishte e pastër dhe e rregullt, e pajisur me frigorifer dhe bolier, por mungonte aspiratori. Menyja ditore dhe gramaturat ishin të afishuara në përputhje me rregulloren dhe kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, të kyçura me çelës. Në momentin e inspektimit, në institucion nuk kishte persona të cilët të kishin nevojë për dietë ushqimore specifike.

Grupi i inspektimit konstatoi si problematikë kryesore, varësinë e dyfishtë për administrimin e disa ambienteve që ndodheshin në territorin e këtij institucioni, atë të Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë. Kjo problematikë refleктоhej në mungesën e menaxhimit, të miradministrimit dhe përgjegjësisë së këtyre institucioneve për rikonstruksionin e këtyre ambienteve.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, mungonin pothuajse aktivitetet sociale dhe rehabilituese, për shkak të mungesës së ambienteve të përbashkëta për kryerjen e tyre. Biblioteka nuk ekzistonte si ambient në këtë institucion. Sipas organikës së miratuar, sektori i kujdesit psiko-social përbëhej nga një specialist i kujdesit social. Ambienti i destinuar për të ushtruar detyrën specialisti i shërbimit psiko-social ishte një dhomë e vogël brenda në regjim me kubaturë 1.5m x 2 m. Në këtë ambient, mungonte baza e nevojshme materiale dhe shërbimi edukimit ishte pothuajse jo funksional..

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, u konstatua se raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit, plotësoheshin formalisht, pasi mungesa e ambienteve të përbashkëta e bënte të pamundur realizimin e tyre. Aktivitetet konsistonin kryesisht në zhvillimin e disa lojërave në tavolinë.

Sa i takon shërbimit shëndetësor, Organika e sektorit të shëndetësisë ishte plotësuar me mjek me kohë të pjesshme dhe 4 (katër) infermierë me kohë të plotë, të cilët realizonin detyrat funksionale në kushte infrastrukurore dhe financiare të vështira. Ambienti ku kryheshin vizitat mjekësore ishte një mjedis i vogël dhe nuk kishte orënditë e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Dhënia e ilaçeve të paraburgosurve kryhej sipas recetës së firmosur nga mjekut, me ilaçe të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ilaçe të siguruara nga fondi në dispozicion të këtij institucioni. Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte për shkak të mungesës së marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos farmaceutike dhe në shumë raste ilaçet siguroheshin nga familjarët e të paraburgosurve. Kishte ankesa të shumta në lidhje me vonesat në kryerjen e vizitave shëndetësore, si dhe mungesën e shërbimit stomatologjik. Këto shërbime sipas rastit, trajtoheshin në spitalin rajonal të Sarandës ose në klinikat shëndetësore private. Në këtë institucion mungonte autoambulanca dhe në rastet e emergjencave shërbimi ofrohej me mjetet e urgjencës të spitalit rajonal Sarandë.

Në këtë institucion kishte regjistër për evidentimin e rasteve të dhunës, por nuk kishte të regjistruar asnjë rast dhune. Gjithashtu, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin plotësuar në rregull.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar,

**Rekomanduar : “Mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, pasi me gjithë rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit për kryerjen e rikonstruksionit të plotë të godinës të këtij institucioni, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, në këtë institucion vazhdojnë të mbahen dhe trajtohen persona të paraburgosur në kushte jo humane dhe degraduese”.**

Si dhe deri në gjetjen e një zgjidhjeje për mbylljen e menjëhershme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, rekomandojmë:

Marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e situatës së mbipopullimit, marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e godinës ekzistuese të këtij institucioni, si dhe ambienteve të brendshme të tij, Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës së dhomës së observim/veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve; Marrjen e masave për adresimin dhe zgjidhjen e menjëhershme të çështjes së ambienteve të IEVP Sarandë, i cili shërbente si ambient për dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, ndarjen në dhoma më vete sipas kategorive 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, e parashikuar kjo në nenin 29, pika 1 dhe 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve; shtimin e nyjeve sanitare, riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre; krijimin e një ambienti të përshtatshëm me hapësirë dhe të plotësuar me materialet e nevojshme, i destinuar për ushtrimin e detyrës të specialistëve të sektorit të edukimit; marrjen e masave për kontraktimin e një farmacistit dhe stomatologu me kohë të pjesshme, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor; marrjen e masave për sigurimin e ilaçeve të paraburgosurve nga skema e rimbursimit duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos farmaceutike; marrjen e masave për pajisjen e institucionit me një autoambulancë; krijimin e një ambienti të ri me kushte të përshtatshme për ajrimin e të paraburgosurve, i cili të garantojë sigurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve.

## **5.8 IEVP 302 “Mine Peza” Tiranë**

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimeve Penale IEVP Mine Peza më datë 23.10. 2018, Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, konstatoi se: sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë I.E.V.P. Mine Peza është kategorizuar në dy seksione: një i sigurisë së lartë dhe tjetri i sigurisë së zakonshme, që trajton të paraburgosur me masë siguri “arrest me burg” si dhe një kontingjent të



vogël të dënuarish. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 178 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 193 persona të paraburgosur, me mbipopullim prej 23 personash, **numër ky i shtuar krahasuar një vit më parë.**

Në I.E.V.P. Mine Peza, grupi inspektues konstatoi ankesa të shumta në lidhje me mbipopullimin e shpërndarjen në dhoma, si dhe mbi vonesat në transferimet e tyre në I.E.V.P-të pranë qendrave të tyre të banimit. Problem i vazhdueshëm ishte fjetja përtokë e 12 të paraburgosurve. Ankesa të shumta u konstatuan lidhur me mungesat në ilaçe, si dhe rastet më urgjente, ashtu edhe për të sëmurët kronik të cilët shpesh mjekimin e siguronin nëpërmjet familjes. Po ashtu mungesa e një autoambulance për transportin e shpejtë drejt spitalit ishte një shqetësim. Një problematikë e pretenduar nga të intervistuarit ishte edhe vonesa në kryerjen e ekzaminimeve, analizave laboratorike e konsultave në qendrat e specializuara mjekësore.

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Nga ana e stafit të sigurisë ishte hapur një regjistër i posaçëm për pranimin e të paraburgosurve tranzit.

Sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte formalisht sipas rregullave. Të paraburgosurit në I.E.V.P. 302, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit. Ky i fundit i dërgonte në protokoll, pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, gjatë kontaktit me të paraburgosur, pati ankesa se nuk u ishte kthyer përgjigje ose se u ishte kthyer me shumë vonesë për problemet e ngritura.

-Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, sipas legjislacionit në fuqi.

-Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera funksionale sigurie. Problematika e tyre kishte të bënte vetëm me çështjen e ruajtjes së regjistrimeve, të cilat, sipas informacionit të marrë edhe nga personi përgjegjës për këtë çështje në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, qëndronin vetëm për 2 javë në memorie.

Mjedisi në regjim vijonte të ishte tejet i amortizuar dhe me lagështirë, në korridore vërehej mungesa e sistemit të ajrosjes e cila shkaktonte një mjedis të rrënduar ajrimi Kushtet materiale ishin në përmirësim, por mbetej problematike sipërfaqja e dhomave 2X5 m apo 10 m<sup>2</sup>, në të cilën qëndronin deri në pesë të paraburgosur. Në katin e parë të ndërtesës ndodhej sektori i dhomave të veçimit dhe dhomave të transitit. Këto dhoma ndryshe nga një vit më parë ishin pajisur me batanije ,çarçafë dhe karrige dhe me dollap të vegjël për mbajtjen e sendeve personale.

Konstatimet lidhur me ambientet përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.<sup>21</sup> Avokati i Popullit vlerëson se vendosja e personave në kushtet e një hapësirë jetike prej më pak se 4m<sup>2</sup> dhe larg standardeve minimale të Rregullores së përgjithshme të Burgjeve, neni 22, pika 1, *“Në strehimin e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo I.E.V.P.-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja*

---

<sup>21</sup> Një çështje e tillë është gjykuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës në rastin Sulejmanovic kundër Italisë. Gjykatësit e Strasburgut në vendimin e tyre kanë cilësuar se kufizimi i hapësirës jetike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve përtej standardeve ligjore të shteteve palë dhe ato të Konventave Ndërkombëtare përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

*e banimit jo më pak se 4 m2 për çdo të burgosur,...*” përbën trajtim degradues dhe jo human dhe shkelje të nenit 3 të KDNJ. Për sa më lart, Avokati i Popullit kërkon ndërhyrje urgjente nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të bërë të mundur ndryshimin e shpejtë të situatës në sektorë dhe garantimin e respektimit të normave të hapësirës jetike për çdo të paraburgosur.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, në I.E.V.P. 302 Mine Peza, kishte një mjedis për takimet me familjarët, me 4 sportele të ndara me zgarë hekurash, që monitorohej me kamera vëzhgimi. Kishte po ashtu, një mjedis të posaçëm për takimin me avokatët të pajisur sipas standardeve.

Grupi i inspektimit konstatoi se biblioteka përdorej si një mjedis shumë-funksional, për aktivitete fetare, social-kulturore, për ditë të veçanta festash etj.

Kuzhina, ishte një mjedis në hyrje të regjimit, e pastër dhe e pajisur me mjetet e nevojshme për gatim. Gjithashtu kampionët mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Grupi i inspektimit konstatoi se për personat diabetikë kishte të njëjtin ushqim, por të gatuar sipas dietës përkatëse. Menyja e përditshme ishte e afishuar.

Në hyrje të mjedisit të ajrimit ndodhej dhe dyqani i institucionit. Dyqani ishte i vogël dhe nuk ofronte shumë larmi artikujsh. Lista e çmimeve të produkteve ndodhej e afishuar. Të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me çmimet e larta të artikujve ushqimorë.

I.E.V.P.302 Mine Peza nuk ka ngrohje qendrore dhe grupi i inspektimit konstatoi se të paraburgosurit përdornin mjete të siguruara nga vetë ata.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale, ishte i afishuar.

Nga intervistat e realizuara me të paraburgosurit aktivitetet në bibliotekë zhvilloheshin çdo të premte, ndërkohë që aktivitetet e besimit dhe riteve fetare zhvilloheshin çdo të mërkurë dhe te premte. Ky ambient përdorej si për këshillime individuale. Një mjedis tjetër, që përdorej edhe për këshillime individuale dhe kurse për analfabetët ndodhej në katin e parë. Kjo klasë ishte e pajisur me një tavolinë të gjatë, gjashtë karrige, një dollap me disa revista dhe disa piktura të varura në mur. Dhoma e prindërimit tashmë ishte funksionale e pajisur me lodra fëmijësh në të cilën zhvilloheshin takimi me fëmijët e mitur të dënuarve.

Në dosjet psiko-edukative nuk mungonin programe individuale të trajtimit si dhe pasqyrimi i organizimit të aktivitete të përbashkëta në ta, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktiviteteve sportive. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Në momentin e inspektimit ishin disa të paraburgosur të punësuar në këtë institucion, kryesisht si pastrues, sanitar, shpërndarës ushqimi etj., por për ta nuk kishte asnjë pagesë monetare për punën që kryenin.

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga përgjegjësja e sektorit, e cila ishte dhe mjekja e institucionit, një stomatolog, një farmacist, 4 ndihmës mjekë.

Gjatë inspektimit në këtë institucion, si dhe gjatë intervistave me të paraburgosurit pretendohet nga shumica e të intervistuarve se ofrohet një shërbim bazik shëndetësor. Institucioni ishte i pajisur me një autoambulancë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, në veçanti të mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri themeltar, dhe një regjistër vizitash të sekretuar. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar** : marrjen e masave të menjëhershme lidhur me adresimin e mbipopullimit dhe respektimin e kapaciteteve zyrtare të akomodimit në kuadër të respektimit të hapësirës jetike për person;

marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të mjedisve të banimit; marrjen e masave lidhur me kushtet higjieno-sanitare dhe lagështirën në tualete dhe dushe, gjithashtu pajisjen me produkte higjieno-sanitare për çdo të paraburgosur; marrjen e masave për pajisjen e institucionit me ambulance si një emergjencë e domosdoshme; marrjen e masave për pajisjen me sistem ajrimi dhe ngrohjeje të ambienteve të I.E.V.P-së; marrjen e masave nga ana e stafit drejtues të institucionit për furnizimin e farmacisë me ilaçe, si për rastet akute, ashtu dhe ato kronike duke vënë në zbatim efektiv skemën e rimbursimit të ilaçeve.

## **5.9. IEVP DRENOVË, KORÇË**

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, datë 29.10.2018, MKPT-ja kishte për qëllim vlerësimin e kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Korçë, cilësinë e trajtimit të të dënuarve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë kishte kapacitet maksimal zyrtar prej 312 personash që sipas një studimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kapaciteti mund të arrihte edhe deri në 383 persona . Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 401 persona, nga të cilët 183 të paraburgosur (ndërkohë që 4 të paraburgosur ishin të mitur) dhe 218 të dënuar. Në seksionin e sigurisë së lartë ndodheshin 45 persona. Kishte mbipopullim me 89 persona mbi kapacitet

Mbipopullimi ishte një problematikë e këtij institucioni, problem i konstatuar përgjatë të gjitha vizitave të kryera ndër vite dhe ende i mbetur pa zgjidhje. Avokati i Popullit vlerëson se, mbipopullimi i I.E.V.P.-ve sjell si pasojë uljen e cilësisë së jetesës së personave të dënuar/paraburgosur dhe për rrjedhojë edhe cenimin e të drejtave të tyre ligjore.

Seksioni i sigurisë së lartë kishte 4 (katër) sektorë me një total prej 34 dhomash dhe 68 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Seksioni i paraburgimit kishte 4 ( katër) sektorë me një total prej 34 dhomash

dhe 164 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Seksioni i sigurisë së zakonshme kishte një total prej 44 dhomash dhe 257 shtretër si dhe 4 klasa dhe 4 magazina. Sektori i observimit kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër të cilat ishin reduktuar për shkak të mbipopullimit në 2(dy) dhoma. Sektori i izolimit kishte 10 dhoma dhe 10 shtretër. Në total Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Korçë dispononte 531 shtretër. Në institucion nuk kishte asnjë person që kishte shtrat të improvizuar në tokë.

Organika e punonjësve të policisë të rolit bazë ishte 12% e paplotësuar, pasi mungonin 17 punonjës dhe organika e punonjësve të policisë së rolit drejtues ishte 20% e paplotësuar, pasi mungonin 3 oficerë drejtimi. Gjithashtu nuk ishte i plotësuar pozicioni i mjekut me kohë të plotë dhe funksionojë me mjek me kohë të pjesëshme.

Nuk u evidentuan pretendime për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve, por kishte ankesa për mbipopullimin.

Ankesa kishte për kushtet e ambienteve të vuajtjes së dënimit, dhe veçanërisht të ambienteve të paraburgimit të cilat kishin nevojë për riparime pasi kishin lagështirë të theksuar dhe në mënyrë të veçantë tualetet brenda dhomave kërkonin riparime për të garantuar higjienën e nevojshme.

Gjithashtu ankesa kishte për sigurimin me ngrohje në I.E.V.P.Korçë për t'iu përshtatur kushteve klimaterike nisur edhe nga fakti që rajoni i qarkut të Korçës karakterizohet nga temperatura të ftohta gjatë vitit.

Problem shumë serioz ishte çështja e furnizimit me ujë të institucionit, si dhe mungesa e ujit të ngrohtë në dushe, ku si rezultat i mbipopullimit kishte probleme në frekuentimin nga të burgosurit.

Dushet ndodheshin në çdo seksion, përjashtuar ambientin e parashikuar për observim. Në ambientet ku bëhej dushi kishte lavamanë dhe katër ose pesë dushe, si dhe vihej re prania e lagështirës ose mungesa e kokave të dusheve. Nga intervistat që u bënë në të gjitha sektorët u pohua se dushi realizohej përgjithësisht një herë në javë.

Cilësia e ujit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Korçë nuk ishte e mirë dhe furnizimi me ujë kishte probleme. Furnizimi me ujë nuk kryhej 24 orë në ditë por kryhej me orar përmes dy puseve, pasi nuk ekzistonte lidhja me rrjetin. Në disa dhoma ishin vendosur aparatura shtesë për ngrohjen e ujit në lavamanët e brendshëm pasi uji përgjithësisht vinte i ftohtë. Shumica e të intervistuarve pohuan se e blinin ujin e pijshëm, pasi uji prej rubinetit ishte jo i pastër dhe nuk mund të pihet, veçanërisht në ditët me shi.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit e konsideronin shërbimi mjekësor në këtë institucion jo në nivelin e duhur dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte dhe për ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse edhe për shërbimin stomatologjik i cili nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve dentare. Lidhur me këtë problematikë blerja dhe sigurimi i ilaçeve sigurohej përkohësisht nga blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P. Burgjeve. Gjithashtu dhe blerjet e medikamenteve të urgjencës siguroheshin nga ky fond.

Ankesa kishte edhe për numrin e kufizuar të aktiviteteve rekreative në I.E.V.P.Korçë.

Të paraburgosurit ishin në seksion më vete nga të dënuarit. Ata realizonin ajrimin dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta veçmas nga të dënuarit. Përsa i përket të miturve, nga vëzhgimet dhe intervistat e

kryera rezultonte se ata ishin të shpërndarë nëpër dhoma të ndryshme. Të miturve të cilët ishin 4 (katër) në total dhe gjendeshin në dhomat e spitalit të burgut, nga dy persona në dhomë u ofroheshin lehtësira në ajrim.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Korçë kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 40 ditore.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit apo të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Në I.E.V.P. Korçë ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosurit/dënuarit që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë, me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike.

Në I.E.V.P. kishte disa të dënuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Të dënuarit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Kjo procedure ndiqej pasi ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme për të garantuar të drejtën për punësim dhe për shpërblim të drejtë të punës, për të burgosurit, sipas standardeve ligjore në fuqi.

Pothuajse në të gjitha seksionet si në atë të sigurisë së zakonshme dhe në atë të sigurisë së lartë baza materiale ishte e plotësuar. Përrjashtim përbënte seksioni i paraburgimit dhe ai i observimit i kthyer në ambiente banimi për të paraburgosurit si rrjedhojë e mbipopullimit.

Edhe në ambientet e përbashkëta, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Korçë kishte bazë materiale të shpërndarë sipas nevojave.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Korçë ekzistonte një godinë e cila shërbente si spitali i këtij institucioni. Në katin e parë të tij gjendej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe farmacia. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues, por nga biseda më të dënuarit dhe të paraburgosurit u theksua se kishte nevojë për furnizim me një pjesë të mirë të materialeve/medikamenteve dentare për të funksionuar në normalitet. Në këtë institucion punonte një stomatolog. Dhoma e mjekut dhe farmacia ishin të lyera dhe të mirëmbajtura. Ndërsa në katin e dytë ishin 8 dhoma me shtretër, ku në dy prej tyre ishin shpërndarë të miturit dhe në dhomat e tjera ishin vendosur të sëmurët me sëmundje të rënda. Në spital ndodheshin banjat me dy tualete dhe një post dushi.

Problematika u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistonin kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloheshin me kontributet e sjelljes nga familja.

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte më mirë për të dënuarit, ndërkohë që më i vështirë bëhej zbatimi i kësaj skeme për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin të më të vështirë sigurimin e ilaçeve me anë të skemës së rimbursimit të ilaçeve.

Ndërsa për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai kishte probleme për shkak të mungesës së bazës materiale megjithëse uniti dentar funksiononte.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P.Korçë përbëhej nga 1(një) mjek, me kohë të pjesshme ( mjek psikiatër) 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 6 (gjashtë) ndihmës mjekë. Mjeku aktual punonte me kohë të pjesshme në këtë institucion dhe si rezultat i mbipopullimit ishin shtuar numri i vizitave mjekësore si në I.E.V.P.Korçë, ashtu dhe ato të specializuara pranë Spitalit të Burgjeve dhe Spitalit Rajonal të Korçës.

Dhoma e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin përgjithësisht në gjendje të mirë. Dhoma e infermierisë, farmacia dhe dhoma e stomatologut ishin me kushte të mira higjieno-sanitare. Në një institucion u vu re se mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Korçë sipas kontratës tre palese ISKSH, depo farmaceutike nuk funksiononte.

Seksioni i sigurisë së zakonshme ishte në godinën B përbërë nga dy kate me nga katër sektorë për çdo kat. Në dhoma ishin akomoduar 4-6 persona, në maksimum të kapacitetit. Ky rast përbën shkelje të standardit ligjor lidhur me sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për një person<sup>22</sup>, si dhe është në kundërshtim me rekomandimet e bëra nga CPT për Shqipërinë.<sup>23</sup> Në disa dhoma nuk funksiononin kaloriferët. Ngrohja sigurohej vetëm për 3-4 orë në ditë, kohë e pamjaftueshme, referuar kushteve klimaterike të kësaj zone.

Seksioni i sigurisë së lartë ishte i ndarë në 4 sektorë për të dënuar me siguri të lartë, dhe 4 sektorë për të paraburgosur siguri e lartë. Kryesisht kati i parë i sektorit të të dënuarve kishte një shpërndarje nëpër dhoma me nga një të dënuar. Dhomat ishin të pajisura me tualete brenda. Ndërsa kati i dytë i këtij sektori të paraburgimit shfaqej më i mbipopulluar.

Sektori i observimit kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër të cilat ishin reduktuar për shkak të mbipopullimit në 2(dy) dhoma të cilat nuk plotësonin standard normale jetese, dhe kishte lagështi, si dhe dritare që nuk mund të hapeshin. Në sektorin e observimit ditën e inspektimit gjendeshin 2 persona.

Në këtë sektor gjendeshin 2(dy) tualete të përbashkëta për të gjitha dhomat. Problematike ishte çështja e bërjes së dusheve jashtë kësaj godine, dhe se nuk kishte hapësirë për ajrosje. Në sektorin e izolimit kishte 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Ky seksion kishte ambient ajrimi.

Në I.E.V.P. Korçë kishte palestra, klasa dhe dhoma këshillimi. Kishte një sallë kompjuterësh dhe të gjithë kompjuterët ishin në gjendje funksionale. Palestrat ishin pajisur me mjete të sjella nga vetë të dënuarit. Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në futboll, volejbol dhe lojëra tavoline siç janë lojëra me letra dhe domino. Ambienti i kultit ishte i bollshëm, i ndriçuar dhe i mirëpajisur.

<sup>22</sup> Shiko nenin 30 pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

<sup>23</sup> Albania: Visit 1997 [par.127] Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) pranë Këshillit të Europës me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare:

"Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6 m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

Kuzhina e institucionit ishte e madhe dhe moderne, me higjienë të mirë. Muret e kuzhinës ishin veshur me pllaka së fundmi. Kishte edhe 2(dy) paradhoma ku njëra shërbente si magazinë për ushqimet dhe një tjetër për larjen e enëve. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menjya ditore ishte e afishuar.

Në I.E.V.P. Korçë larja në dushe zhvillohej mesatarisht një deri në dy herë në javë. Edhe në ambientin e dusheve u konstatua sërish lagështirë kokat e dusheve ishin të dëmtuara, dhe kishte amortizim të pllakave.

Në kishte lavanderi gjendeshin dy lavatriçe. Për përsa i përket larjes së rrobave të të burgosurve dhe atyre të fjetjes vazhdonin të laheshin nga familjarët në pjesën më të madhe të rasteve ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre.

Në lidhje me ajrimin u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta në raport me numrin e personave dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa. Sipas stafit të institucionit të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar** : marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në I.E.V.P., Korçë; marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështirë dhe lyerjen e dhomave të paraburgimit në I.E.V.P. Korçë; marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.P. Korçë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në I.E.V.P. Korçë sipas kontratës tre palëshe ISKSH, depo farmaceutike; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit; marrjen e masave për pajisjen e I.E.V.P. Korçë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit; marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë stomatologjik; marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim; marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive; marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në tualetet e dhomave të banimit të paraburgosurve/dënuarve; marrjen e masave për riparimet e nevojshme të ambienteve të dusheve në Institucion; marrjen e masave për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit bazë dhe të rolit drejtues; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e sektorit shëndetësor me regjistrin për evidentimin e rasteve të dhunës.

## 5.10 IEVP VAQARR

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqarr më datë 03.12.2018, MKPT-ja kërkoi fillimisht një informacion në lidhje me situatën e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve/dënuarve në këtë institucion, mënyrën e trajtimit të kërkesë/ankesave, vënien në dispozicion të dokumentacionit në lidhje me strukturën, organikën dhe aktivitetin e sektorëve juridik, psiko-social dhe shërbimit shëndetësor, si dhe për masat e marra në zbatim të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqar klasifikohet si “burg i sigurisë së ulët”, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion burg i hapur për të dënuarit me vendim gjykate (gjysmë liri).

Kapaciteti fizik i I.E.V.P Vaqar ishte për akomodimin e 140 personave të paraburgosur, në ditën e inspektimit, në mjediset e këtij institucioni numri i personave të paraburgosur dhe të dënuarve ishte 154 persona, nga të cilët 153 të paraburgosur dhe 1 i dënuar, me mbipopullim prej 14 personash mbi kapacitet. Në këtë institucion ishin 6 të paraburgosur të cilët i përkisnin kategorisë 18-21 vjeç të vendosur në seksion të veçantë për këto moshë, 6 persona të sëmurë mendorë dhe 9 persona që ishin diagnostikuar me sëmundjen e diabetit.

Në ambientin e observim/veçimit, ishin 3(tre) persona, nga të cilët njëri prej tyre ishte me kërkesën e tij për mospërshtatje, për shkak të orientimit seksual ndryshe (homoseksual) dhe dy të tjerë të ndëshkuar me masë disiplinore.

Nga 40 dhomat e destinuar për banim të paraburgosurve, në 34 prej tyre ishin të pajisura me lavamanë dhe dushe brenda në dhoma. Veç tyre, për çdo sektorë kishte dhe ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e trupit.

Marrëdhëniet ndërmjet personelit të Institucionit dhe të paraburgosurve e të dënuarve ishin korrekte dhe nuk pati ankesa nga këta të fundit.

Organika e institucionit ishte e plotësuar dhe nuk kishte mungesë stafi në sektorët kryesorë që ofrojnë shërbimet bazë si për ruajtjen dhe sigurinë e institucionit, në sektorin juridik, sektorin psiko-social, shërbimin mjekësor dhe në personelin e guzhinës.

Në I.E.V.P. Vaqar në momentin e inspektimit nga 25 të paraburgosur të punësuar në organikë, ishin të punësuar 22 të paraburgosur kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë. Sipas informacionit të drejtuesit të Institucionit, me të paraburgosurit e punësuar nuk ishin lidhur kontrata pune që rregullojnë marrëdhëniet e punës, pasi me marrjen e vendimit nga gjykatat këta persona menjëherë ose lirohen ose transferohen për në Institucionet e tjera penitenciare. Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, mungesa e lidhjes të kontratës të punës me të paraburgosurit e punësuar, është shkelje e një të drejte e sanksionuar në aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, por kryesisht në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve përcaktohet se “*Të paraburgosurit apo të dënuarit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike... ..Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës,*



*me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëlloj edhe për të paraburgosurit e të dënuarit*<sup>24</sup>.

Nisur nga ky konstatim, sjellim gjithashtu në vëmendje se punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet sipas neneve 34, 35 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar<sup>25</sup> dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve<sup>26</sup>.

Për rastet e kërkesë/ankesave i drejtoheshin drejtuesit të Institucionit, punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte ato në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim ose merrte takim me vetë të paraburgosurit. Në regjistrin e kërkesë/ankesave ishte e pasqyruar me shkrim se nga cili anëtar i stafit merrej ajo, mënyra e trajtimit dhe e zgjidhjes së saj.

të paraburgosurit e grup moshës 18-21 vjeç ishin të akomoduar në seksion të veçantë dhe për trajnimin e tyre më vete kishte një program psiko-social. Po ashtu, aktivitetet e përbashkëta zhvilloheshin në orare të ndryshme nga personat e tjerë madhorëm në zbatim të rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm në këtë Institucion.

Institucioni mbikqyrej nëpërmjet sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi, të cilat ishin vendosur në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Monitorimi kryhej për 24 orë, ndërsa filmimi ruhej për dy javë. Qartësia e pamjeve të kamerave të sigurisë ishte e mirë.

Kontakti i të paraburgosurve dhe i të dënuarve me botën e jashtme realizohej nëpërmjet takimeve me familjarët, të cilat zhvilloheshin rregullisht. Për realizimin e kësaj të drejte në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vaqar kishte dy ambiente takimi me familjarët dhe një ambient prindërimi në distancë. Në këtë ambient, kishte edhe një dhomë për takime speciale e cila ishte me kushte normale dhe e pastër, si dhe e pajisur me tualet dhe dush më vete. Ky ambient përdorej shumë rrallë nga të paraburgosurit, ndaj kjo dhomë shërbente edhe për takim me avokatët.

Gjithashtu, komunikimi me telefon i të paraburgosurve dhe i të dënuarve me familjarët e tyre bëhej normalisht, sipas numrit të telefonatave të parashikuara në rregullore që është 8 telefonata në muaj.

Sipas infrastrukturës, godina e banimit ishte me dy kate të ndara në dy seksione për çdo kat. Ndërkohë që çdo seksion ishte i ndarë në dy sektorë të tjerë. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete dhe dushe brenda. Dhomat ishin të pajisura me materiale dhe orenditë e nevojshme për jetese si shtretër, dyshekë, batanije, çarçafë, tavolina, dollapë, stola për të gjithë të paraburgosurit.

Pastërtia dhe higjiena në korridoret dhe në dhomat e të paraburgosurve ishte e mirë. Dyshekët ishin në gjendje relativisht të mirë, ndërsa batanijet dhe çarçafët në një pjesë të tyre ishin sjellë nga familjarët e të paraburgosurve. Gjithashtu, Institucioni nuk kishte sistem ngrohje qendrore, por në periudhën e dimrit të paraburgosurit ngroheshin me pajisje elektrike të siguruar nga familjarët e tyre.

---

<sup>24</sup> Neni 54, Kreu XII, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

<sup>25</sup> Nenet 76 dhe 77 të ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

<sup>26</sup> Nenet 54/3 dhe 54/4/a të Rregullores të Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015

Ndër problematikat kryesore që u konstatuan gjatë inspektimit të infrastrukturës ishte, prezenca e lagështirës e cila ishte shumë shqetësuese në katin e parë të godinës ku pothuajse i gjithë muri i jashtëm ishte tejet i amortizuar. Lagështira ishte prezentë edhe në katin e dytë, kryesisht në pjesën e mureve ngjitur me tualetet. Kjo situatë, përbën një problem shqetësues dhe me pasoja të rënda në shëndetin e të paraburgosurve që jetojnë aty.

Dhomat e observim/veçimit ishin në katin e parë të godinës. Për të plotësuar funksionet e observimit dhe veçimit shërbente një godinë e përbërë nga gjashtë dhoma me kapacitet maksimal 12 persona. Sipërfaqe dhe kubatura e dhomave ishte për akomodimin e dy personave. Në sektorin e observim/veçimit, kishte një ambient që shërbente si tualet dhe një ambient dushi për larjen e trupit, nga të paraburgosurit që ndodheshin aty për arsye të mospërshtatjes apo për masë disiplinore. Ambienti i tualetit dhe dusheve kishte ujë të ngrohtë dhe ishte i plotësuar me pajisje hidrosanitare. Ky ambient kishte lagështirë, por ajo ishte në nivele të ulta krahasuar me lagështirën në ambientet e paraburgimit.

Nga inspektimi i dhomave të banimit u konstatua se përmasat e dritareve ishin në përputhje me parametrat e nevojshëm dhe mundësonin futjen e dritës natyrale dhe ajrimin. Gjithashtu dhomat kishin hapësirë, por kubatura dhe sipërfaqja në 4 (katër) dhoma ku ishin sistemuar 6 të paraburgosur, nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur standardin, respektivisht jo më pak se 9 m<sup>3</sup> dhe jo më pak se 4 m<sup>2</sup> për çdo person.<sup>27</sup> Por, pavarësisht mbi popullimit, nga inspektimi rezultoi se, asnjë i paraburgosur nuk flinte me dyshek të vendosur në dysheme, por ishin të plotësuar me shtretër.

Gjatë vizitës u konstatua se, në ndryshim nga vizita e mëparshme, institucioni e kishte zgjidhur problemin e furnizimit me ujë me anë të rrjetit, duke vendosur disa cisterna në oborrin e institucionit. Megjithatë uji vazhdonte të ishte me orare, tre herë në ditë dhe këto orare ishin nga dy orë. Gjatë intervistave pati ankesa nga të burgosurit në lidhje me oraret e furnizimit me ujë, pasi kushtëzonte në kohë kryerjen e dusheve, larjen e ndërresave dhe enëve të ushqimit. Gjithashtu, pati edhe pretendime se uji ishte i papastër dhe i turbullt. Lidhur me këtë shqetësim, drejtuesi i institucionit sqaroi se kufizimet e vendosura për furnizimin me ujë, kishte të bënte me oraret e përcaktuara nga Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, ndërsa uji i turbullt vinte për shkak të amortizimit të rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit.

Institucioni ishte i pajisur me lavanderi dhe lavatriçe profesionale, por pjesa më e madhe e të paraburgosurve dhe e të dënuarve i lanin vetë ndërresat e tyre. Nga ana e institucionit bëhej furnizimi i të paraburgosurve me detergjente të higjienës personale, sipas normave, por një pjesë e tyre merrnin detergjente shtesë nga familjarët e tyre, pasi ato ishin të pamjaftueshme.

Nga inspektimi që u zhvillua në kuzhinën e këtij institucioni, u konstatua se, ajo ishte në gjendje të mirë dhe e pajisur me orënditë e nevojshme bazë. Kuzhina ishte e lyer dhe e pastër nga ana higjienike. Punonjësit që punonin aty ishin të pajisur me libeza shëndetësore. Cilësia e ushqimit të gatuar në ditën e inspektimit dukej e mirë. Evidencat e gramaturave dhe menyja ditore mbaheshin konform rregullave dhe ishin të afishuara. Gjithashtu ishin të afishuara edhe menyja dhe gramatura përkatëse për diabetikët dhe personat e punësuar. Kampionet e ushqimit të gatuar një ditë më parë ruheshin për 24 orë në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se nuk kishte ankesa për ushqimin. Pothuajse pjesa më e madhe e tyre e konsumonin ushqimin e gatuar në institucion. Vijonte te mungonte aspiratori dhe ventilatori për largimin e avujve.

---

<sup>27</sup> Neni 30, pika 1 e VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

Aktivitetet në këtë institucion zhvilloheshin sipas një programi vjetor të sektorit psiko-social, i cili ishte i detajuar në javë dhe muaj dhe ishte i miratuar nga drejtuesi i Institucionit. Aktivitetet kryesore që zhvilloheshin në këtë institucion ishin ato me karakter kulturor, futbolla dhe pingpongu. Në ambientet e katit të dytë në sektorin II gjendej dhe salla e aktiviteteve, e cila kishte disa funksione. Ajo shërbente si sallë aktivitetesh, kompjuterësh dhe takimesh të përbashkëta. Gjithashtu brenda këtij ambienti, por në një dhomë më të vogël ndodhej edhe biblioteka ku kishte libra të cilët ishin kryesisht tituj të vjetër dhe ngelet për tu pasuruar më shumë me tituj të rinj të librave. Gjithashtu në këtë ambient zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta dhe ritet fetare.

Ajrimi i personave që ndodhen në këtë institucion bëhej dy herë në ditë, dy orë paradite dhe një orë mbasdite. Ambienti i ajrimit kishte infrastrukturën e përshtatshme, pasi një pjesë e këtij ambienti ishte mbuluar, kryesisht për rastet kur kushtet atmosferike nuk ishin të favorshme për kryerjen e ajrimit.

Dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve plotësoheshin nga stafi i edukimit në mënyrë periodike. Punonjësit e edukimit bënin takime individuale me çdo të paraburgosur e të dënuar të cilat zhvilloheshin në sallën e këshillimit. Stafi i edukimit kishte zhvilluar diskutime për tema të ndryshme që kishin ndihmuar të paraburgosurit në procesin e përshtatjes në këtë institucion.

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion ishte e plotësuar dhe përbëhej nga 7 punonjës, një mjek, një stomatolog, një farmacist dhe 4 infermierë, me kohë të plotë. Shërbimi shëndetësor funksiononte me tre turne.

Farmacia e këtij institucioni ishte në gjendje të rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike dhe ato për sëmundjet akute. Furnizimi me ilaçe bëhej me skemën treshe, për të sëmurët kronikë ilaçet siguroheshin nga skema e ribursimit, për rastet e sëmundjeve të zakonshme furnizimi me ilaçe kryhej nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe, për rastet akute furnizimi me ilaçe bëhej menjëherë nga farmacisti dhe përballohej nga fondi që kishte në dispozicion ky institucion.

Në këtë institucion ishin 6 të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor dhe 9 persona diabetik. Gjithashtu kishte katër persona të cilët trajtoheshin me medikamentin “metadon”. Trajtimi dhe ndjekja e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor bëhej pas vizitave, konsultave dhe rekomadimeve të bëra nga mjeku psikiatër i Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, i cili vinte mbi bazën e kërkesës së personelit mjekësor të këtij institucioni.

Dhoma e vizitave të mjekut ishte e rregullt, e pastër, e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, ndërsa në mesin e administratës dhoma e mjekut kishte një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me çelës.

Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me autoklavë dhe instrumente dentare të cilat ishin të amortizuara, por sipas mjekut ishin funksionale. Shërbimi stomatologjik ofronte vetëm mjekime të urgjencës dhe ndonjë rast heqje dhëmbësh. Ndërkohë stomatologu nuk ofronte shërbim për mbushjen e dhëmbëve dhe të dhëmballëve, për shkak të mungesës të mjeteve dhe instrumenteve dentare. Në rastet kur kishte kërkesa dhe probleme për mbushje të dhëmballëve, personat e paraburgosur apo të dënuar dërgoheshin tek stomatologët privat. Në rast se ky shërbim do t'u ofrohej të paraburgosurve brenda Institucionit, ky shërbim do të ishte më i shpejtë dhe pa kostot shtesë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekut, regjistri themeltar i të paraburgosurve dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Institucioni kishte një autoambulancë, por nuk ishte funksionale dhe nuk ishte e pajisur me mjetet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduar** : marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në I.E.V.P Vaqar; marrjen e masave të menjëhershme për kryerjen e hidroizolimit të tarracës së godinës dhe rikonstrukcionin e mureve të jashtme të dhomave të banimit e tualeteve në veçanti, për eliminimin e lagështirës, e cila ishte tej normave të lejuara; marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Ujësjiellës Kanalizimeve, Tiranë, për riparimin e pjesëve të rrjetit të ujësjiellësit, që është amortizuar, për furnizimin me ujë të këtij Institucioni dhe eliminimin e problemit të furnizimit me ujë të turbullt; marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomës së stomatologut me pajisjet dhe materialet dentare të nevojshme, në mënyrë që të ofrohet një shërbim efikas stomatologjik; marrjen e masave të nevojshme për të pajisur autoambulancën e institucionit me mjetet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë; marrjen e masave të nevojshme për të vendosur në ambientet e kuzhinës, I.E.V.P Vaqar dhe të paraburgosurve të punësuar.

## 5.11 IEVP BERAT

Gjatë vizitës në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat më datë 15.11.2018, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, rezultoi se rekomandimet e mëparshme kishin gjetur zbatim, ndërkohë që mbeten të porealizuara një sërë rekomandimesh. Edhe pse ambientet e kësaj I.E.V.P-je ishin të reja, zilet e emergjencës në dhoma, brenda në regjim, nuk ishin funksionale. Ndërkohë nga inspektimi i kryer disa ambiente si dhoma e stomatologut, dyqani i I.E.V.P-së, salla e televizorëve, palestra dhe lavanteria e I.E.V.P-së, ishin jofunksionale për shkak të mungesës së orendive.

Institucioni ka kapacitet maksimal zyrtar prej 168 personash. Në momentin e vizitës inspektuese, në mjediset e institucionit ishin 137 persona të privuar nga liria prej të cilëve 105 të dënuar dhe 32 të paraburgosur.

Grupi i monitorimit në informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit konstatoi si rast flagrant dhune dhe përdorimi të forcës, rastin e të dënuar. R.B që ishte dhunuar nga dy punonjës sigurie, nga një konfrontim verbal punonjësit e sigurisë e kanë dhunuar. Nga pamja e parë vizuale vërehej se kishte hematomë në syrin e djathtë. Nga këqyrja e kamerave të institucionit nga ana e MKPT-së, vërehej qartazi se punonjësit e sigurisë D. K dhe S. D, në po atë ditë dhe orë që denoncon i dënuari, kanë qenë me të në infermieri rreth orës 20 deri 21.

*“Drejtuesit e institucionit duhet të marrin hapa konkrete lidhur me eliminimin e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës.*

*Hetime të shpejta dhe efektive, të cilat mundësojnë identifikimin dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për keqtrajtim ndaj të burgosurve, janë esenciale për t'i dhënë vlerë reale parimit dhe detyrimit ligjor për ndalimin e torturës dhe trajtimit degradues dhe jo human dhe ndëshkues në burgjet tona”<sup>28</sup>*

Në I.E.V.P Berat, në momentin e inspektimit, nga të paraburgosurit pati ankesa të cilat kishin të bënin me mungesën e komunikimit me juristin e institucionit, mungesën e shërbimit të mjekut stomatolog, mungesën e medikamenteve dhe vizitave të mjekut.

Ndërsa Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Dhomat e observim/veçimit ndodheshin në regjim, 4 dhoma veçimi me nga një shtrat të vendosur brenda këtyre ambienteve dhe një dhomë observimi, e cila ishte e pajisur me nga 4 shtretër. Ekzistonte sistemi i kërkesë/ankesave, të paraburgosurit dhe të dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese që administrohej nga Sektori i Edukimit, i cili i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit drejtori i institucionit, kthente përgjigje ose ia shpërndante për trajtim sektorëve të ndryshëm, brenda ditës ose për 3 ditë.

Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të telefononin dhe të flisnin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjediset e ajrimit dhe në regjim, sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera sigurie.

Mjedisi në regjim, përbëhej nga 2 godina, me dy sektorë secila, me një hapësirë midis të dy godinave, ku në katin e parë ndodhej kuzhina e I.E.V.P-së dhe në katin e dytë ndodheshin salla e TV, palestra, biblioteka, ambientet e kultit fetar, tualetet e përbashkëta të këtyre ambienteve. Dhomat e banimit akomodonin nga 2, 4 deri në 6 persona. Gjithashtu, u konstatua se dhomat ishin të pajisura me tavolina, karrige, apo pajisje elektro-shtëpiake. Dhomat kishin tualete të brendshme, në korridoret e regjimit të brendshëm kishte stola të cilët përdorehin për raste festash apo aktivitete nga të paraburgosurit. Gjithashtu këto korridore ishin të pajisur me kabina telefoni të cilat mund të përdorehin nga të paraburgosurit. Në regjimin e brendshëm të çdo godine kishte dhoma këshillimi të cilat ishin jofunksionale për shkak të mungesës së orëdive.

Në ambientet e brendshme të regjimit, në I.E.V.P Berat, u vërejt se kishte një dhomë observimi dhe katër veçimi si dhe një dhomë, e cila përdorej për prindërimin në distancë. Gjithashtu në ambientet midis dy godinave gjendej dhe dhoma për takimin me avokatët dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës. Kushtet e dhomave në regjim ishin brenda standardeve, me ndriçim natyral dhe artificial, pasi dritaret ishin të hapura me përmasa brenda standardeve, gjë që lejonte hyrjen e dritës natyrale dhe ajrimin brenda në dhomë. Në institucion kishte sistem qendror ngrohjeje, më kaldajë e cila funksiononte me orare të ndryshme sipas një udhëzimi të Drejtorisë së përgjithshme të Burgjeve nga janari 2017. Në dy godinat e I.E.V.P Berat kishte pesë ndarje ajrimi, një fushë futbollli dhe një fushë volejbollli. Grupi i inspektimit konstatoi se në mjediset e jashtme, që përdorehin për ajrim të dënuarit dilnin me orare të cilat vajonte nga 2 ore deri në 3 orë. Të paraburgosurit dhe të dënuarit lejoheshin të dilnin në ajrim të ndarë dhe në orare të ndryshme dhe se nuk kishin pasur probleme në këtë drejtim. Gjithashtu kishte ambiente për aktivitete këshilluese, fetare, kulturore, sportive etj. Biblioteka konsistonte në një dhomë me disa rafta të vendosura në mur dhe një tavolinë të madhe plotësuar me karrige. Në bibliotekë nuk kishte më tepër se 100 tituj librash. Ambientet e kultit ishin të

<sup>28</sup> Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve

ndara sipas përkatësisë fetare mysliman dhe të krishterë. Për besimtarët e fesë myslimane ambienti ishte funksional ndërsa për besimtarët e krishterë ambienti kishte nevojë për mobilim me orenditë përkatëse. Pati ankesa mbi pajisjen e të paraburgosurve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh etj. Kuzhina, ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme midis dy godinave. Ambienti ishte brenda standardeve, në kushte shumë të mira hijeno-sanitare. Pajisjet në të ishin të reja dhe kampionët ushqimorë mbaheshin në frigorifer të mbyllur me dry. Në kuzhinë punonin katër kuzhinierë dhe një punonjës mirëmbajtje. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit u informua se pjesa më e madhe e të paraburgosurve e konsumonin ushqimin e institucionit ndërsa një pjesë e merrnin nga familjarët.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale ishte i afishuar. Në ambientet e IEVP-së ishin të afishuara posterat e Avokatit të Popullit, ku specifikoheshin të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve gjithashtu edhe numrat e kontaktit. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet që kryej sipas parashikimeve ligjore. Duke marrë në konsideratë faktin se në regjim mjediset e aktiviteteve sociale, kulturore ishin akoma jofunksionale për shkak të mungesës së orendive, në I.E.V.P Berat nuk kishte mundësi realizimi të aktiviteteve kulturore, ndërsa aktivitetet edukative zhvilloheshin në bibliotekë. Nga takimi me punonjës të sektorit të kujdesit social, si edhe nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit vuri re një komunikim dhe ndërveprim shumë të mirë të ndërsjelltë mes tij dhe të paraburgosurve. Disa nga dosjet ishin të rregullta, ku përfshiheshin përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit dhe të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, ndërsa në disa të tjera kishte ende elementë për të plotësuar.

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek dhe stomatolog me kohë të pjesshme dhe pesë ndihmës mjekë, dhe një farmacist. Përgjithësisht vizitat dhe ndërhyrjet mjekësore nga ana e stafit mjekësor ishin realizuar në kohë. U konstatuan se kishte ankesa të shumta për shërbimin stomatologjik, i cili ishte jofunksional për arsye se dhoma e mjekut stomatolog nuk ishte e kompletuar me pajisjet përkatëse dhe mungonin kushtet e ofrimit të këtij shërbimi. Gjatë inspektimit u vërejt se institucioni kishte marrë masa për kompletimin e dhomës së stomatologut dhe po punohej në të. Në këtë institucion kishte dhomë mjeku, farmacisti dhe infermierie të pajisura me orendi sipas standardeve. Dhoma e vizitave ishte e pajisur me një shtrat vizitash si dhe një tavolinë dhe një karrige. Dhoma shtrimi ishin tre, të pajisura me nga dy shtretër, por kishte mungesa në pajisje si një aparat për ekzaminimin e shqetësimeve në veshë, aparat oksigjeni etj. Kishte regjistrin e vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve dhe kartelave mjekësore, të cilat ishin mbajtur në rregull, ndërkohë që konstatuam se nuk ishte hapur ende një regjistër i rasteve të veçanta dhe të dhunës. Skema e rimbursimit të ilaçeve në parim ishte në funksionon dhe të paraburgosurit/dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Gjithsesi nuk funksionon skema tre palëshe për furnizimin me ilaçe, depoja e ilaçeve është në Fier.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, gërma “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe nenit 12, nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar

**Rekomanduan** : marrjen e masave konkrete lidhur me eliminimin e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë, duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës; kryerjen e hetimeve të shpejta dhe efektive, të cilat mundësojnë identifikimin dhe marrjen e masave disiplinore

ndaj personave përgjegjës për keqtrajtim ndaj të burgosurve; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e sektorit të shëndetësisë me një regjistër të rasteve të veçanta dhe të dhunës; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen dhe vënien në funksionim të dhomës së stomatologut; marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me orenditë përkatëse të sallës së TV dhe palestrës së I.E.V.P-së; marrjen e masave për pajisjen e bibliotekës së IEVP-së me libra; marrjen e masave për vënien në funksionim të lavanderisë dhe shërbimit të saj ndaj të dënuarve/paraburgosurve të institucionit; marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e medikamenteve për të paraburgosurit në një kohë sa më të shkurtër, duke e bërë më të funksionueshme marrëveshjen trepalëshe për rimbursimin e medikamenteve; marrjen e masave për pajisjen e dhomave të këshillimit në godina me orenditë e nevojshme me qëllim krijimin e kushteve normale të funksionimit të tyre; pajisjen e institucionit me ambulancë si pjesë e domosdoshme jetike.

## 5.12 IEVP SHËN KOLL LEZHË

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë, më datë 07.12.2018, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe sipas procedurës të zhvillimit të inspektimit në institucionet penitenciare. Grupi i inspektimit u takua fillimisht me z. Shaban Hysa, Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, si dhe me shefat e sektorit sipas seksioneve të këtij institucioni, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Nga informacioni i grumbulluar rezultoi se, kapaciteti fizik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë ishte për akomodimin e 440 personave të paraburgosur/dënuar. Në datën e inspektimit, në mjediset e këtij institucioni, numri i personave të paraburgosur dhe të dënuarve ishte 404 persona të akomoduar në 3 godina, 2 (dy) godina me seksion paraburgimi dhe 1 (një) godinë me seksion i sigurisë së zakonshme. Nga këta, 283 persona të paraburgosur dhe 121 persona të dënuar me burgim. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë, ishte i klasifikuar si “burg i sigurisë të zakonshme” dhe “institucion paraburgimi”.

Me urdhrin nr.8927/1 datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, ky Institucion klasifikohet “burg i sigurisë të zakonshme”, me një seksion siguri e zakonshme, një seksion paraburgimi dhe një seksion i veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “mjekim të detyruar”. Në lidhje me trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “mjekim të detyruar”, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat jetojnë personat që vuajnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Zaharisë, Krujë, Avokati i Popullit ka disa vite që ka rekomanduar mbylljen e menjëhershme të kësaj qendre dhe zhvendosjen e këtyre shtetasve, në ambiente me kushte dhe standarde ligjore të përshtatshme në mënyrë të veçantë për trajtimin mjekësor të tyre. Gjatë inspektimit u konstatua se dy nga godinat me nr.4 dhe nr.5 në këtë Institucion ishin duke u rikonstruktuar dhe përshtatur për akomodimin dhe trajtimin mjekësor të këtyre personave, në zbatim të projektit të financuar nga qeveria shqiptare dhe donatorë të huaj.

Nisur nga rëndësia që ka zbatimi i këtij projekti, si dhe për të parë ecurinë e punimeve në këto godina, grupi i inspektimit zhvilloi në datë 10.01.2019 një vizitë tjetër inspektuese në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll. Nga verifikimi në vend i punimeve rezultoi se, kishte përfunduar faza e rikonstruksionit të jashtëm dhe të brendshëm të godinave, hidroizolimi i plotë i tarracës, instalimet hidraulike, instalimi tubacioneve për shkarkimin e ujërave, instalimet elektrike, si

dhe shtrimi me pllaka i dhomave. Sipas informacionit të drejtorit të institucionit, afati për përfundimin e punimeve në këto godina dhe marrja në dorëzim e objekteve, duhet të përfundojnë deri në fundin e muajit Mars 2019. Nga inspektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm, u konstatua se gjendja teknike e godinave nr.1, 2 dhe 3 ishte shumë e amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstrukcionin e tyre. Muret e godinave në pjesën e jashtme të tyre kishin filluar të çaheshin dhe ju kishte rënë suvaja. Nga intervistat me të paraburgosurit/dënuarit u evidentua një problem tepër shqetësues që kishte të bënte me lagështirën në ambientet e jashtme e të brendshme të godinave nr.1, 2 dhe 3. Lagështira ishte e dukshme në dhomat e të paraburgosurve/dënuarve, por më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve dhe të dusheve. Në vlerësimin e grupit të inspektimit, lagështira ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë dëmton rëndë jetën dhe shëndetin e personave që qëndrojnë për kohë të gjatë në këto ambiente. Të paraburgosurit dhe të dënuarit, ngritën ankesa për mungesën e kushteve të jetesës në ambientet e vuajtjes së dënimit. Në dhoma kishte mungesa të pajisjeve dhe orendive të nevojshme, si dollapë për vendosjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale, për mbajtjen e ushqimeve, etj. Në disa nga dhomat në godinën nr.2 nuk kishte furnizim me ujë të rrjedhshëm për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës vetjake. Gjithashtu, ankesa u ngritën edhe për mungesën e sistemit të ngrohjes. Në periudhën e dimrit, ngrohja në dhoma realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë të paraburgosurit/dënuarit dhe familjarët e tyre. Në intervistat me të dënuarit në këtë institucion, u ngrit si shqetësim mungesa e kushteve higjieno-sanitare kryesisht në ambientet e përbashkëta të tualeteve dhe dusheve. Gjatë inspektimit në këto ambiente, grupi inspektues konstatoi se, këto ambiente nuk ishin të pastra dhe të lyera, kokat e dusheve ishin të dëmtuara dhe nëpër mure vareshin kabllo elektrik që përbënin rrezik për jetën e këtyre personave. Në ambientin e tualeteve dhe të dusheve, si dhe në koridoret e seksioneve u konstatuan xhama të thyer të dritareve. Në intervistat me disa nga personat e dënuar, u ngritën ankesa që kishin të bënin me shërbimin shëndetësor, lidhur me vonesat e vizitave nga stafi mjekësor i këtij institucioni, për cilësinë jo të mirë të ushqimit, për shkeljen e të drejtës për trajtimin me leje shpërblyese, si dhe për refuzimin pa shkaqe të kërkesave të të dënuarve për transferime dhe vuajtje dënimi në një institucion pranë vendbanimit të familjarëve. Në godinën nr.2, disa të paraburgosur/dënuar ngritën pretendime në lidhje me mungesën e komunikimit me familjet e tyre, pasi aparatet e telefonit që ndodheshin në regjim kishin disa ditë që nuk punonin, për shkak të një defekti teknik. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, ishin të punësuar 25 të dënuar kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi. Ashtu sikurse dhe në institucionet e tjera penitenciare, personat e dënuar të punësuar ngritën ankesa në lidhje me përfitimin e shpërblimit për punën e kryer. Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve rregullohet në bazë të kërkesave të neneve 34, 35 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, por pa shpërblim. Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave rezultoi se çdo formular regjistrohej në regjistrin përkatës dhe më tej protokollohej<sup>29</sup>. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit/ dënuarit plotësonin formularin e kërkesë/ankesës dhe e hidhnin në kutinë postare ose ia dorëzonin punonjësit të sektorit psiko-social. Grupi i inspektimit mori informacion për rregullat e pritjes të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institucion, si dhe mënyrën si funksiononte Komisioni i Pritjes. Nga verifikimi i dokumentacionit, ky komision mbledhej rregullisht dhe kishte në përbërjen e tij përfaqësues nga sektori ligjor, sektori i ruajtjes dhe sigurisë, sektori i kujdesit social dhe sektori i shëndetësisë. Të dhënat regjistroheshin në formularin e përkatës dhe më tej pasqyroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjeku bënte pjesë në Komisionin e Pritjes, ndërsa në Komisionin Disiplinor ishte prezent në rolin e vëzhguesit.

---

<sup>29</sup> Neni 49 i ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.



Komunikimi me familjarët kryhej përmes takimeve periodike dhe me telefona të vendosur në mjediset e regjimit të brendshëm dhe në ambientin e ajrimit. Të dënuarit/paraburgosurit që ndodheshin në katin e parë të godinës nr.2, u ankuan lidhur me mosfunksionimin prej disa ditësh të aparateve telefonik që ndodhen në ambientin e regjimit të brendshëm, si rezultat i një defekti teknik. Ndërkohë, nga ana e të paraburgosurve/dënuarve nuk pati ankesa për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet e tyre, por ata ngritën shqetësime për mënyrën e kryerjes së kontrollit të ushqimeve nga stafi i institucionit. Në ambientin e kontrollit, mungonte një pajisje “Skaner” për të kontrolluar ushqimet që iu dërgoheshin këtyre personave nga familjarët e tyre. Në këto kushte, punonjësit e policisë të shërbimit në këtë ambient, detyroheshin të kryenin kontroll fizik të imtësishëm të pakove me ushqime. Sa i përket çështjes së sigurisë, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, ishin të instaluara kamera në ambientet e regjimit të jashtëm dhe të brendshëm të Institucionit. Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në institucion kishte kamera që monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruhen në server për një periudhë një mujore. Nga inspektimi në ambientet e regjimit të brendshëm, grupi inspektues konstatoi se, kishte mungesë të kushteve higjieno-sanitare. Në dhoma akomodoheshin nga 2, 4 dhe 6 të paraburgosur/dënuar, por respektohej standardi në lidhje me hapësirën jetike për person. Mbipopullimi ishte reduktuar në godinat e regjimit të brendshëm, për shkak të hapjes të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Reç, Shkodër dhe transferimit të paraburgosurve/dënuarve nga ky Institucion në muajin Tetor 2018. Dhomat kishin dritë natyrale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Lidhur me pajisjet për akomodimin e të paraburgosurve/dënuarve u konstatua se dyshekët ishin të vjetruar dhe në pjesën më të madhe jastëkët dhe çarçafët siguroheshin nga familjarët e tyre. Batanijet e siguruara nga institucioni ishin tejet të vjetërsuara dhe në kushte jo të përshtatshme higjienike. Grupi i inspektimit konstatoi se të paraburgosurit/dënuarit ishin furnizuar me detergjente sipas normativave për larjen e enëve dhe për mbajtjen e higjienës vetjake. Por sipas rastit, pjesa më e madhe e të dënuarve, siguronin detergjentet dhe pajisjet e nevojshme për ushqimin nga familjarët e tyre. Gjendja e tualeteve dhe dusheve në përgjithësi në të tre godinat ishte tejet e amortizuar. Kushte higjieno-sanitare ishin të këqija për arsye të nivelit të theksuar të lagështirës. Instalimet elektrike në këto ambiente nuk ishin sipas kushteve dhe standardeve të sigurisë, pasi ato ishin të ekspozuara në muret e brendshme dhe paraqisnin rrezikshmëri të lartë për jetën e këtyre personave. Automatët e bojlerëve, si rrjedhojë e amortizimit dhe mungesës së mirëmbajtjes, përbënin rrezik permanent për çdo person që afrohej për shkak të ekspozimit të telave që përcjellin energjinë elektrike. Automati dhe pajisjet elektrike ishin krejtësisht jashtë dhe të ekspozuara në muret e këtyre ambienteve. Dritaret e dusheve ishin me xhama të thyer. Në vendet e tualeteve dhe të dusheve, për shkak të lagështirës së theksuar (tavane që pikojnë), ambienti mbante erë të rëndë. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm përgjithësisht ishte i siguar 4 orë në ditë, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të kryer normalisht nevojat e tyre dhe kujdesur për higjienën vetjake. Por, grupi inspektues konstatoi se, në disa dhoma të godinës nr.2 dhe 3, për arsye të defektit në sistemin brendshëm të shpërndarjes së ujit, kishin një periudhë të gjatë pa u furnizuar me ujë të rrjedhshëm. Vonesa në riparimin e shpejtë të këtij defekti, kishte krijuar vështirësi serioze në plotësimin e kushteve higjienike për të dënuarit që qëndronin në këtë sektor. Godinat e institucionit nuk kishin sistem qendror ngrohjeje. Në periudhën e dimrit, ngrohja nëpër dhoma realizohej me pajisje të siguruara nga vetë të paraburgosurit/dënuarit apo nga familjarët e tyre. Kjo situatë, ishte një zgjidhje për sa i takon ngrohjes të dënuarve, por krijonte probleme me sigurinë dhe jetën e këtyre personave, pasi kabllo elektrik ishin jashtë të varur në mure dhe të ekspozuar në dyshtemenë e dhomave. Grupi i inspektimit, konstatoi se kuzhina ishte e lyster, e pastër dhe me kushte të mira higjieno-sanitare. Ajo furnizohej rregullisht me ujë që përdorej për gatim dhe larjen e enëve. Personeli që punonte në kuzhinë ishte i plotësuar sipas organikës dhe ishte i pajisur me libereza shëndetësore. Gjithashtu, kampionet e ushqimit ishin të etiketuara dhe mbaheshin me çelës në ruajtje në frigorifer, për çdo vakt ushqimi. Për

personat diabetikë ishte hartuar një menu e veçantë. Përgjithësisht, nga intervistat e kryera me këtë kategori personash u konstatua se, ose gatuanin vetë ose e merrnin ushqimin nga familjet e tyre. Organika e sektorit psiko-social për çështjet shoqërore, përbëhej nga 10 (dhjetë) punonjës, por në kohën e inspektimit ishin vetëm 7 (shatë) punonjës të punësuar me arsimim “punë sociale” dhe “psikolog”. Nga verifikimi i dokumentacionit të stafit psiko-social si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, plotësimi i dosjeve psiko-sociale, si edhe programet individuale dhe të punës në grup të trajtimit, ishin të plotësuara dhe të përditësuara me aktivitete, takime me të dënuarit, si dhe me vlerësimet për çdo tremujor. Nga inspektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm, grupi i inspektimit konstatoi se, mungonin mjediset e veçanta për zhvillimin e aktiviteteve aftësuese dhe mjetet e nevojshme për ushtrimin e detyrës nga ana e stafit psiko-social.

Aktivitetet zhvilloheshin sipas një plani të miratuar dhe një grafiku të paracaktuar, ku përfshiheshin kryesisht lojëra sportive dhe lojëra tavoline. Në këtë institucion mungonin kurset e formimit profesional. Megjithatë, sektori psiko-social organizonte aktivitete me tematika të veçanta, ku përfshiheshin një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve, sikurse aplikoheshin edhe programe individuale për trajtimin e tyre. Në çdo sektor kishte ambiente për zhvillimin e aktiviteteve aftësuese të përbashkëta, por ato ishin me hapësira shumë të vogla. Për zhvillimin e aktiviteteve sportive përdorej vendi i ajrimit. Ndërsa, brenda në ambientet e godinave kishte nga një palestër që shfrytëzohej nga të dënuarit sipas orarit të miratuar nga administrata e institucionit. Në godinën e parburgimit kishte një klasë të pajisur me kompjutera, e cila përdorej për kurset e kompjuterit.

Në këtë Institucion, ndodheshin dy ambiente që shërbenin si biblioteka, por dhe këto ishin me hapësira të vogla dhe kishin një numër të varfër tituj librash, të cilët ishin ofruar nga organizata jofitimprurëse. Njëkohësisht në këto mjedise, kryheshin seanca këshillimore të stafit psiko-social me të dënuarit. Sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit ka një rëndësi të veçantë për sa i takon rehabilitimit dhe ri-integrimit të personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të parburgosurve dhe të dënuarve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i parburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut. Në këto kushte, në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Shënkoll, ishte e domosdoshme krijimi i ambienteve të veçanta me hapësirë dhe të plotësuara me mjetet e nevojshme për çdo sektorë në funksion të punës të stafit psiko – social për trajtimin individual, si dhe për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore, çlodhëse e sportive me të parburgosurit/dënuarit. Këto aktivitete, duhet të shërbejnë për motivimin dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxitjen e interesit për arsimim dhe formimin profesional të parburgosurve dhe të dënuarve. Në godinën nr.2 të parburgimit kishte 2 dhoma kulti, përkatësisht për besimin e krishterë dhe për atë mysliman. Shërbesat kryheshin çdo të premte dhe të hënë nga personeli i besimeve respektive sipas një marrëveshje ndërmjet institucionit me komunitetet fetare lokale. Mjediset ku kryheshin këto rite fetare ishin të mirëmbajtura dhe të pastra. Organika e sektorit shëndetësor ishte e plotësuara dhe përbëhej nga 9 (nëntë) punonjës prej të cilëve dy mjekë, një stomatolog, një farmacist dhe pesë infermierë. Është për t'u vlerësuar fakti që nga ana e institucionit dhe stafit mjekësor, ishin bërë përpjekje për të mbuluar problematikën e furnizimit me ilaçe, si për rastet urgjente, ashtu edhe për mjekimin e të sëmurëve kronikë. Furnizimi me ilaçe bëhej nga skema e rimbursimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe me ilaçe të siguruar nga fondi i veçantë në dispozicion të Institucionit. Nga ana e sektorit shëndetësor trajtoheshin me medikamentin “metadon” disa të sëmurë kronikë, të sëmurë mendorë dhe të dënuar që kishin abuzuar me substancat narkotike. Dhoma e mjekut, ku zhvilloheshin vizitat, ishte zhvendosur për në ambientin e ish-godinës së të miturve, ku ishte krijuar më vete një Sektor i Kujdesit të Veçantë (SKV). Ajo ishte e plotësuara me orenditë e domosdoshme

për kryerjen e një shërbimi shëndetësor në kushte normale. Dhomat brenda ishin të plotësuara me krevatet dhe shtroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë, të cilat funksiononin mirë. Megjithatë, mungonin materialet dhe instrumentet dentare dhe për pasojë nuk bëheshin mbushje të dhëmbëve nga dentisti i institucionit. Në rastet e problemeve serioze dentare, personat e paraburgosur/dënuar shoqëroheshin për mjekime në klinika private të stomatologëve në qytetin e Lezhës. Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, regjistri themeltar të të sëmurëve kronikë dhe regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ishin plotësuar sipas rubrikave. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës. Në disa raste, për shkak të dinamikës së transferimeve nga një institucion penitenciar në tjetrin, kishte vonesë në plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me libreza shëndetësore. Mekanizmi Kombëtar ka rekomanduar: Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e plotë të godinave nr.1, 2 dhe 3 për shkak se gjendja e tyre ishte tejet e amortizuar dhe jashtë kushteve teknike; marrjen e masave të menjëhershme për hidroizolim të tarracës, riparimin e sistemit hidraulik dhe shkarkimit të ujërave, të cilat përbëjnë shkak për nivelin e lartë të lagështirës në dhomat e të paraburgosurve/dënuarve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve; marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e kokave të dusheve, si dhe izolimin e instalimeve elektrike në ambientet e përbashkëta të tualeteve dhe të dusheve, pasi ato përbëjnë rrezik për jetën e të paraburgosurve dhe të dënuarve. Marrjen e masave për instalimin në godinat e të paraburgosurve dhe të dënuarve të sistemit të ngrohjes qendrore, si dhe ndërprerjen e lidhjeve të kabllave elektrik të ekspozuar në muret dhe dyshemetë e dhomave të të dënuarve. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e defektit në rrjetin e brendshëm të furnizimit me ujë të rrjedhshëm në godinën nr.2/kati 3, si një shërbim jetik për personat që jetojnë në këto dhoma; Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me riparimin e dritareve dhe zëvendësimin e xhamave të thyer në ambientet e korridoreve të brendshme dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve; Marrjen e masave për krijimin e kushteve të plota higjieno-sanitare dhe pajisjen me orenditë e domosdoshme të ambientit për prindërimin në distancë dhe mjedisit të takimit me familjarët; Marrjen e masave për kompletimin e dhomës së stomatologut me instrumente dhe materiale dentare të domosdoshme për të kryer efektivisht një shërbim të tillë. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e 3 vendeve vakante të sektorit psiko-social sipas organikës; Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të përshtatshme të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim, si dhe të ambienteve me hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve aftësuese, të plotësuara me mjetet dhe orenditë e nevojshme; Marrjen e masave për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të paraburgosurve/dënuarve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Marrjen e masave të menjëhershme që çdo të paraburgosuri dhe të dënuari t’u sigurohen shtresa dhe batanije të reja për fjetje, në përputhje me kushtet klimaterike dhe normat e miratuara në rregulloren e brendshme të IEVP-së. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë të ushqimit për të paraburgosurit/dënuarit, sipas llojshmërisë dhe normës të ushqimit, në përputhje me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë.

## **6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018 në Drejtorinë e Policisë së Vendore dhe në Komisaritet e varësisë e DPV- ve**

### **6.1 KOMISARIATI I POLICISË KRUIJË**

Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 10.05.2018 në Komisaritetin e Policisë Krujë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisaritetin e Policisë Krujë ambienti i shoqërimit nuk ishte ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>30</sup> Në këtë komisaritet kishte vetëm dhoma shoqërimit, një për meshkujt madhorë dhe tjetra e përbashkët për femrat dhe të miturit. Dhomat kishin nga një dritare, e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, por ato ishin të amortizuara. Dhomat e shoqërimit nuk ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej nga punonjësit e policisë të këtij komisariteti.

Në korridorin dhe në dhomat e ambientit të shoqërimit nuk ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit. Gjithashtu në dhomat e shoqërimit nuk kishte sende apo mjete të tilla që shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në Komisaritetin e Policisë Krujë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisaritetit të Policisë Durrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaritetin e Policisë Krujë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar nga punonjësit e policisë, por si mangësi u konstatua se në rubrikën “shkaqet, arsyet e shoqërimit” nuk pasqyroheshin në mënyrë korrekte dhe me saktësi shkaqet apo baza ligjore e shoqërimit të shtetasve, duke e lënë evazive dhe shkurt, si p.sh. “për verifikim”, “informacion”, etj.

Në këtë komisaritet ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e privimit të tyre nga liria nga organet e policisë.

---

<sup>30</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë, Sipas punonjësve të policisë nuk ka pasur ankesa apo kërkesa që të evidentoheshin në regjistrin e mësipërm.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të arrestuar/ndaluar.

### **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:**

Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Krujë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të dhomës së tretë të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Krujë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Procedurës Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe dinjitoz për të shoqëruarit. Marrjen e masave të nevojshme për kompletimin e dhomave të shoqërimit me orënditë e nevojshme për qëndrim, duke zëvendësuar ato ekzistuese të cilat ishin të amortizuara, si dhe ndërtimin e tualeteve për personat e shoqëruar brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësorë të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit, si dhe në dhomat e shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin me saktësi dhe përgjegjësi të “Regjistrin të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” në rubrikën “shkaqet, arsyet e shoqërimit”, duke e saktësuar dhe orën për çdo rast shoqërimi.

## **6.2 KOMISARIATI I POLICISË BULQIZË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 27.09.2018 në Komisarati i Policisë Bulqizë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisariatin e Policisë Bulqizë nuk kishte ambiente shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt**

madhorë dhe të miturit.<sup>31</sup> Në këtë Komisarariat sërisht kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarariatit brenda territorit të këtij organi. Dhoma ishte me përmasa 4 x 4m, kishte një derë druri të veshur me llamarinë, mbyllja e të cilët bëhej me shul dhe dry, një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër dhe e lyer rishtazi dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar madhorë meshkuj. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje. Në rastet kur në Komisarariat shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit. Në këtë Komisarariat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Në Komisariatin e Policisë Bulqizë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Bulqizë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Aktit për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në këtë Komisarariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues

---

<sup>31</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.<sup>32</sup>

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet të përmbusheshin në mënyrë të menjëhershme këto rekomandime paraprake:**

Marrjen e masave të nevojshme për përshpejtimin e punimeve për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarlatin e Bulqizës sipas kërkesave të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në korridoret e tyre si dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

## **6.3 KOMISARIATI I POLICISË MAT**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 06.09.2018 në Komisarlatin e Policisë Mat, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarlatin e Policisë Mat nuk ishte marrë asnjë masë për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Konkretisht nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme këto problematika:**

Në Komisarlatin e Policisë Mat, ambientet e shoqërimit nuk janë të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>33</sup>

Në këtë Komisarlat kishte një dhomë shoqërimi e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarlatit brenda territorit të këtij organi. Dhoma ishte me përmasa 5 x 5m, me dyer druri, ndërsa dritarja ishte e madhe dhe lejonte ajrim dhe ndriçim natyral. Ndërkohë ndriçimi sigurohej edhe nga rrjeti elektrik. Dhoma që përdorej për shoqërimin e shtetasve ishte e palyer dhe jo e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar meshkujt madhorë. Për intervistimin e femrave dhe të miturve të shoqëruar përdorehin dhomat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të cilat ndodheshin në katin e dytë të godinës. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje.

---

<sup>32</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

<sup>33</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

Në këtë Komisarariat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Në Komisariatin e Policisë Mat ambienti i sigurisë nuk ishte ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Në këtë Komisarariat kishte 12 dhoma sigurie nga të cilat përdorshin vetëm 6 prej tyre për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë. Ato nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të ndaluar/arrestuar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë, dhe e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>34</sup> Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ato ishin të pajisura me dyshekë e batanije të cilët ishin të vjetër, nuk kishin jastëk dhe krevate. Personat e ndaluar/arrestuar flinin në dyshekë, që vendoseshin mbi dyshemenë prej dërrase, sepse nuk kishte krevate. Ambienti i sigurisë kishte shumë lagështirë dhe ishte i amortizuar në tërësi. Qëndrimi i shtetasve të arrestuar/ndaluar në këto kushte përbën trajtim degradues.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në tualetet që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Manualit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Kjo dhomë nuk përmbushte standardet, pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Në Komisariatin e Policisë Mat “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Aktin e procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

---

<sup>34</sup> Kreu V, pika 3.3 e Manualit “Për Rregullat e Trajtitimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.



Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarariat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Grupi i monitorimit u informua nga punonjësit e policisë se personat e arrestuar/ndaluar, trajtohen në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Shtetasit e intervistuar vihen në dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin marrin kontakt dhe kryejnë veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë shoqërimit dhe arrestimit punonjësit e policisë identifikohen përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e personelit mjekësor të I EVP Burrel brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në aktin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin e Personave të ndaluar/arrestuar”.<sup>35</sup> Ky personel pasqyrore konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet e burgut të përmbusheshin në mënyrë të menjëhershme këto rekomandime paraprake: Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në këtë komisarariat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm

---

<sup>35</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit

të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit. Marrjen e masave për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Mat sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Aktit të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të intervistimit në këtë komisarjat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

## 6.4 KOMISARIATI I POLICISË DIBËR

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 07.09.2018 në Komisarati i Policisë Dibër sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisaratin e Policisë Dibër, ambientet e shoqërimit nuk janë të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>36</sup>**

Në këtë Komisarjat kishte një dhomë shoqërimi e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarajatit brenda territorit të këtij organi. Dhoma ishte me përmasa 6 x 5m, me dyer druri, ndërsa dritarja ishte e madhe dhe lejonte ajrim dhe ndriçim natyral. Ndërkohë ndriçimi sigurohej edhe nga rrjeti elektrik. Në korridorin e këtij ambienti kishte edhe dy dhoma të tjera të ndara me zgarë hekuri, të cilat qëndronin të hapura, por punonjësit e policisë informuan se ato nuk përdorehin për shtetasit e shoqëruar në Komisarajat. Dhoma që përdorej për shoqërimin e shtetasve ishte e palyer, por e pastër dhe e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar meshkuj madhorë. Për intervistimin e femrave dhe të miturve të shoqëruar përdorej një dhomë e cila ndodhej në katin e dytë të godinës. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje. Në korridorin e godinës, afër dhomës së shoqërimit, kishte një tualet, i cili ishte jashtë funksionit.

Në këtë Komisarajat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre në Komisaratin e Policisë Dibër ambienti i sigurisë nuk ishte ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këtë Komisarajat kishte 13 dhoma sigurie nga të cilat përdorehin vetëm 5 prej tyre për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë. Ato nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme nuk ishte jo më pak se 10 metra katrorë, dhe e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>37</sup> Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe

<sup>36</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

<sup>37</sup> Kreu V, pika 3.3 e Manualit “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

dritës natyrale. Ato ishin të pajisura me dyshekë e batanije të cilët ishin të vjetër, por nuk kishin jastëk dhe krevate. Personat e ndaluar/arrestuar flinin në dyshekë që vendoseshin mbi dyshemenë prej dërrase, sepse nuk kishte krevate.

Ambienti i sigurisë kishte shumë lagështirë dhe ishte i amortizuar në tërësi. Qëndrimi i shtetasve të arrestuar/ndaluar në këto kushte përbën trajtim degradues.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në tualetet që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Manualit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Kjo dhomë nuk përmbushte standardet, pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Në Komisarlatin e Policisë Dibër “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Aktin e procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarlat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Grupi i monitorimit u informua nga punonjësit e policisë se personat e arrestuar/ndaluar, trajtohen në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Shtetasit e intervistuar vihen në dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin marrin kontakt dhe kryejnë veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë shoqërimit dhe

arrestimit punonjësit e policisë identifikohen përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk monitorohej me kamera. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Nga monitorimi në disa prej zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore që u ndodhën në këtë komisarariat në kohën e inspektimit nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat ishte krijuar një magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e ndihmësmjekut të brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin e Personave të ndaluar/arrestuar”.<sup>38</sup> Ndihmësmjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plorë. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Dibër sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Aktit të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në këtë komisarariat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja sipas kërkesave të Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të

---

<sup>38</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit

arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e dy dhomave ekzistuese të shoqërimit në korridorin e përbashkët në këtë komisarariat dhe vulosjen e tyre. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisarariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme rikonstruksionin dhe vënien në shërbim të tualetet që ndodhet në ambientin e shoqërimit.

## **6.5 KOMISARIATI I POLICISË HAS**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 10.09.2018 në Komisaritati i Policisë Has, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se Komisaritati Has i ishte nënshtruar një rikonstruksioni total. Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaritin e Policisë Has, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.**

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Disa rubrika të regjistrin nuk plotësoheshin me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë. Konkretisht, në rubrikën “Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmeve”, në vend që të shkruhej emri, atësia dhe mbiemri i të njoftuarit, shkruhej “familja”, “babai”, “vëllai”, “xhaxhai” por paidentifikuar individualisht personi e njoftuar. Në rubrikën “Nr. telefonit të të njoftuarit” në shumicën e rasteve shkruhej “me gojë”, “prezent” dhe në pak raste shkruhej numri i telefonit. Po kështu kishte edhe raste që nuk shkruhej ora e njoftimit të tyre.<sup>39</sup> Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për përshpejtimin dhe përfundimin e punimeve në ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisaritatet e Policisë Has sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të punës ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme me qëllim plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të të gjitha rubrikave të “Regjistrin të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar” në këtë komisarariat, si dhe të dokumenteve të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore lidhur me të shoqëruarit.

Marrjen e masave administrative për personat që në mënyrë të përsëritur nuk plotësojnë me përgjegjësi dhe saktësi të gjitha rubrikat e “Regjistrin të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar” në këtë komisarariat

---

<sup>39</sup> Kreu VII, pika a.1.4.k e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

## 6.6 KOMISARIATI I POLICISË KUKËS

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 10.09.2018 në Komisarati i Policisë Kukës, sipas planit të inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se, në Komisaratin e Policisë Kukës ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:**

Në Komisaratin e Policisë Kukës, mjediset e shoqërimit janë ndërtuar të reja vitet e fundit në një godinë më vete, brenda territorit të këtij institucioni dhe përbëhen nga dy dhoma shoqërimi, një për meshkujt madhorë dhe tjetra për femrat dhe të miturit. Ato, përveç mungesës së një dhome të tretë, janë ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrim. Ato kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, ishin të lyera dhe të pastra, si dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, tavolina dhe karrige për të qëndruar ulur të shoqëruarit sipas pikës 3 të Kreut IV të “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”, të cituar më sipër. Gjithashtu në korridorin e këtij ambienti, pranë dhomave kishte një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte ujë të rrjedhshëm. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera.

Përveç sa më sipër, në ambientet e shoqërimit kishte edhe dhoma të tjera që nuk përdorehin: dhoma e paraqitjes për njohje edhe një ambient tjetër i ndarë në dy dhoma për të bërë veprime me teknikë operative, por sipas punonjësve të policisë ky ambient nuk përdorej dhe në derën e tij ishte vendosur një tabelë ku shkruhej “jo funksionale”.

Në Komisaratin e Policisë Kukës në ambientet e sigurisë kishte gjashtë dhoma sigurie me kapacitet për tetë persona. Dhomat ishin të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ato ishin të ndara më vete, një për femra, një për të mitur dhe katër për meshkuj madhorë, nga të cilat, dy me nga një krevat dhe dy me nga dy krevate. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>40</sup> Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshekë, batanije, çarçaf dhe jastëk në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor, sikurse parashikohet në pikën 9 të Kreut V të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102,

---

<sup>40</sup> Kreu V, pika 3.3 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit. Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës për të komunikuar me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme, të cilat ishin funksionale.

Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige. Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Në Komisarlatin e Policisë Kukës “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Aktin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se jo të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektësi. Shoqërimi i shtetasve në organin e policisë bëhet në bazë të nenit 111, të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se, punonjësi i Policisë bën arrestimin dhe ndalimin e personit, sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në nenin 112/2/e, të po këtij ligji parashikohet se, në rastet e arrestimit/ndalimit, policia evidenton për çdo person të dhënat për orën, datën dhe vendin e arrestimit, apo të ndalimit.

Në rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në vijimësi që prej më shumë se dhjetë vjetësh, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit është kërkuar që, edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij. Të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej nga punonjësja e punësuar nga Komisarlati në kuzhinën e IEVP Kukës. Punonjësja ishte e pajisur me librezën

shëndetësore, të vendosur në stendën ku paraqitej menyuja javore, brenda kuzhinës së IEVP-së të ndërtuar brenda të njëjtës godinë ku ndodheshin ambientet e sigurisë të këtij komisariati.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Kukës ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me të. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologjia sigurohej nga Qendra e Strehimit të Grave dhe të Miturve të Dhunuar pranë Bashkisë Kukës dhe shoqata te grave me seli në këtë qytet.

Të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Grupi i punës konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e ndihmësmjekut kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.<sup>41</sup> Ndihmësmjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjithashtu në këto ambiente kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar. Nga verifikimi tij rezultoi se ishte regjistruar vetëm një kërkesë për takim me Avokatin e Popullit gjatë vitit 2016, e cila ishte ndjekur nga punonjësit e policisë duke njoftuar nëpërmjet telefonit institucionin e Avokatit të Popullit. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e dhomës së tretë të shoqërimit për femra, si dhe të dhomës për marrjen në pyetje të të shoqëruarve dhe pajisjen e tyre me orenditë e nevojshme sipas kriterëve të parashikuara në Aktin e

---

<sup>41</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit



procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit në dhomën që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisariati dhe që shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave administrative nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës dhe Komisarati në varësi për të garantuar plotësimin në kohë, në mënyrë të saktë, korrekte dhe pa gabime të regjistrave të shoqërimit dhe/ose ndalimit të shtetasve, si dhe aplikimin e procedurave korrekte si nga ana personave shoqërues, edhe atyre pritës, në lidhje me të shoqëruarit apo të ndaluarit.

## 6.7 KOMISARIATI I POLICISË TROPOJË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 10.09.2018 në Komisarati i Policisë Tropojë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se** në Komisaratin e Policisë Tropojë nuk kishte ambiente shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe Aktin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>42</sup> Ndonëse Avokati i Popullit në vijimësi i ka rekomanduar autoriteteve përkatëse ndërtimin e ambienteve të shoqërimit konform akteve normative në fuqi, me qëllim për të krijuar kushtet për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve, ato nuk janë ndërtuar ende. Sipas punonjësve të policisë, të shoqëruarit mbaheshin nëpër zyra deri sa përfundonin procedurat e verifikimit të shkakut të shoqërimit të tyre në organin e policisë. Në katin e parë të godinës ndodhej tualeti, por nuk ishte i ndarë më vete për meshkuj dhe femra.

Në këtë Komisarati nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të hyrjes dhe korridorit të godinës.

Në Komisaratin e Policisë Tropojë nuk kishte ambiente sigurie të ndërtuara sipas kërkesave të Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017.

Grupi i inspektimit u informua nga punonjësit e policisë se, personat e arrestuar/ndaluar nga Komisarati i Policisë Tropojë dërgoheshin në I.E.V.P. Tropojë. Ky veprim bëhej në bazë të një Marrëveshjeje - Bashkëpunimi e lidhur në vitin 2015 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. 2157/1 Prot., datë 17.03.2015 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 1054/1 Prot., datë 16.03.2015. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, ky komisarati kishte në përdorim një dhomë sigurie në mjediset e regjimit të brendshëm të I.E.V.P. Tropojë. Të arrestuarit dhe të ndaluarit që dërgoheshin në këtë institucion siguroheshin nga punonjësit e Komisarati të Policisë Tropojë. Sipas informacionit të marrë nga punonjësit e policisë dhe librit të personave të arrestuar e ndaluar rezultoi se në datën e inspektimit nuk kishte persona të arrestuar/ndaluar.

Ky bashkëpunim bazuar në marrëveshjen ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duhet të rishikohet bazuar mbi parimin e ndarjeve të

---

<sup>42</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

statusit ligjor dhe kompetencave ndërmjet veprimeve policore të ndalim /arrestimit dhe termave ligjore të paraburgimit.

Grupi i punës inspektoi dhomën e sigurimit në I.E.V.P. Tropojë, e cila ishte në dispozicion të Komisarariatit të Policisë Tropojë për ruajtjen dhe trajtimin e personave që arrestoheshin apo ndaloheshin nga organi i Policisë. Në këtë institucion grupit të inspektimit iu vu në dispozicion një kopje e marrëveshjes së cituar më lartë. Edhe kjo dhomë nuk përmbushte kriteret e parashikuara në Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017.

Në Komisariatin e Policisë Tropojë personat e shoqëruar regjistroheshin në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektësi. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.<sup>43</sup> Koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve ishte pothuajse e njëjtë me kohën e shoqërimit të tyre, duke lëvizur me minuta, por brenda një ore.

Të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisaritati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Tropojë nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej në kuzhinën e I.E.V.P. Tropojë.

Sipas punonjësve të policisë, ndonëse në ambientin e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomës së sigurisë.

Gjithashtu sipas punonjësve të policisë, të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e Komisarariatit të Policisë Tropojë ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të.

---

<sup>43</sup> Kreu VII, pika a.1.4 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht. Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga shkollat e mesme të qytetit.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit përkatës rezultoi se të arrestuarve/ndaluarve u bëhej vizita mjekësore brenda afatit 12 orë nga personeli mjekësor i I.E.V.P. Tropojë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë të këtij komisariati. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin në këtë Komisarjat të ambientit të shoqërimit dhe pajisjen e tij me orenditë e nevojshme sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 3 të Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të sigurisë në këtë Komisarjat sipas Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të punës ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

## **6.8 KOMISARIATI I POLICISË VLORË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 16.09.2018 në Komisarjati i Policisë Vlorë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarjatin e Policisë Vlorë ishte vetëm 1 (një) dhomë shoqërimi e ndarë me dy ambiente. Kjo dhomë shërbente vetëm për shoqërimin e personave të rritur. Në rastet kur shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë deri në përfundim të verifikimit të rastit apo kryerjes së veprimeve procedurale për të cilat ishin shoqëruar në organin e policisë.**

Dhoma ishte e lyster, e pastër, si dhe e pajisur me tavolinë dhe karrige të palëvizshme të fiksuara në dysheme. Ajo kishte një dritare e cila mundësonte ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Në këtë ambient, mungonte tualeti i veçantë për personat e shoqëruar dhe si i tillë shërbente tualeti që përdorej nga personeli i këtij komisariati. Në dhomë dallohej lagështia në mure dhe ndihej erë myku.

Gjithashtu, në ambientin e shoqërimit mungonte sistemi i monitorimit me kamera, i cili shërben për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të dhomave të shoqërimit.

Grupi i inspektimit konstatoi se, mungonin dhomat e shoqërimit të ndara më vete për femra dhe të mitur, si dhe dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë gjyqësore.

Në Komisarlatin e Policisë Vlorë ambienti i sigurisë nuk ishte konform normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017.

Në këtë ambient, ndodheshin 4 dhoma sigurie, 2(dy) për persona të rritur, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti i dhomave ishte për 7 persona, por sipërfaqja dhe hapësira e dhomave nuk ishte e mjaftueshme për të përballuar këtë kapacitet.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të vogla dhe nuk lejonin ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Të katërta dhomat ishin të lyera, të pastra, të pajisura me orënditë e nevojshme si krevate, dyshekë, jastëk dhe batanije. Në ambientin e sigurisë kishte tre tualete nga të cilat dy ishin brenda dhomave dhe një në korridor. Në tualete mungonte dushi me ujë të ngrohtë. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes në dhoma mungonte. Në dhomat e sigurisë mungonte dhe ambienti i veçantë për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve.

Në ambientin e sigurisë kishte një dhomë, e cila përdorej nga mjeku për kryerjen e vizitave mjekësore dhe e pajisur me orënditë e nevojshme si shtrat, tavolinë, karrige, rafte dhe pajisje për ngrohje. Njëkohësisht, sipas informacionit të punonjësit të policisë të shërbimit në ambientin e sigurisë, kjo dhomë përdorej edhe nga prokurorët për marrjen në pyetje të ndaluarve/arrestuarve, si dhe për takime me avokatët.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte instaluar një telefon fiks, i cili shërbente në rastet emergjente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient. Në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile/sinjali në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevoje.

Në ambientin e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Vlorë, mbetet si problem mungesa e instalimit të sistemit audio-vizive, për vëzhgimin e korridorit dhe të dhomës që përdoret për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar.

Ambienti i sigurisë kishte gjeneratorë më vete, si burim rezervë të energjisë në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarlatin e Policisë Vlorë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte sipas tipit “Model nr.1” të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrave të informacionit. Nga këqyrja e këtij

dokumenti rezultoi se, regjistri ishte plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisariati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariatit të policisë, konstatoam se, punonjësi i policisë shënonte në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur personi shoqërohet për në organin e policisë, pra në orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës. Sa më sipër, evidentuam zbatimin e rekomandimit të Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Vlorë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ishin 2 persona, nga të cilët 1 (një) i arrestuar dhe 1 (një) i ndaluar, në dhoma më vete.

Nga inspektimi u konstata se, sipërfaqja dhe kubatura e dhomave të sigurisë<sup>44</sup> nuk ishin të mjaftueshme për të përballuar kapacitetin për 7 (shtatë) persona. Nga informacioni i punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë, u konstata se në rast mbipopullimi në të dy dhomat e planifikuara për personat e rriturit, personi tjetër detyrohej të flinte në dyshekë të vendosur mbi dysheme, pasi nuk kishte shtretër. Dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë të këtij komisariati, por dhe nga organet e policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Grupi i monitorimit intervistoi personat e ndaluar/arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuan frikë apo ekspozim për të raportuar nëse kishin keqtrajtim.

Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Koha e qëndrimit të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor. Nga intervistimi i punonjësve të informacionit, rezultoi se, gjatë këtij viti nuk kishte raste të vonesave për transferimin e personave të arrestuar/ndaluar në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për shkak të ekzekutimit të vendimeve të dënimit të tyre penal.

Gjithashtu, nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe pyetja e personave të ndaluar/arrestuar rezultoi se, të arrestuarit/të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

---

<sup>44</sup> Kreu VIII, pika 3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e policisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, si dhe nga verifikimi në vend i ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë, rezultoj se pranë tyre nuk kishte asnjë zyrë intervistimi për marrjen në pyetje të shtetasve nga punonjësit e policies, e cila të ishte e monitoruar me kamera. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të ndaloheshin apo të arrestoheshin, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit.

Referuar standardeve ndërkombëtare<sup>45</sup>, Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Nga inspektimi që u bë në disa prej zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore që u ndodhën prezent në kohën e inspektimit, nuk u gjetën pajisje prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Në përfundim të vizitës, grupi i inspektimit administroi praktikat shkresore në lidhje me nevojat dhe kërkesat e Komisarimit të Policisë Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm. Në informacionin e Komisarimit të Policisë Vlorë<sup>46</sup> rezultoi të ishin parashikuar masa për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe në vijim ishte ngritur grupi i punës<sup>47</sup> për studimin, vlerësimin dhe hartimin e detyrave të projektimit për rikonstruksionin e godinave në administrimin e saj, në veçanti për ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit dhe të sigurisë, në përputhje me procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Nga informacioni i Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe drejtuesit të Komisarimit të Policisë Vlorë, konstatoam se projekti është dërguar në Drejtorinë Ekonomike pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë dhe fondet për këto investime, janë përfshirë në projektet prioritare që do të miratohen në buxhetin e vitit 2019.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarimit të Policisë Vlorë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar, të cilat është e nevojshme të rinovohen me postera të rinj.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht të caktuar nga prokurori sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të

---

<sup>45</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

<sup>46</sup> Shkresë nr.351/2, datë 27.02.2018 drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe Departamentit të Sigurisë Publike pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë

<sup>47</sup> Urdhër nr.544 prot., datë 06.03.2018 i Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, ose të zgjedhur nga familjarët e tyre, si dhe të psikologut.

Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga pyetja e 2 (dy) të arrestuarve/ndaluarve, të cilët deklaruan se ishin njohur me të drejtat ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje dhe ishin takuar me avokatët e tyre.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe formularit me të drejtat e tyre. Po ashtu, punonjësit e policisë në zyrën e informacionit, dispononin formularët me të drejtat e personave që ju privohet liria në këto ambiente të përkthyer në 7 gjuhë të huaja.

Të arrestuarve/ndaluarve u ishte bërë vizita mjekësore brenda afatit 12 orë nga mjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë,<sup>48</sup> i cili ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë së këtij komisariati.

Në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të këtij komisariati ishte i afishuar numri i kontaktit falas me zyrën e Avokatit të Popullit.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime:

Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të dhomës më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në mjediset e komisariatit.

Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e pajisjeve të sigurisë (sisteme me kamera audio-vizive) për monitorimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe veprimet e punonjësve të policisë me personat që ndodhen në mjediset e policisë.

Marrjen e masave të nevojshme për rinovimin e materialeve informuese (postera) për njohjen e personave të shoqëruar dhe personave të arrestuar/ të ndaluar në mjediset e policisë, me të drejtat e këtyre personave. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin në dhomat e sigurisë të butonit me zile/sinjali në mur, për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin në ambientin e dhomave të sigurisë të një ambienti të posaçëm, që të shërbejnë për larjen e trupit të arrestuarve/ndaluarve dhe sigurimin e ujit të ngrohtë. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e ngrohjes në ambientin e dhomave të sigurisë me sistem ngrohje qendrore.

---

<sup>48</sup> Kreu V, pika 7/2 e procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1102, dt. 07.11. 2017.

## 6.9 KOMISARIATI I POLICISË NR.1 TIRANË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 20.09.2018 në Komisarati i Policisë Nr.1 Tiranë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se vazhdonin të ishin prezente problematikat mbi ndërtimin e ambientit të shoqërimit, sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ndërtimin e ambientit të sigurisë, sipas procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1102, datë 07.11. 2017, krijimin e dhomës më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë, e cila të ishte e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive, krijimin e dhomës të mjekut dhe plotësimin me materialet e nevojshme për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e sigurisë, si dhe regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar dhe personave të arrestuar/ndaluar në mjediset e policisë, nuk ishin të plotësuar me përgjegjësi dhe saktësi sipas rubrikave, kryesisht për saktësimin e orës se kur personave të shoqëruar ishte privuar liria. Në Komisaratin e Policisë Nr.1, Tiranë ambienti i shoqërimit nuk ishte ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.**

Në ambientin e shoqërimit kishte 1(një) dhomë e cila shërbente vetëm për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave të rritur. Personat e shoqëruar femra dhe të mitur, mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë deri në përfundim të verifikimit të rastit apo kryerjes së veprimeve procedurale për të cilat ishin shoqëruar në organin e policisë.

Grupi inspektues, konstatoi se dhoma e shoqërimit ndodhej brenda godinës të komisarariatit dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si tavolinë dhe karrige të palëvizshme të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Ajo kishte një dritare të vetme e cila mundësonte ajrim dhe ndriçim natyral, por zgara e hekurit e vendosur në dritare ishte jo estetike dhe pothuajse e panevojshme, pasi pengonte ajrimin dhe ndriçimin e plotë të saj. Dhoma ishte pajisur me ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Në këtë ambient ndodhej një tualet, ngjitur me dhomën e shoqërimit, i cili nuk ishte i ndarë për femra dhe meshkuj. Dhoma e shoqërimit, nuk ishte e pastër nga ana higjienike dhe ishte e palyer.

Nga kryerja e inspektimit, rezultoi gjithashtu se në ambientin e shoqërimit mungonin kushtet bazë të përcaktuara në aktet normative si dhoma e shoqërimit më vete për femrat dhe të miturit, dhoma më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e të shoqëruarve nga punonjësit e policisë, si dhe mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambienteve të shoqërimit.

Dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë Nr.1, Tiranë, nuk ishin të ndërtuara sipas kërkesave të procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017. Grupi i inspektimit konstatoi se, gjendja e dhomave në ambientin e sigurisë të komisarariatit në lidhje me plotësimin e kushteve, kritereve dhe kapaciteteve fizike sipas standardeve ligjore, nuk kishte ndryshuar nga inspektimi i mëparshëm.



Në ambientin e sigurisë kishte 3 dhoma sigurie dhe sipas informacionit të përgjegjës të dhomave të sigurisë, këto dhoma ishin me destinacion vetëm për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të rritur. Kapaciteti fizik i dhomave ishte për akomodimin e 5(pesë) personave. Personat e arrestuar/ndaluar femra dhe të mituri, pasi ju plotësohej dokumentacioni i nevojshëm nga punonjësit e policisë, dërgoheshin në dhomat e veçanta të sigurisë që ndodhet në ambientin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Dritaret e dhomave të sigurisë ishin me përmasa të vogla dhe nuk lejonin ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, ato ishin të pajisura me materiale si krevate, dyshekë dhe batanije, por u konstatua se ato ishin shumë të vjetërsuar. Dhomat ishin të pastra nga ana higjienike por ishin të palyera. Në ambientin e sigurisë kishte një tualet ngjitur me dhomat e sigurisë me ujë të rrjedhshëm, por mungonte uji i ngrohtë në dushe.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte instaluar një telefon fiks i cili shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që kryenin shërbenin në këtë ambient në rastet emergjente. Por, në dhomat e sigurisë mungonte butoni zile/sinjali i montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte instaluar sistemi i monitorimit audio-vizive me kamera, për vëzhgimin e veprimeve të punonjësve të policisë të shërbimit në dhomat e sigurisë.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë nuk kishte ambient më vete për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe mungonte ambienti që shërben si objekt kulti. Por, sipas intervistave me personat e arrestuar/ndaluar, rezultoi se atyre iu lejohej kryerja e riteve fetare brenda ambientit të dhomave.

Ambienti i sigurisë kishte gjeneratorë më vete, si burim rezervë të energjisë në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Në ambientin e sigurisë mungonte dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë gjyqësore dhe për takime me avokatët.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarlatin e Policisë nr.1, Tiranë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte sipas tipit “Model nr.1” të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrave të informacionit. Nga këqyrja e këtij dokumenti rezultoi se, regjistri ishte plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisarlati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga verifikimi i dy regjistrave ku evidentohen personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Nr.1, Tiranë, konkretisht për rastin e evidentimit të të dhënave në regjistër të personave të ndaluar nga banorët e Bashkisë Kukës në lidhje me tubimin e datë 31.03.2018 për anulimin e taksës së “Rrugës së Kombit”, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar shkelje lidhur me dokumentimin e orës se kur këtyre personave është privuar liria.

Konkretisht, në regjistra rezulton se këta personat kanë hyrë në mjediset e policisë Tiranë midis orës 8:00 - 9:30 të mëngjesit të datës 01.04.2018, çka do të thotë se këtyre personave duke qenë se janë banorë të Kukësit e janë ndaluar në Kukës u është privuar liria minimalisht 2 orë më parë, nëse do të marrim kohën që duhet për të përshkuar rrugën nga qendra e qytetit të Kukësit e deri në Tiranë.

Kjo praktikë, bie ndesh me rekomandimin e Avokatit të Popullit, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit duke kërkuar që, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

Sipërfaqja dhe kubatura e dhomave të sigurisë nuk ishte e mjaftueshme për kapacitetin fizik dhe akomodimin e 5 personave. Grupi inspektues konstatoi se, për shkak të mungesës së shtretërve në dy nga dhomat kishte persona të ndaluar/arrestuar që flinin në dyshekë të vendosur në dysheme.

Koha e qëndrimit të të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor, ndërsa për personat e ndaluar për shkak të ekzekutimit të vendimeve të dënimit të tyre penal ishte bërë shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për transferimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të vendosur nga gjykata.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe pyetja e personave të ndaluar/arrestuar rezultoi se, të arrestuarit/ndaluarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi sillej nga një subjekt privat me të cilin ishte lidhur kontratë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Nr.1 ishin të afishuara material informuese (postera) me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar dhe atyre të shoqëruar.

Nga informacioni i punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të ambientit të sigurisë.

Nga intervistimi i punonjësve të policisë rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu

sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht të caktuar nga prokurori sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur ose femra, ata shoqëroheshin menjëherë për në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për veprime procedurale të mëtejshme.

Grupi inspektimit, zhvilloi intervista dhe me personat e arrestuar/ndaluar, të cilët deklaruan se ishin njohur me të drejtat ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje dhe ishin takuar me avokatët e tyre.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Të arrestuarve/ndaluarve u ishte bërë vizita mjekësore brenda afatit 12 orë nga mjeku i DVP Tiranë,<sup>49</sup> i cili ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë të këtij komisariati.

Gjithashtu në këtë komisariat ishte vendosur edhe regjistri i kërkesë/ankesave të personave të arrestuar/ndaluar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të sigurisë sipas procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambientit që do të shërbejnë si zyrë më vete, për marrjen në pyetje dhe intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e pajisjeve të sigurisë (sisteme me kamera audio-vizive) për monitorimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe veprimeve të punonjësve të policisë me personat që ndodhen në këto mjedise policie. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin dhe plotësimin me materialet e nevojshme të dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e sigurisë. Marrjen e masave të menjëhershme për instruktimin e punonjësve të policisë të informacionit në plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të rubrikave të “Regjistrave të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar”, kryesisht për dokumentimin e saktë të orës kur shtetasve ju privohet liria dhe jo kur hyjnë në mjediset e policisë. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve sa më të pastra higjieno-sanitare të mjedisit dhe në dhomat ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

---

<sup>49</sup> Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1102, dt. 07.11. 2017.

## 6.10 KOMISARIATI I POLICISË NR.3 TIRANË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 26.09.2018 në Komisarati i Policisë Nr.3 Tiranë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika.**

Në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë, ambientet aktuale të shoqërimit nuk janë të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit” me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe miturit.<sup>50</sup>

Në këtë Komisarati kishte dy dhoma shoqërimi të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së Komisariatit brenda territorit të këtij organi. Dhomat ishin me dimensione 4 x 3m. Njëra prej tyre, e cila përdorej për personat e shoqëruar madhorë, kishte dritare me përmasa të vogla e cila nuk krijonte mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, por kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ndërsa dhoma tjetër, e cila përdorej për personat e shoqëruar femra dhe të mitur, ishte me dritare normale e cila lejonte ajrimin dhe futjen e dritës natyrale. Ato ishin të lyera dhe të pastra, si dhe kishin stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat ishin të pajisura me dyer druri të veshura me llamarinë dhe mbylleshin nga jashtë me shul dhe dryna. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili kishte ujë të rrjedhshëm dhe përdorej nga të shoqëruarit.

Në këtë Komisarati ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit ishte vetëm një person i shoqëruar për shkak se kishte kryer një aksident automobilistik dhe ndaj tij po kryheshin procedurat ligjore.

Në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë në ambientin e sigurisë kishte 3 dhoma sigurie, me kapacitet për 6 persona, të cilat përdorshin vetëm për meshkujt madhorë. Ndërsa të arrestuarit/ndaluarit femra dhe të mitur dërgoheshin në ambientin e sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Dhomat nuk ishin të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit. Ato nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë, dhe jo e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>51</sup> Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale, por sigurohej ndriçimi nga rrjeti elektrik në mënyrë të vazhdueshme. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra, por nuk ishin të pajisur me shtretër për të gjithë personat që trajtoheshin aty. Gjendej vetëm një shtrat, ndërsa të tjerët flinin në dyshekë të shtruar për tokë mbi zgarë druri.

<sup>50</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

<sup>51</sup> Kreu V, pika 3.3 e Manualit “Për Rregullat e Trajtitimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në tualetin që ndodhej në korridorin e ambientit të sigurisë. Ndërsa për larjen e trupit në tualet ishte instaluar një dush me ujë të ngrohtë. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Manualit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Dhoma për kryerjen e vizitave nga mjeku ndodhej jashtë ambienteve të sigurisë, ngjitur me të dhe ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Gjithashtu kjo dhomë përdorej edhe për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore.

Hyrja kryesore ambienteve të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Në Komisarlatin e Policisë nr. 3 Tiranë “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit Aktin e procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe regjistri ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarlat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë me shërbim katering, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë.

Ndonëse në ambientin e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë ose në ambientin e ajrimit.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore që u ndodhën në këtë komisarlat në kohën e inspektimit nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek

personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarariat ishte krijuar një magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarariat e Policisë nr. 3 Tiranë ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me të. Gjithashtu nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu ofrohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ose nga shkollat e mesme të qytetit.

Të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga personat e arrestuar/ndaluar.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e mjekut të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin e Personave të ndaluar/arrestuar”.<sup>52</sup> Mjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Ai i pasqyrore konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

---

<sup>52</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen të dhënat për personat shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për rastin e ndalimeve nga banorët e Bashkisë Kukës, për tubimin e datë 31.03.2018 për anulimin e taksës së “Rrugës së Kombit”, ka konstatuar shkelje në lidhje me dokumentimin e orës, kur këta persona kanë hyrë në mjediset e policisë Tiranë.

Konkretisht, në këta regjistra rezultonte se personat kanë hyrë në mjediset e policisë Tiranë midis orës 08:00 të mëngjesit dhe 09:30 të datës 1.4.2018, çka do të thotë se këtyre personave duke qenë se janë banorë të Kukësit dhe ishin ndaluar në Kukës iu ishte privuar liria minimalisht 2 orë më parë, nëse do të marrim kohën që duhet për të përshkuar rrugën nga qendra e qytetit të Kukësit e deri në Tiranë. Madje, grupi i inspektimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatoi se në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë deri në orën 17.45, të datës 01.04.2018, të ndaluarve nuk iu ishte dhënë asnjë dokument për veprimet e kryera nga Policia.

**Kjo praktikë, bie ndesh me rekomandimin e Avokatit të Popullit, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit duke kërkuar që, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.** Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave për ndërtimin në Komisarriatin e Policisë nr.3 Tiranë të ambienteve të shoqërimit sipas kërkesave të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për të rritur, femra dhe të mitur. Marrjen e masave për ndërtimin në këtë Komisarriat të ambienteve të sigurisë konform Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin me shtretër të dhomave të sigurisë, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për jetesë të shtetasve të arrestuar/ndaluar. Marrjen e masave për mos përsëritjen e praktikave të ngjashme të verifikuar në kontrollin e datës 1.04.2018 për të garantuar plotësimin në kohë, në mënyrë të saktë, korrekte dhe pa gabime të regjistrave të shoqërimit dhe/ose ndalimit të shtetasve, si dhe aplikimin e procedurave korrekte si nga ana personave shoqëruar, edhe atyre pritës, në lidhje me të shoqëruarit apo të ndaluarit.

## **6.11 KOMISARIATI I POLICISË NR.6 TIRANË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 21.09.2018 në Komisarriati i Policisë Nr. 6 Tiranë, sipas planit të inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se ky komisarriat së**

shpejti do të zhvendosej në ambientet e reja pasi ishte përfunduar rikonstruksioni i godinës së re dhe ishin duke u realizuar detajet e fundit të vënies në funksionim të saj.

Grupi i inspektimit paralelisht evidentoi edhe ambientet e godinës së re të Komisarariatit Nr.6 në Tiranë ku konstatoi se investimi i kryer është mjaft serioz duke e cilësuar këtë të fundit si një model për mënyrën se si duhet të ndërtohen apo ri konstruktohen edhe komisarariatet e tjera në RSH.

Për rrjedhojë ishte plotësuar rekomandimi i mëparshëm për marrjen e masave për sigurimin e investimeve të nevojshme dhe përfundimin e godinës së re, me qëllim transferimin e këtij komisaritati në godinën tjetër, pasi nuk plotëson standardet minimale në Ligjin Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016,

Nga ana tjetër grupi i inspektimit konstaton se për aq kohë sa ky institucion (Komisariati Nr.6 Tiranë, godina aktuale) vijon të jetë në shërbim të ligjit dhe shtetasve, cenohen të drejtat dhe liritë themelore të personave të shoqëruar dhe kryesisht femrave dhe të miturve<sup>53</sup>.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këtë rekomandim: Marrjen e masave për vënien në funksion të godinës së re të Komisarariatit Nr.6 Tiranë konform Ligjit Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Aktit mbi “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Aktit mbi “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016.

## **6.12 KOMISARIATI I POLICISË RINAS**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 25.09.2018 në Komisaritati i Policisë Rinas sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisariatin e Policisë “Nënë Tereza” Rinas ambienti i shoqërimit nuk ishte ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>54</sup>**

Në këtë Komisaritat kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarariatit brenda territorit të këtij institucioni. Dhoma ishte e bollshme për qëndrim, me dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër, por

<sup>53</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde

<sup>54</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.



e palyer. Dhoma ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit.

Në këtë Komisariat riatdhesohen në mënyrë periodike nga shtetet e tjera shtetas shqiptarë. Për këtë kategori personash ishin përshtatur dy ambiente qëndrimi. Ambienti i parë ishte vetëm për personat që riatdhesoheshin nga Anglia, për të cilin shteti anglez i paguante qeranë konçensionarit të aeroportit. Ky ambient ndodhej brenda territorit të aeroportit dhe i shkëputur nga ambientet e komisarariatit. Ambienti ishte me hapësirë dhe kushte të përshtatshme për qëndrimin e qytetarëve. Ndërsa ambienti tjetër, i cili përdorej për qëndrimin e shtetasve që riatdhesoheshin nga vendet e tjera, ishte pranë godinës së komisarariatit. Sipas drejtuesit të policisë, në këtë ambient mund të qëndrojnë ulur deri 30 persona, por numri i tyre shkon sipas rastit deri në 40 persona në të njëjtën kohë.

Grupi i punës konstatoi se sipërfaqja e tij ishte rreth 25 m<sup>2</sup>, kishte 13 karrige për të qëndruar ulur dhe një tualet. Kishte ndriçim natyral dhe artificial nëpërmjet energjisë elektrike, por dritaret ishin të pahapshme. Duke iu referuar hapësirës, numrit të karrigeve dhe mungesës së ajrimit, ky ambient nuk ishte i përshtatshëm për mbajtur shtetasit e riatdhesuar, numri i të cilëve sikurse përshkruam edhe më lartë është i konsiderueshëm. Gjithashtu në këtë komisariat kishte një ambient që shërbente si për akomodimin e femrave ashtu dhe për familjarët e riatdhesuar, i cili ishte i pajisur me dy divane për qëndrimin ulur, si dhe një tualet.

Personat e riatdhesuar regjistroheshin në librin përkatës dhe intervistoheshin të gjithë nga punonjësit e policisë të këtij Komisaritati. Ndërkohë ndaj tyre bëheshin edhe verifikime nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Sipas, punonjësve të policisë, koha e qëndrimit në komisariat të këtyre personave shkonte deri në 4 orë. Ky fakt u provua edhe nga pyetja e personave që ndodheshin aty në momentin e inspektimit.

Përveç sa më sipër, u konstatua se edhe ambientet e punës së punonjësve të policisë ishin të kufizuara dhe jo komode për të kryer me efikasitet detyrat e tyre ligjore.

Gjatë kohës së inspektimit në këtë komisariat u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët e ndryshëm, si shtetasit shqiptarë të riatdhesuar nga vendet e tjera, ashtu edhe me qytetarët shtetas shqiptarë dhe të huaj që hynin e dilnin në Aeroportin “Nënë Tereza” Rinas. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve të riatdhesuar dhe të disave prej atyre që hynin dhe dilnin nga aeroporti u konstatua se punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta, duke i trajtuar me respekt e dinjitet. Ne gjykojmë se kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë rrit imazhin dhe prestigjin e organit të Policisë së Shtetit Shqiptar në publik.

Gjatë inspektimit në këtë Komisariat grupi inspektues intervistoi një grup personash të sapo riatdhesuar dhe konstatoi se atyre në momentin e dorëzimit të pasaportës u jepej një kopje e proces-verbalit të mbajtur nga punonjësi i policisë<sup>55</sup> për secilin person të rikthyer në të cilin të pasqyroheshin

---

<sup>55</sup> Neni 109/1/f “Punonjësi i policisë bën shoqërimitin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

Neni 109/ 5 “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbalin nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

shkaqet e kthimit dhe kohëzgjatja e penaliteteve si rezultat i shkeljeve të rregullave Shengen nga personi i kthyer konform nenit 109/1/f dhe 109/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në Komisarlatin e Policisë Kufitare “Nënë Tereza” Rinas nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kufitare “Nënë Tereza” Rinas, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Aktit për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në këtë Komisarlat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk kishte asnjë ankesë apo kërkesë, të regjistruar. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Ndërtimin e ambientit të shoqërimit, duke shtuar edhe dy dhomave të tjera, referuar standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, dhe Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin ose krijimin e ambienteve të përshtatshme, me hapësirën e duhur, me ndriçim natyral, me ajrim dhe të pajisura me orenditë e nevojshme me qëllim për të siguruar kushte normale për qëndrimin dhe akomodimin e qytetarëve të riatdhesuar nga vendet e tjera. Marrjen e masave për të mundësuar ndërtimin e ambienteve të nevojshme pune dhe me kushte e standarde bashkëkohore për punonjësit e policisë të këtij komisarlati që zhvillojnë procedurat e riatdhesimit. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin dhe në dhomën e shoqërimit të këtij Komisarlati. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

### **6.13 KOMISARIATI I POLICISË VORË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 25.09.2018 në Komisarlati i Policisë Vorë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarlatin e Policisë**

Vorë ambienti i shoqërimit ishte ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Këto dhoma kishin sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>56</sup>

Në këtë Komisariat kishte tre dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së Komisarariatit brenda territorit të këtij institucioni. Dhomat ishin me përmasa të bollshme për qëndrim, me dritare të cilat lejonin ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra dhe e lyera rishtazi dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit.

Në këtë Komisariat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Në Komisariatin e Policisë Vorë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e ndaluar/arrestuar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Vorë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit Aktin e procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe regjistri ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në këtë Komisariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre për organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në Komisariatin e Policisë Vorë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk

---

<sup>56</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.<sup>57</sup>

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin dhe në dhomat e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Vorë. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e ngrohjes në dhomat e shoqërimit të këtij Komisarati.

#### 6.14 KOMISARIATI I POLICISË KAVAJË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 27.09.2018 në Komisarati i Policisë Kavajë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se mjediset e shoqërimit ishin ndërtuar të reja vitet e fundit në një godinë më vete, brenda territorit të këtij Komisarati. Në mjediset e brendshme të këtij Komisarati, ka 3 dhoma shoqërimi me përmasa 3x4 m, të pajisura me tavolina dhe me karrige, sipas standardeve. Ato janë sipas gjithë kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ambiente të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të shoqërimit ishin të bollshme për qëndrim, dhe ishin të pajisur me tualet brenda korridorit të përbashkët si dhe kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, por në këto dhoma u konstatua prani e theksuar lagështie, kjo për shkak se prej kohës së ndërtimit ato nuk ishin mirëmbajtur.**

Dhomat e shoqërimit kishin dritare përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra, por nuk ishin të pajisura me kamera monitorimi, sistemi i monitorimit nuk mbulonte as korridorin e këtij ambienti. U konstatua mungesa e ndriçimit në tualetin e përbashkët të dhomave të sigurisë dhe mungesa e ujit të ngrohtë,

Në korridorin e këtij ambienti ishin vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar në organet e policisë. Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë shenjë, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u këqyren të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë

---

<sup>57</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Gjyqësore në të gjitha ambientet e Komisarariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Ambienti i sigurisë nuk ishte konform normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në procedurën standarde , kishte 3 dhoma sigurie të cilat në momentin e inspektimit përdorshin për meshkuj të rritur. Dhomat e sigurisë ishin të përbëra nga dhomë dhe paradhomë, me ndriçim natyral.

Dhomat ishin të pajisura me krevate, batanije dhe çarçafë, paradhoma ndahej nga mjedisi tjetër me skarë hekuri, që mbyllet nga ana e brendshme e paradhomës pa dorezë. Korridori i ambientit të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi, tualetet në çdo dhomë ishin funksionale dhe të pastra.

Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por disa rubrika të regjistrit nuk plotësoheshin me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Konkretisht, në rubrikën “Adresa e vendbanimit” të personave të shoqëruar nuk ishte pasqyruar rruga, lagjia apo numri i banesës. Në rubrikën “Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve”, nuk ishin pasqyruar gjeneralitetet e të njoftuarit, numri i telefonit dhe ora e njoftimit të tyre.

Në këtë Komisarariat ishte edhe regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, gjithashtu u konstatua se ishte vendosur regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjatë inspektimit në Komisarariatet u konstatuan 2 persona të ndaluar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë

Gjatë inspektimit, grupi monitorues intervistoi personat e ndaluar,. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuar frikë apo druajtje për të raportuar.

Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Të ndaluarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë me katering, ndërkohë që nuk realizohej pajisja e të ndaluarve/arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh etj.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/arrestuarve, u rikonstatua problematika e përsëritur që, në organikën e institucionit nuk është parashikuar një mjek i përgjithshëm, por me **Urdhër nr 1102, dt. 07.11. 2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**, detyra e mjekut i është deleguar mjekut të përgjithshëm të Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë. Gjithashtu u kontaktua se për të

ndaluarit/të arrestuarit nuk kryheshin rregullisht nga mjeku, nuk kishte një psikolog të parashikuar në organikën e këtij komisariati, por në çdo rast ai kontaktohej në bashkinë Kavajë.

Në dhomës së mjekut, u vu re një ambient i papërshtatshëm për kryerjen e vizitave, përfshirë këtu edhe kubaturën e vogël të tij. Krevati i vizitave ishte i papërshtatshëm, dollapi për mbajtjen e medikamenteve ishte jashtë standardit, mungonin ilaçet bazë të urgjencës, si edhe ilaçe të tjera të domosdoshme për një shërbim efikas shëndetësor, nuk kishte frigorifer për mbajtjen e ilaçeve të posaçme.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës, nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, u rekomandua:

Marrja e masave të menjëhershme për futjen në organikë të personelit mjekësor, në Komisaratin e Policisë Kavajë, Marrjen e masave për futjen në organikë të psikologut, si pjesë e rëndësishme e të gjithë procesit të arrestimeve apo ndalimeve, marrjen e masave për rikonstruksionin e dhomës së mjekut, pajisjen e saj me bazën materiale të nevojshme, marrjen e masave për pajisjen me sistem monitorimi të dhomës, së marrjes në pyetje të ndaluarve/arrestuarve nga organi i akuzës, si edhe për takim me avokatët, marrjen e masave të nevojshme me qëllim plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të të gjitha rubrikave të regjistrit të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar” në këtë komisarati, si dhe të dokumenteve të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore lidhur me të shoqëruarit, marrjen e masave për mirëmbajtjen dhe eliminimin e pranisë së lagështirës në të trija dhomat e sigurisë, marrjen e masave për sigurimin e ndriçimit në tualetin e përbashkët dhe sigurimin e ujit të ngrohtë, marrjen e masave për pajisjen e të ndaluarve/arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh etj.

## **6.15 KOMISARIATI I POLICISË TEPELENË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 01.10.2018 në Komisarati i Policisë Tepelenë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisaratin e Policisë Tepelenë ambiente të shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në Ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016.**

Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur<sup>58</sup>, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve.

Në këtë komisarati kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtesë brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik.

Ato ishin të pastra, dhe të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ishte ndërtuar edhe tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm. Gjithashtu kishte edhe gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh.

---

<sup>58</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

Në këtë komisariat sërish nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Në Komisarlatin e Policisë Tepelenë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Gjirokastrë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Tepelenë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me parashikimin në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>59</sup>.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Në Komisarlatin e Policisë Tepelenë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Gjithashtu Komisarlati i Policisë Tepelenë nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduralë.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Punonjësit e policisë pasqyruar për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar

---

<sup>59</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë.

Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Tepelenës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë ishte zhvilluar konform ligjit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve proceduralë nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

## **6.16 KOMISARIATI I POLICISË PËRMET**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 01.10.2018 në Komisaritati i Policisë Përmet, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisariatin e Policisë Përmet ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016.**

Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur,<sup>60</sup> duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve.

Në këtë komisarariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së këtij komisaritati. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra, dhe të lyera rishtaz dhe ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator.

---

<sup>60</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.



Dhoma e shoqërimit të femrave kishte tualet brenda, ndërsa për të shoqëruarit meshkuj kishte një tualet, i cili ndodhej në korridorin e ambientit të shoqërimit. Në këtë komisariat sërish nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisarlatin e Policisë Përmet nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Gjirokastrë. Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Përmet, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>61</sup>.

Në këtë komisariat kishte regjistrë për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistrë ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistrë për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

## **6.17 KOMISARIATI I POLICISË GJIROKASTËR**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 03.10.2018 në Komisarlatin e Policisë Gjirokastrë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në komisarlatin e Policisë Gjirokastrë nuk kishte zyra të intervistimit ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe pajisjen e tyre me sistem të monitorimit me kamera.**

<sup>61</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

Në Komisariatin e Policisë Gjyrokastër, ambienti i shoqërimit ishte në katin e parë të godinës dhe përbëhej nga tre dhoma shoqërimi, një për meshkujt madhorë, një për femrat dhe një për të miturit.

Ato ishin ndërtuar sipas kritereve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në korridorin e këtij ambienti, pranë dhomave të shoqërimit kishte tualete të cilët ishin të pastra dhe kishin ujë të rrjedhshëm. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

U konstatua se në këtë komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Gjyrokastër mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë, Gjyrokastër, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Në këtë komisarjat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarjat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në Komisariatin e Policisë Gjyrokastër në ambientin e sigurisë kishte aktualisht 8 (tetë) dhoma me kapacitet për 8 (tetë) persona. Dhomat ishin të ndërtuara sipas kërkesave të parashikuara në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Në 5 (pesë) prej dhomave të sigurisë ishin bërë disa ndryshime që konsistonin konkretisht në spostimin e llambave brenda këtyre ambienteve në

mënyrë që ato të mos ishin të arritshme nga të ndaluarit për të garantuar sigurinë e tyre. Gjithashtu ishin realizuar edhe tualetet e reja në këto dhoma.

Ato ishin të ndara më vete në 1 (një) dhomë për femra, 1 (një) dhomë për mitur dhe 6 (gjashtë) dhoma për meshkuj madhorë, si dhe ishin të pajisura me 8 (tetë) krevate. Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>62</sup>

Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda, si dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte një ambient të posaçëm (dushi me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor.

Gjithashtu në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër, sikurse parashikohet në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Dhomat kishin edhe burim rezervë energjie me gjenerator.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore e cila nuk ishte e monitoruar nga kamerat. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige. Hyrja kryesore ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personi i arrestuar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të.

---

<sup>62</sup>“Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Në ambientin e sigurisë kishte 1 (një) person të arrestuar gjatë kohës së inspektimit. Grupi i monitorimit intervistoi personin e arrestuar, i cili konfirmoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

I intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarit ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Personit të ndaluar/arrestuar i ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tij. Ai kishte kontaktuar edhe me një avokat dhe ishte në pritje të procedurave gjyqësore lidhur me caktimin e masës së sigurisë dhe vlerësimit të arrestit.

Ndërkohë në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjyqësore kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk monitorohej me kamera.

Gjithashtu, Komisaritati i Policisë Gjyqësore në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e personelit mjekësor kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Mjeku ishte i pranishëm sipas nevojave dhe thirrje të kryente procedurat përkatëse në kohë.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin në mënyrë të menjëhershme këto rekomandime:

Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit në dhomën që ndodhet në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjyqësore që shërben për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave për shtimin në organikën e personelit të Komisarariatit të Policisë Gjyqësore të pozicionit të mjekut me kohë të plotë.

## 6.18 KOMISARIATI I POLICISË DELVINË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 07.10.2018 në Komisarati i Policisë Delvinë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se , vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika. Konkretisht, nuk ishin zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me: ndërtimin në Komisaratin e Policisë Delvinë të ambientit të shoqërimit sipas kritereve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur, të monitoruar me sistemin e kamerave; si dhe në ambientin e shoqërimit nuk ishte krijuar dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë.**

Nga kontrolli i dokumentacionit dhe i regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar në mjediset e policisë grupi i inspektimit konstatoi se, në këtë Komisarati zbatohet rekomandimi i Institucionit të Avokatit të Popullit për plotësimin me saktësi dhe përgjegjësi i rubrikave të “Regjistrit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”.

Në Komisaratin e Policisë Delvinë nuk kishte dhoma sigurie. Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>63</sup>, personat e arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë të këtij komisarati, shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Komisaratisë të Policisë Vlorë.

Sipas informacionit, lëvizja dhe shoqërimi i personave të **arrestuar/ndaluar** për në dhomat e sigurisë të Komisaratisë të Policisë Vlorë, bëhet për çështje sigurie dhe mungesë hapësirash dhe kushtesh në këtë Komisarati, me automjetet e veta të policisë<sup>64</sup>.

Gjithashtu, grupi i inspektimit konstatoi se në Komisaratin e Policisë Delvinë ishin marrë masa për përmirësimin e kushteve higjiena–sanitare në dhomën e shoqërimit, por ende vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika që kishin të bënin me mungesën e infrastrukturës së nevojshme të ambientit të shoqërimit, në përputhje me standardet ligjore, për garantimin e respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar.

Në Komisaratin e Policisë Delvinë ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, dt. 31.03.2016. Ndërkohë, plotësimi i standardeve të parashikuara në ligj është detyrim ligjor minimal dhe çon në përgjegjësi ndaj personave të cilët nuk garantojnë trajtimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, në një mënyrë të ndryshme nga ajo e parashikuar në ligj.

---

<sup>63</sup> Kreu VIII, pika 1, Ndërtimi i dhomave të sigurisë në njësitë policore, të procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

<sup>64</sup> Kreu X, pika 1.1/c, Rregullat dhe masat e sigurisë gjatë veprimeve me të ndaluarit/arrestuarit, jashtë dhomave të sigurisë, të procedurës standarde.

Në ambientin e shoqërimit të këtij komisariati kishte vetëm një dhomë shoqërimi e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomës të shoqërimit ishte sipas kritereve teknike. Dhoma kishte një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër nga ana higjieno-sanitare dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige të palëvizshme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Ambienti i shoqërimit nuk kishte tualet brenda dhomës apo ngjitur me të, por si i tillë shërbente tualeti që përdorej nga personeli i komisariatit.

Grupi i inspektimit konstatoi se, në ambientin e shoqërimit mungonin dhoma më vete për personat e shoqëruar femra dhe të miturit<sup>65</sup>, dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje të personit të shoqëruar nga punonjësit e policisë, si dhe nuk ishte i instaluar sistemi i kamerave për monitorimin dhe mbajtjen në vëzhgim të këtyre ambienteve. Mungesa e këtyre elementeve përbëjnë shkelje të rregullave teknike dhe standardeve për shoqërimin e personave në mjediset e policisë.

Në Komisaratin e Policisë Delvinë, nuk kishte ambient sigurie dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë. Nga inspektimi i ambientit të sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, rezultoi se gjendja teknike dhe kapaciteti i dhomave nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret ligjore për ndërtimin e tyre. Në këto kushte, ambienti i sigurisë nuk ishin në gjendje të përballonin numrin e personave të arrestuar/ndaluar nga të tre Komisarariatet e Policisë Vlorë, Sarandë dhe Delvinë, në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Kjo përbën një shkelje të të drejtave të personave të privuar nga liria, lidhur me kushtet e qëndrimit dhe trajtimin që u bëhet nga personeli policor.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Delvinë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Nga verifikimi i regjistrit, rezultoi se, personat e shoqëruar kishin qëndruar në ambientin e shoqërimit të Komisarariatit, jo më shumë se 4-5 orë mesatarisht.

Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësi i informacionit të komisariatit të policisë<sup>66</sup>.

Në këtë komisarati kishte regjistrë për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga verifikimi i regjistrave rezultoi se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës të viteve të kaluara, lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë,

<sup>65</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

<sup>66</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

pra në orën kur personit është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës, apo personi ka hyrë në komisariatit e policisë.

Gjithashtu, grupi inspektues konstatoi se, në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në kohën e kryerjes së inspektimeve në ambientet e shoqërimit në Komisariatit e Policisë Delvinë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Në Komisariatit e Policisë Delvinë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me kamera. Ndërkohë, mungonte dhoma më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila të jetë e monitoruar me kamera, për vëzhgimin e punonjësve të policisë gjyqësore gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me këta persona.

Në rastet kur personat e ndaluar/arrestuar ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa asistenca e psikologut sigurohej nga shkolla e mesme e qytetit të Delvinës ose punonjësi në organik të Bashkisë Delvinë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariatit, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Në përfundim grupi i inspektimit, administroi kopje të shkresës të Komisarariatit të Policisë Delvinë<sup>67</sup> drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, kërkesë për mbështetje buxhetore për ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas procedurës standarde të rregullave të shoqërimit në polici. Nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, nuk kishte asnjë përgjigje me shkrim lidhur me plotësimin e kërkesave të parashtruara në shkresën e Komisarariatit të Policisë Delvinë. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet të përmbusheshin në mënyrë të menjëhershme këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin në Komisarariatit e Policisë Delvinë të ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, dt.31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur, të monitoruara me sistemin e kamerave. Marrjen e masave të nevojshme për

<sup>67</sup> Shkresë nr.869/2 prot., datë 12.08.2018 drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për vëzhgimin e korridorit të ambientit të shoqërimit dhe në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar.

## **6.19 KOMISARIATI I POLICISË SARANDË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 17.10.2018 në Komisarati i Policisë Sarandë sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisaratin e Policisë Sarandë ambienti i shoqërimit nuk ishte ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.**

Grupi inspektimit konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ishte vetëm 1 (një) dhomë që shërbente për shoqërimin e personave të rritur dhe femrave, në formën dhomë-paradhomë. Në rastet kur shoqëroheshin të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë deri në përfundim të verifikimit të rastit apo kryerjes së veprimeve procedurale për të cilat ishin shoqëruar në organin e policisë.

Paradhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ndërsa dhoma ishte e pajisur me stola të palëvizshëm në dy anë. Ndryshimi natyral dhe ajrimi në paradhomë ishte i mjaftueshëm, ndërsa në dhomë ndryshimi dhe ajrimi bëhej indirekt nga paradhoma dhe ishte i pamjaftueshëm. Gjithashtu, dhoma dhe paradhoma kishin ndryshim artificial nga rrjeti elektrik. Në fundin e dhomës ndodhej një tualet për plotësimin e nevojave vetjake të personave të shoqëruar. Ambienti i shoqërimit ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare.

Nga inspektimi rezultoi se, në ambientin e shoqërimit mungonte dhoma e shoqërimit më vete për femrat dhe të miturit<sup>68</sup>, si dhe dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar. Marrja në pyetje e këtyre personave kryhej në zyrat e punonjësve të policisë.

Në Komisaratin e Policisë Sarandë grupi inspektues konstatoi gjithashtu se, mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit në ambientin e shoqërimit, si dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Institucioni i Avokati i Popullit, ka rekomanduar ndërtimin e ambientit të shoqërimit sipas standardeve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz të të shoqëruarve, por nga inspektimi rezultoi se, ky ambient nuk ishte në përputhje me aktet ligjore dhe dokumentet ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim.

Institucioni i Avokati i Popullit gjykon se, standardet e përcaktuara në rregullat teknike të shoqërimit, janë standarde minimale që duhet të respektohen në mjediset e policisë, ndaj plotësimi i tyre është detyrim ligjor për organet e policisë.

---

<sup>68</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”



Në Komisarariat e Policisë Sarandë gjendja e ambientit të sigurisë, nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017.

Ambienti i sigurisë ndodhej brenda godinës së Komisarariatit të Policisë Sarandë. Në këtë ambient, kishte 2 dhoma me kapacitet për 3 (tre) persona, i cili shërbente vetëm për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të rritur. Në rastet kur personat e arrestuar/të ndaluar ishin femra dhe të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientin e dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë.

Ndërkohë, gjendja e kushteve fizike dhe materiale në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë bëhet problematike, në rastin e sjelljes të personave të arrestuar/ndaluar nga komisarariatet e policisë Sarandë dhe Delvinë. Në këtë Komisarariat, mungojnë ambientet e përcaktuara në procedurën standarde, në veçanti dhomat për trajtimin me dinjitet të femrave dhe të miturve të arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit konstatoi se, kushtet dhe gjendja teknike në ambientin brenda dhe jashtë dhomave të sigurisë nuk ishin të përshtatshme për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar<sup>69</sup>. Korridorit dhe muret e dhomave ishin me lagështirë. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të vogla dhe nuk lejonin futjen e ajrimit dhe të ndriçimit natyral të mjaftueshëm. Të dyja dhomat ishin të pajisura me shtretër, respektivisht dy shtretër në njërin dhomë dhe një shtrat në dhomën tjetër. Ato ishin të pajisura me materiale si dyshekë, batanije e jastëkë, por ato ishin të vjetërsuara.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet i përbashkët, i cili kishte ujë të rrjedhshëm, por nuk kishte dush me ujë të ngrohtë. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Gjithashtu në ambientin e sigurisë nuk kishte mjedis më vete për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve.

Në ambientin e sigurisë ishte instaluar një telefon fiks, i cili shërbente në rastet emergjente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient. Ndërsa në dhoma mungonte butoni me zile/sinjali në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe të dhomave të sigurisë. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike, komisarariat kishte në gatishmëri një gjenerator për furnizimin e ambientit të sigurisë me energji elektrike.

Nga informacioni i drejtuesit të komisarariatit të policisë, rezultoi se në rastet kur numri i personave të arrestuar/të ndaluar ishte mbi kapacitetin e dhomave të sigurisë, këta persona shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ose në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë. Ndërkohë, në bazë të një marrëveshje midis Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, dhoma e observimit/veçimit në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Sarandë, përdorej si dhomë sigurie.

---

<sup>69</sup> Kreu VIII, pika 3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë së këtij komisariati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër u kontrollua dhe ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariatit të policisë, konstatoam se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës të mëparshme, lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata shoqërohen për në organin e policisë, pra në orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës apo kur hyjnë në komisariat.

Gjatë kryerjes të inspektimit në ambientin e shoqërimit dhe në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar apo të arrestuar/ të ndaluar.

Nga këqyrja në vend e sipërfaqes dhe kubaturës të dhomave të sigurisë rezultoi se, ato nuk plotësonin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në procedurat standarde, për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave që qëndrojnë në këto ambiente. Në rast mbipopullimi në të dy dhomat e planifikuara për personat e rritur, njëri prej tyre flinte në dyshek të vendosur në dysheme, për shkak të mungesës të shtretërve.

Grupi i inspektimit intervistoi punonjësit e policisë që shërbenin në këto ambiente dhe kontrolloi dokumentacionin lidhur me mënyrën e evidentimit të rasteve apo pretendimeve të shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar për trajtim denigrues, jo human, si dhe për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë ndaj tyre. Në shënimet e mbajtura në regjistrat e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë dhe punonjësve të informacionit, grupi i inspektimit nuk konstatoi raste të keqtrajtimit ndaj shtetasve të shoqëruar apo personave të arrestuar/ të ndaluar.

Punonjësit e policisë të këtij komisariati shpjeguan gjithashtu se, në rastet e shoqërimit të personave në mjediset e policisë, si dhe gjatë ndalimit/arrestimit të tyre, punonjësit e policisë identifikoheshin duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Koha e qëndrimit të të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor. Nga intervistimi i punonjësve të informacionit dhe verifikimi i shënimeve në regjistrin e të dhënave të personave të arrestuar/ndaluar, rezultoi se, gjatë këtij viti nuk kishte raste të vonesave për transferimin e tyre, pas marrjes të vendimit nga ana e gjykatave, për në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Lidhur me trajtimin me ushqim të të ndaluarve/arrestuarve ai kryhej tre herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej në kuzhinën e I EVP Sarandë, e cila ndodhej ngjitur me godinën e komisariatit të policisë.

Nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e policisë në Komisariatin e Policisë Sarandë, si dhe nga verifikimet në vend të ambienteve të shoqërimit dhe ato të sigurisë, rezultoi se pranë tyre nuk kishte asnjë zyrë intervistimi për marrjen në pyetje të shtetasve nga punonjësit e policisë. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të hynin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera.

Lidhur me të drejtën e ligjshme për informim të personave që ndodhen në dhomat e shoqërimit, si dhe në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e tyre ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të arrestuar/ndaluar dhe atyre të shoqëruar, por ato ishin të vjetërsuara dhe duhet të rinovohen me postera të rinj.

Në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë mungonin fletë palosjet me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në gjuhë të huaj.

Grupi i inspektimit konstatoi se, për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, punonjësit e zyrës së informacionit dispononin formularë me të drejtat e të arrestuarve/ndaluarve në disa gjuhë të huaja dhe ishin pjesë e dokumentacionit që shoqëronin këta persona.

Nga intervistimi i punonjësve të policisë, rezultoi se ndaj personave të arrestuar/ndaluar dhe personave të shoqëruar ishte respektuar e drejta e tyre për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje. Po ashtu, këtyre personave u ishin krijuar mundësi reale nga punonjësit e policisë për të kontaktuar me avokatët e tyre dhe asistuar sa herë që ata merreshin në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurorët e çështjes.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej nga prokurori mbrojtja me avokat kryesisht, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin femra dhe të mitur, dërgoheshin në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë. Veprimet procedurale për të miturit kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës apo të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë. Ndërsa psikologu ishte plotësuar në organikën e komisarariatit të policisë.

Të ndaluarve dhe të arrestuarve u vihej në dispozicion nga oficerët e policisë gjyqësore kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të formularit me të drejtat e tyre.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, vizita mjekësore e të ndaluarve/arrestuarve nga ana e personelit mjekësor ishte kryer brenda afatit të 12 orëve nga koha e vendosjes së tyre në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurat standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.<sup>70</sup> Vizita mjekësore e të ndaluarve/të arrestuarve kryhej nga një mjek i Spitalit të Sarandës, pasi Komisarati i Policisë Sarandë nuk ka në organik personel mjekësor. Shënimet me konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë, kartelat mjekësore (kartelat ditore) ishin të plotësuara dhe gjendeshin në fashikullin përkatës për çdo të arrestuar/ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë Sarandë ishin vendosur regjistra për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Nga verifikimi i tyre rezultoi se, kishte një numër shumë të vogël të ankesë/kërkesave të regjistruara në këtë regjistër nga personat e shoqëruar dhe të

---

<sup>70</sup> Kreu II, pika 7, procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

ndaluar/arrestuar, kryesisht për sigurimin e avokatit mbrojtës, të cilat ishin zgjidhur nga prokurori i çështjes duke caktuar avokatë kryesisht.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e përkohshme të dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Sarandë, deri në plotësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, që të garantojnë respektimin e të drejtave të personave që qëndrojnë në këto ambiente. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës më vete në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në mjediset e policisë. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e pajisjeve të sigurisë (sisteme me kamera audio-vizive) për vëzhgimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, të dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe për monitorimin e veprimeve të punonjësve të policisë me personat që ndodhen në mjediset e policisë. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin në dhomat e sigurisë të butonit me zile/sinjali në mur, për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjës in e policisë në rast nevojë. Marrjen e masave për vendosjen e posterave dhe fletëpalosjeve në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë.

## 6.20 KOMISARIATI I POLICISË POGRADEC

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 31.10.2018 në Komisarlatin e Policisë Pogradec, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarlatin e Policisë Pogradec nuk kishte ambiente shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>71</sup>**

Në këtë Komisarlat sërish kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në një ndërtesë 1(një) katëshe brenda territorit të këtij organi e ndarë nga godina e Komisarlatit. Dhoma kishte një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik.

Ajo ishte e pastër dhe e lyer rishtazi dhe ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje. Në rastet kur shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre. Në korridorin e ambientit të shoqërimit kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit. Komisarlati kishte edhe burim rezervë energjie me gjenerator.

<sup>71</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

Në këtë Komisarariat nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisariatin e Policisë Pogradec nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Korçë.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për realizimin e investimit për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pogradec sipas kërkesave të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në korridoret e tyre si dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

## **6.21 KOMISARIATI I POLICISË KOLONJË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 01.11.2018 në Komisarati i Policisë Kolonjë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se:** Komisarati i Policisë Kolonjë është i përqendruar në një godinë të vjetër ekzistuese e cila është shumë e amortizuar dhe nuk ofron kushte të denja pune edhe për punonjësit e këtij institucioni çka kërkon domosdoshmërisht realizimin e investimeve për rikonstruksionin e saj në vijim.

U konstatua se nuk ishte plotësuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

Gjithashtu edhe rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridorin e dhomave të shoqërimit nuk ishte zbatuar ende.

Por nga ana tjetër u konstatua se institucioni i Komisarariatit të Policisë Kolonjë kishte bërë përpjekjet e nevojshme duke ju drejtuar organeve eprore me kërkesa për të mundësuar realizimin e investimeve në këtë institucion në kuadrin e përmirësimit të mëtejshëm të ambienteve të shoqërimit për të garantuar respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar.

Grupi i inspektimit u njoh gjithashtu edhe me veprimtarinë administrative edhe kërkesat e këtij institucioni drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, lidhur me krijimin e kushteve sipas standardeve për vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kolonjë, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit,

duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.

Në Komisariatin e Policisë Kolonjë ambientet e shoqërimit ishin përshtatur duke shfrytëzuar si dhoma shoqërimi dy nga ambiente ekzistuese të godinës, prej të cilave njëra për meshkujt madhorë dhe tjetra për femrat dhe të miturit.

Dy dhomat aktuale të shoqërimit që përdorehin, ishin të rregullta dhe kishin nga një dritare të madhe të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim funksional nga rrjeti elektrik. Gjithashtu realizohej edhe furnizimi me energji elektrike me anë të gjeneratorit në rast defektesh elektrike.

Dritaret ishin pa hekura dhe gjithashtu dyert e tyre ishin pa hekura. Ato ishin të mirëmbajtura, të pastra, të lyera rishtazi dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientit të shoqërimit kishte një tualet, i cili përdorej nga punonjësit e policisë dhe të shoqëruarit.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit nuk ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryheshin me të shoqëruarit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisariatin e Policisë Kolonjë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Korçë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Kolonjë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>72</sup>.

Në këtë komisarjat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarjat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

---

<sup>72</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

Në Komisarlatin e Policisë Kolonjë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat sipas një liste që disponohej në institucion.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit dhe Bashkinë Ersekë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisarlati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin në mënyrë të menjëhershme këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për rikonstruksionin dhe realizimin e investimeve në Komisarlatin e Policisë Kolonjë për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni ashtu edhe për të krijuar ambiente cilësore për ofrimin e shërbimeve për qytetarët e interesuar. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksion të dhomës së tretë të shoqërimit dhe miratimin e këtyre ambienteve në Komisarlatin e Policisë Kolonjë sipas kërkesave të ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm, dinjitoz, të pajisur me orenditë e nevojshme për qëndrim. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

## **6.22 KOMISARIATI I POLICISË LUSHNJË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 05.11.2018 në Komisarlati i Policisë Lushnjë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në këtë komisarlat por nuk ishte realizuar sërish ndërtimi i ambienteve të reja sipas kërkesave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar dhe aktit mbi “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.**

U konstatua se nuk ishte plotësuar rekomandimi marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

Gjithashtu nuk ishte plotësuar rekomandimi për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Lushnje sipas kritereve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.

Gjithashtu ishte plotësuar rekomandimi për plotësimin me saktësi të të gjitha rubrikave të “Regjistrimit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” në këtë komisariat, si dhe të dokumenteve të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore lidhur me të shoqëruarit.

Në Komisarlatin e Policisë Lushnjë nuk kishte dhoma shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.

Ambienti i shoqërimit që përdorej aktualisht ndodhej në një godinë më vete, brenda territorit të këtij organi. Ambienti kishte hyrje direkte pa korridor dhe nuk ishte i monitoruar me kamera. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 1 (një) dhomë me përmasa 8m x 7m dhe përdorej vetëm për shoqërimin e meshkujve madhorë, ndërsa për shoqërimin e femrave dhe për të miturit përdorej ambienti i pritjes së qytetarëve dhe zyrat e punonjësve të policisë.

Ambienti që përdorej për shoqërimin e meshkujve madhorë, ishte i rregullt dhe kishte një dritare të madhe e cila lejonte ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishte ndriçim funksional nga rrjeti elektrik. Gjithashtu realizohej edhe furnizimi me energji elektrike me anë të gjeneratorit në rast defektesh elektrike. Dritarja ishte pa hekura dhe ambienti nuk kishte derë. Dhoma që përdorej për shoqërim ishte e pastër dhe e lyster dhe ishte pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë e stola të gjatë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Pranë ambientit të shoqërimit që përdorej për meshkujt madhorë kishte dy tualete të cilët ishin të pastër dhe kishin ujë të rrjedhshëm. Në momentin e inspektimit nuk kishte shtetas të shoqëruar. Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

U konstatua se në këtë komisariat zbatohesh detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë, Lushnjë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde:



“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>73</sup>.

Në këtë komisariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar për të bërë ankesa në qoftë se kishin të tilla.

Në Komisarlatin e Policisë Lushnjë nuk kishte ambiente të sigurisë pasi ato ishin mbyllur në përputhje me rekomandimin e bërë pak kohë më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Fier. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Lushnje sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë dhe miratimin e tyre sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktit mbi “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave (zyrave) të punës në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

## **6.23 KOMISARIATI I POLICISË MALËSI E MADHE**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 21.11.2018 në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarlatin e Policisë Malësi e Madhe nuk kishte ambiente shoqërimi të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në Aktin për procedurat standarde: “Rregullat teknike**

<sup>73</sup> Kreu VII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>74</sup>

Në këtë Komisarariat sërisht kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisarariatit brenda territorit të këtij organi. Dhoma ishte me përmasa 4 x 4m, kishte një derë druri të veshur me llamarinë, mbyllja e të cilët bëhej me shul dhe dry, një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër dhe e lyer rishtazi dhe ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar madhorë meshkuj. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje. Në rastet kur në Komisarariat shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit.

Në këtë Komisarariat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Aktit për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në këtë komisarariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore

---

<sup>74</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde.

dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në korridoret e tyre si dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

## 6.24 KOMISARIATI I POLICISË SHKODËR

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 21.11.2018 në Komisariati i Policisë Shkodër sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në këtë Komisariat kishte tre dhoma shoqërimi të cilat ndodheshin në katin e parë të ndërtesës së Komisarariatit brenda territorit të këtij organi. Dhomat ishin me përmasa 4 x 3.5m, me dyer druri, por të veshura me llamarinë dhe mbylleshin me shul dhe dryna, dritaret lejonin ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra dhe të lyera dhe ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar madhorë, pasi personat e shoqëruar femra dhe të mitur mbaheshin nëpër zyra deri në përfundim të veprimeve procedurale. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili kishte ujë të rrjedhshëm dhe përdorej nga të shoqëruarit. Grupi i inspektimit u njoh me projektin e ri të godinës së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në të cilin ishin parashikuar edhe ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë. Theksojmë se projekti i ri kishte filluar të zbatohet dhe pritej të përfundonte gjatë vitit 2019. Projektimi dhe ndërtimi i këtyre ambienteve në Komisarariatin e Policisë Shkodër ishin sipas kërkesave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.**

Në këtë Komisariat ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Sipas projektit në zbatim ambientet e reja të shoqërimit në ndërtim e sipër do të jenë të pajisura me kamera. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisarariatin e Policisë Shkodër në ambientin e sigurisë kishte 14 dhoma sigurie nga të cilat përdorëshin vetëm 5 prej tyre. Dhomat nuk ishin të ndërtuara sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara më vete, një për femra, një për mitur dhe tre për meshkuj madhorë. Ato nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë, dhe jo e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>75</sup> Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ajrimi i të arrestuarve/ndaluarve bëhej në një ambient të hapur, i cili ndodhej brenda ambientit të sigurisë. Dhomat e sigurisë nuk ishin të pajisura me tualete brenda. Ndërkohë ishin të pajisura me dyshekë,

---

<sup>75</sup> Kreu V, pika 3.3 e Manualit “Për Rregullat e Trajtitimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje relativisht të mirë dhe të pastra, por nuk ishin të vendosur në krevate. Dyshekët vendoseshin mbi dyshemenë prej dërrase. Këto dhoma sipas dinamikës së caktuar mund të akomodonin deri në katër veta në një dhomë. Në këto dhoma akomodoreshin me cilësinë e personave të ndaluar, arrestuar dhe persona të sjellur nga Komisaritet e Pukës dhe Malësisë së Madhe.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në tualetet që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kalidajë për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Manualit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë nuk monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Në Komisaritetin e Policisë Shkodër "Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar" ishte i tipit "Model nr. 1" konform Aktit për procedurat standarde: "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, dt. 31.03.2016, i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" regjistroheshin në këtë regjistrë nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoreshin e siguroreshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisaritet evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistrë ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Në kohën e inspektimit në ambientin e shoqërimit në Komisaritetin e Policisë Shkodër nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodheshin 6 persona të arrestuar/ndaluar në ditët e fundit.

Grupi i monitorimit intervistoi personat e arrestuar/ndaluar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e tyre ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasojë të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmonin frikë apo intimidim për të

raportuar keqtrajtimin e tyre. Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë shoqërimit dhe arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre dhe prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Koha e qëndrimit të arrestuarit në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

Sikurse u përmend edhe më sipër, në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk monitorohej me kamera. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore që u ndodhën në këtë komisarariat në kohën e inspektimit nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat ishte krijuar një magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e mjekut të Spitalit Rajonal Shkodër brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin e Personave të ndaluar/arrestuar”.<sup>76</sup> Mjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të pjesshme. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatoheshin detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e ankesave dhe kërkesave të personave të ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar. Nga verifikimi tij rezultoi se nuk ishte regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë nga personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për të realizuar në kohën e parashikuar në kontratë të ndërtimit të godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe vënien në funksion të ambienteve të reja të shoqërimit dhe të sigurisë në këtë Komisarariat, sipas kërkesave të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të

---

<sup>76</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit.

shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe Aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr.1102, datë 07.11.2017. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në dhomat e shoqërimit dhe në korridoret e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë.

## **6.25 KOMISARIATI I POLICISË PUKË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 23.11.2018 në Komisarati i Policisë Pukë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në këtë Komisarati sërish kishte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e parë të ndërtesës së Komisariatit brenda territorit të këtij organi. Dhoma ishte me përmasa 4 x 4m, kishte një derë druri të veshur me llamarinë, mbyllja e të cilët bëhej me shul dhe dry, një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër dhe e lyer rishtazi dhe ishte e pajisur me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar madhorë meshkuj. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje. Në rastet kur në Komisarati shoqëroheshin femra dhe të mitur, ata mbaheshin në zyrat e punës deri sa mbaronin procedurat e verifikimit dhe të pyetjes së tyre. Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte një tualet, i cili përdorej nga të shoqëruarit.**

Në këtë Komisarati ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisaratin e Policisë Pukë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Shkodër.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Pukë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Aktit për procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në këtë Komisarati kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga

verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat gjithashtu kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në Nenin 115 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarariat e Policisë Pukë sipas kërkesave të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për miratimin e procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në korridoret e tyre si dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

## **6.26 KOMISARIATI I POLICISË MIRDITË**

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 05.12.2018 në Komisarariat i Policisë Mirditë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisarariat e Policisë Mirditë ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.**

Grupi i inspektimit, konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ndodheshin 3 (tre) dhoma shoqërimi, nga të cilat 2 (dy) dhoma shërbenin për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e komisarariatit të policisë për personat e rritur dhe femrat, ndërsa ambienti tjetër ishte kthyer në dhomë për ruajtjen dhe administrimin e provave materiale nga organi i Prokurorisë dhe ishte e mbyllur.

Ambienti i dhomave ishte me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ju njej ligji këtyre personave.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të lyera, të pastra nga ana higjienike dhe ishin të pajisura me orënditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ndodhej tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm.

Grupi inspektues konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ndodhej një skarë hekuri e lartë, e cila ndante korridorin e ambientit të shoqërimit nga ambientet e tjera të Komisarariatit. Kjo praktikë, bie ndesh me standardet ligjore në lidhje me kushtet e mbajtjes, trajtimit dhe sigurinë e personave të shoqëruar, të cilat duhet të jenë në kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në rregullat teknike të shoqërimit në polici<sup>77</sup>.

<sup>77</sup> Kreu VI, pika 3/a e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Nga inspektimi rezultoi gjithashtu se, në këtë Komisarariat mungonin dhomat e shoqërimit të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur<sup>78</sup> dhe nuk kishte sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Sipas informacionit të punonjësit të informacionit, pyetja e personave të shoqëruar kryhej në dhomën e marrjes në pyetje të shtetasve dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë të Komisarariatit.

Mungesa e këtyre elementëve, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Në Komisariatin e Policisë Mirditë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Mirditë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>79</sup>.

Në këtë komisarariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në Komisariatin e Policisë Mirditë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin dhe zyrat e punës së tyre. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të

<sup>78</sup> Kreu VI, pika 3/b e procedurës standard “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

<sup>79</sup> Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.



parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimit të shtetasve. Marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e skarës së hekurit që ndodhet në korridorin e ambientit të shoqërimit të Komisarariatit. Kushtet e mbajtjes dhe siguria për personat e shoqëruar, të kryhet sipas kushteve të përcaktuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

## 6.27 KOMISARIATI I POLICISË KURBIN

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 05.12.2018 në Komisaritati i Policisë Kurbin sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se në Komisariatin e Policisë Kurbin ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.**

Grupi i inspektimit, konstatoi se, në ambientin e shoqërimit ndodheshin 2 (dy) dhoma shoqërimi, të cilat shërbenin për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e komisarariatit të policisë vetëm për personat e rritur dhe femrat. Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra nga ana higjienike, të lyera dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në korridorin e ambientin të shoqërimit ishte ndërtuar edhe tualeti në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm.

Nga inspektimi i ambientit të shoqërimit rezultoi se, në këtë Komisarariat mungonte dhoma e shoqërimit më vete për të mitur<sup>80</sup>. Sipas procedurës standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici, në rastet kur i shoqëruari është i mitur, organi i policisë ka detyrimin ligjor të sigurojë dhomë shoqërimi më vetë për të miturit, si dhe të realizojnë menjëherë njoftimin e personit mbikëqyrës të tij (prindërit, kujdestarit ligjor)<sup>81</sup>.

Gjithashtu, në ambientin e shoqërimit mungonte sistemi i monitorimit me kamera<sup>82</sup> për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar dhe dhomave të shoqërimit.

Në lidhje me zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, në Komisariatin e Kurbin, mungonte edhe dhoma(zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e këtyre personave<sup>83</sup>.

<sup>80</sup> Kreu VI, pika 3/b të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

<sup>81</sup> Kreu VI, pika 2/a të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

<sup>82</sup> Kreu VI, pika 4/ç të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

<sup>83</sup> Kreu VI, pika 4/e të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Mungesa e këtyre elementëve, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Lezhë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kurbin, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë<sup>84</sup>.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe kryesisht për të miturit. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit. Marrjen e masave të

---

<sup>84</sup> Kreu VII, procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

nevojshme për krijimin e zyrës të intervistimit ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

## 6.28 KOMISARIATI I POLICISË LEZHË

**Gjatë vizitës inspektuese që u krye në datën 07.12.2018 në Komisarati i Policisë Lezhë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, MKPT-ja ka vërejtur se ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika**

Në Komisaratin e Policisë Lezhë, mjediset e shoqërimit janë ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit.

Në këtë mjedis ndodheshin katër dhoma shoqërimi, dy për meshkujt madhorë, një për femrat dhe një për të miturit. Njëra prej dhomave të shoqërimit për meshkujt madhorë përdorej për personat e shoqëruar që shfaqnin shenja agresiviteti. Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrim. Tre nga dhomat kishin dritare për sigurimin e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, ndërsa dhoma për shoqërimin e femrave, ishte e organizuar me paradhomë dhe dhomë.

Dhomat ishin të palyera, por të pastra, si dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, tavolina dhe karrige për të qëndruar ulur të shoqëruarit sipas pikës 3 të Kreut IV të “Rregullave teknike të shoqërimit në polici”, të cituar më sipër. Tualetet ndodheshin brenda dhomave të shoqërimit. Ato ishin të pajisura me materialet e duhura hidrosanitare dhe kishin ujë të rrjedhshëm.

Dhomat e shoqërimit dhe korridori i këtij ambienti nuk ishte i monitoruar me kamera.

Në Komisaratin e Policisë Lezhë në ambientet e sigurisë kishte katër dhoma sigurie, me kapacitet për gjashtë persona. Dhomat ishin të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ato ishin të ndara më vete, një për femra, një për mitur dhe dy për meshkuj madhorë, nga të cilat, dy me nga një krevat dhe dy me nga dy krevate. Dhomat e sigurisë për femrat dhe të miturit plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>85</sup> Ndërsa dy dhomat për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë, ndonëse ishin të ndara në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>, por nuk kishin sipërfaqen e nevojshme për dy persona. Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete

---

<sup>85</sup> Kreu V, pika 3.3 e Manualit “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

brenda dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshekë, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor, sikurse parashikohet në pikën 9 të Kreut V të Aktit të procedurave standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit.

Në ambientet e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje për dimër, sikurse parashikohet në pikën 3 të Kreut V të Aktit të procedurave standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit. Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës për të komunikuar me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme, të cilat ishin funksionale.

Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Brenda ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë për kryerjen e vizitave nga ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisariatit e Policisë Lezhë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar mundësia reale për të kontaktuar me të.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologja sigurohej nga shkollat e mesme të qytetit Lezhë.

Të ndaluarve dhe arrestuarve iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Grupi i punës konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e ndihmësmjekut kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në Aktin e procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e

Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.<sup>86</sup> Ndhmësmjeku ishte i punësuar në këtë organ me kohë të plotë. Ai i pasqyronte konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, në regjistrin e vizitave mjekësore. Po ashtu, ai hapte kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat i vendoste në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar. Duke vlerësuar rolin e ndhmësmjekut në këtë komisariat problematike mbetet plotësimi i organikës me mjek me kohë të plotë dhe me kompetenca diagnostifikimi dhe trajtimi të specializuar.

Për sa më sipër grupi i punës kërkoi nga autoritetet respektive të përmbusheshin këto rekomandime: Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në dhomat dhe korridorin e ambientit të shoqërimit. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave/ambienteve të intervistimit në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin dhe vënien në funksionim të sistemit të ngrohjes në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në këtë Komisariat. Marrjen e masave për lyerjen e dhomave të shoqërimit dhe të sigurimit. Marrjen e masave për plotësimin e vendit të punës sipas organikës së DPV Lezhë me mjek me kohë të plotë me qëllim garantimin e shërbimit mjekësor sipas standardeve të personave të arrestuar/ndaluar në këtë Komisariat.

---

<sup>86</sup> Kreu II, pika 7, e Manualit